




DVV International

Arsim për të gjithë. Në mbarë botën  
Gjatë gjithë jetës.

## **Udhëzime për trajnerët**

### **Moduli 3: Komunikimi dhe dinamika e grupit në arsimin për të rritur**



Deutsches Institut für  
Erwachsenenbildung  
Leibniz-Zentrum für  
Lebenslanges Lernen

**Botuar nga:**

Institut für Internationale Zusammenarbeit  
des Deutschen Volkshochschul-Verbandes e.V. (DVV International)  
Obere Wilhelmstraße 32, 53225 Bonn  
Federal Republic of Germany  
Tel.: +49 (0) 228-97569-0, Fax: +49 (0) 228-97569-55  
[info@dvv-international.de](mailto:info@dvv-international.de), [www.dvv-international.de](http://www.dvv-international.de)

Deutsches Institut für Erwachsenenbildung  
Leibniz-Zentrum für Lebenslanges Lernen e.V. (DIE)  
Heinemannstraße 12-14, 53175 Bonn  
Republika Federale e Gjermanisë  
Tel.: +49 (0) 228-3294-0, Fax: +49 (0) 228-3294-399  
[info@die-bonn.de](mailto:info@die-bonn.de), [www.die-bonn.de](http://www.die-bonn.de)

© 2016 DVV International, DIE

Autor:  
Prof. Dr. Zoran Velkovski

## **Përmbajtja**

Tema 1: Elementet dhe tiparet kyçe të komunikimit .....	5
1.1 Çka është komunikimi .....	7
1.2 Çka janë elementet e komunikimit? .....	10
1.3 Komunikimi verbal .....	13
1.4 Komunikimi joverbal .....	15
1.6 Gjuha paraverbale .....	19
1.7 Komunikimi në grup .....	21
Tema 2: Stilet e komunikimit .....	23
2.1. Stili i komunikimit agresiv .....	25
2.2. Stili i komunikimit pasiv .....	25
2.3. Stil komunikimi pasiv-agresiv .....	26
2.4. Stili i komunikimit të vendosur .....	26
2.5. Gjinia dhe komunikimi .....	30
2.6. Kultura dhe komunikimi .....	32
2.7. Mediumi i komunikimit .....	34
Tema 3: Teoria e komunikimit dhe pengesat në komunikim .....	36
3.1. Teoria e komunikimit .....	37
3.2. Pengesat në komunikim .....	41
Tema 4: Parimet e komunikimit .....	44
4.1. Parimet themelore të komunikimit .....	45
4.2. Parimet e komunikimit efektiv verbal .....	48
Tema 5: Metodatat dhe teknikat e komunikimit .....	51
5.1 Dëgjimi aktiv .....	52
5.2 Diskutim në grup .....	56
5.3 Prishësit e komunikimit .....	58
5.4 Komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve .....	61
Tema 6: Parimet themelore teorike dhe karakteristikat kyçe të dinamikës së grupit dhe kulturës së grupit .....	64
6.1. Teoria dhe parimi i punës në grup .....	65
6.2. Format dhe karakteristikat e grupeve të të nxënësve .....	67

Tema 7: Dinamika e grupit.....	72
7.1. Fazat e formimit të grupit .....	74
7.2. Fazat e zhvillimit të grupit.....	77
Tema 8: Modele për punën me grupe .....	82
8.1. Modelet për punën e suksesshme në grup.....	83
8.2. Puna e mësimit dhe e grupit .....	86
Tema 9: Teknika për drejtimin e dinamikës së grupit.....	87
Literatura e përdorur dhe e rekomanduar .....	91

## Hyrje


Këto Udhëzime janë punuar për përdorimin praktik nga praktikuesit e arsimit për të rritur (trajnerë, arsimtarë, instruktorë, etj.). Qëllimi i tyre kryesor është t'u ndihmojnë arsimtarëve të adresojnë shtyllat e teorisë, mjetet dhe teknikat për të analizuar, menaxhuar dhe përmirësuar komunikimin në çdo fushë të ndërveprimit profesional dhe personal dhe dinamikën e grupit në arsimin për të rritur, si dhe me zgjidhje didaktike dhe metodike për përmbajtjen e përshkruar në Moduli 3 të Curriculum globALE të titulluar: Komunikimi dhe dinamika e grupit në arsimin për të rritur.

Këto Udhëzime janë pjesë e një përpjekjeje bashkëpunuese për të ndërtuar shkathtësi komunikimi mes punonjësve të arsimit për të rritur dhe, veçanërisht, për të zhvilluar shkathtësitë e vendosmërisë, bashkëbisedimit ose komunikimit verbal dhe joverbal, dhe kapacitetit për aplikimin efektiv në angazhimin e tyre profesional. Si orientim shoqërues për ofruesit, këto udhëzime paraqesin informacion të thelluar për të gjitha aspektet e komunikimit dhe dinamikës së grupit në arsimin për të rritur, së bashku me udhëzimet didaktike për përdorim praktik.


Të kuptuarit e procesit të komunikimit dhe dinamikës së grupit në arsimin për të rritur, dhe e larmisë së tyre për sa i përket formave dhe zbatimit, funksioneve të komunikimit dhe dinamikës së grupit dhe rëndësisë së tyre për të nxënë efektiv të të rriturve, është një nga gjërat më të rëndësishme për arsimtarët për të rritur kur punojnë me të rriturit. Përmes përmbajtjes së Modulit 3, pjesëmarrësit do të kuptojnë terminologjinë themelore për komunikimin dhe dinamikën e grupit, aspektet teorike dhe praktike, elementet dhe sfidat që paraqesin komunikimi dhe dinamika e grupit në procesin e arsimit për të rritur. Përmbajtja adreson shumëllojshmërinë e punëve dhe profesioneve që përfshijnë punë aktive në fushën e arsimit për të rritur, si dhe kompetencat që u kërkohen nga profesionistët e arsimit për të rritur. Pasi të njihen me Modulin, nxënësit duhet të jenë në gjendje ta kuptojnë dhe të reflektojnë për rolin e tyre në sistemin e arsimit për të rritur.

Udhëzimet përmbajnë pesë kapituj mbi Komunikimin dhe pesë kapituj mbi Dinamikën e grupit, të cilët janë në përputhje me temat e modulit të parë të Curriculum globALE, të paraqitura në Grafikët në vijim.

### **Grafiku nr. 1: Përmbajtja e Udhëzimeve - KOMUNIKIMI**



## Grafiku nr. 2: Përmbajtja e Udhëzimeve - DINAMIKA E GRUPIT



Brenda çdo teme jepet një strukturë didaktike për përmbajtjen e temës:

- përshkrim i shkurtër tematik, me synime dhe rezultate;
- nën-temat me hyrje të shkurtër teorike dhe sugjerime dhe ide didaktike (shembull i skenarit për realizimin e nën-temës ose shembuj të detyrave);
- Sugjerime për ide të provimit dhe pyetje dhe sugjerime për punën individuale.

Këto Udhëzime përbëjnë mbështetje adragogjiko-didaktike për zbatimin e Modulit 3 të Curriculum globALE, siç vijon:

- Ofrojnë bazat teorike të secilës temë, si një lloj “udhërrëfyesi” për zbatimin e përmbajtjes së tij nga trajnerët;
- Propozojnë zgjidhje didaktike dhe modele të zbatimit të disa nën-temave;
- Japin udhëzime dhe këshilla të shumta për trajnerët , në lidhje me zgjedhjen e metodave të punës, kohën e caktuar për tema specifike, krijimin e pyetjeve të provimeve, udhëzimin e nxënësve si të bëjnë punën individuale, përdorimin e literaturës shtesë.

### Kërkesat minimale për trajnimin

#### Komunikimi

1. Të trajnuarve u prezantohen **elementët bazë dhe tiparet kyçe të komunikimit** siç propozohen nga modelet/teoritë kryesore të komunikimit. Atyre u prezantohen lloje dhe nivele të ndryshme të komunikimit (komunikim verbal, joverbal, para-verbal; komunikim në grup kundrejt atij individual; niveli i komunikimit emocional kundrejt atij faktik etj.).

2. Të trajnuarit mësojnë për stile të ndryshme të komunikimit dhe për faktorë që ndikojnë në komunikim (p.sh. gjinia, kultura, konteksti/mjedisi; mediumi).
3. Të trajnuarit i lidhin konceptet teorike të komunikimit me teorinë dhe praktikën e të nxënit të të rriturve. Ata reflektojnë se si trajtohet komunikimi në teoritë e të nxënit të të rriturve; analizojnë shembuj të praktikës së të nxënit të të rriturve (ndoshta nga përvoja e tyre) nën dritën e konceptit të nxënë të komunikimit. Ata mësojnë të njohin pengesat në komunikim që mund të ndodhin.
4. Të trajnuarve u prezantohen parimet e komunikimit që duhen respektuar në praktikën e të nxënit të të rriturve (p.sh. respekti, asnjënjësia, transparenca, bindja, mbështetja). Mundësisht, kjo nuk bëhet përmes një kontributi të trajnerit, por pjesëmarrësit duhet t'i zhvillojnë këto parime në mënyrë aktive përmes reflektimit dhe diskutimit.
5. Të trajnuarve u prezantohen një sërë metodash dhe teknikash të komunikimit që do të zbatohen në një sërë situatash dhe për qëllime të ndryshme (dëgjimi aktiv; lehtësimi i diskutimit në grup; kundërveprimi ndaj 'vrasësve' të bisedës, ballafaqimi me konflikte, udhëzimi i nxënësve, teknikat e informatave kthyesë etj.) dhe kryejnë ushtrime praktike.

Për secilën nga fushat 1, 2 dhe 4, të trajnuarit diskutojnë të paktën 2-3 materiale (p.sh. punime/dokumente origjinale, ekstrakte nga punime/dokumente origjinale, përshkrime të rasteve ose tekste/prezantime të përgatitura/përpiluara posaçërisht për trajnim), si dhe reflektojnë dhe / kryejnë disa ushtrime praktike (p.sh. punë individuale ose punë në grup gjatë seancave të trajnimit). Ushtrimet praktike janë veçanërisht të nevojshme për fushën 4.

Sa u përket faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në komunikim (fusha 1), të gjitha llojeve të të trajnuarve duhet t'u jepet një prezantim i shkurtër i përgjithshëm. Sipas asaj që është veçanërisht e rëndësishme për të trajnuarit, një ose dy faktorë specifikë mund të trajtohen më në thellësi (p.sh. gjinia).

### **Dinamika e grupit**

6. Të trajnuarve u prezantohen parimet themelore teorike dhe tiparet kyçe të dinamikës së grupit dhe kulturës së grupit (format dhe karakteristikat e grupeve të të nxënit, fazat e zhvillimit të grupeve, roleve, hierarkive, vlerave dhe rregullave)
7. Të trajnuarit i lidhin konceptet teorike të dinamikës së grupit me teorinë dhe praktikën e të nxënit të të rriturve. Ata reflektojnë për rëndësinë e dinamikës së grupit për procesin e mësimdhënies/të nxënit. Atyre u prezantohen dhe reflektojnë për rolet e ndryshme të arsimtarit për të rritur në grupin e mësimdhënies/të nxënit.
8. Të trajnuarve u prezantohen modele të ndryshme për të punuar me grupe (p.sh. ndërveprimi i përqendruar në tema, sociometria, etj.)
9. Të trajnuarve u prezantohen një sërë metodash dhe teknikash për drejtimin e dinamikës së grupit dhe përballimin e situatave sfiduese.

Për secilën nga këto fusha të trajnuarit diskutojnë të paktën 1-2 materiale (p.sh. punime/dokumente origjinale, ekstrakte nga punime/dokumente origjinale, përshkrime rastesh ose tekste/prezantime të

përgatitura/përpiluara posaçërisht për trajnim), si dhe reflektojnë dhe / kryejnë disa ushtrime praktike (p.sh. punë individuale ose punë në grup gjatë seancave të trajnimit).

## **Tema 1: Elementet dhe tiparet kyçe të komunikimit**

Tema e parë trajton temën më të gjerë të komunikimit në arsimin për të rritur, e cila mund të vëzhgohet nga këndvështrime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme. Ajo ka disa nën-tema specifike të cilat janë përqendruar në elemente të ndryshme të temës kryesore dhe janë paraqitur në Udhëzime me përshkrime të synimeve të të nxënit dhe rezultateve të të nxënit.

Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe diturive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënit. Koha optimale për zbatimin e kësaj teme është 1 ditë.

Qëllimi kryesor i kësaj teme është të kuptohet komunikimi si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur, dhe larmia e tij në aspektin e strukturës, organizimit, elementeve kyçe, parimeve dhe modeleve të komunikimit, si dhe rëndësinë e tij për të nxënit efektiv dhe zhvillimin personal.

**Tabela 1: Nën-temat, synimet e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për zbatimin e temës:  
ELEMENTET DHE TIPARET KYÇE TË KOMUNIKIMIT**

*Synimi i të nxënit:* Të kuptohet domethënia dhe rëndësia e Komunikimit, si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur, dhe larmia e tij në aspektin e strukturës, organizimit, elementeve kyçe, parimeve dhe modeleve të komunikimit, dhe zhvillimit të shkathtësive të komunikimit për të nxënë më mirë dhe për të jetuar së bashku.

*Rezultati i përgjithshëm i të nxënit:* Pas përfundimit të kësaj teme, nxënësit e njohin diversitetin dhe shumëllojshmërinë e formave të arsimit dhe të nxënit të të rriturve, kuptojnë funksionet themelore të arsimit për të rritur dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në arsimin për të rritur.

<b>Nën-tema</b>	<b>Synimi</b>	<b>Rezultati</b>
<b>1. Çka është komunikimi?</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimi i komunikimit dhe përshkrimi i komunikimit si proces.</li> <li>- Identifikimi dhe përshkrimi i komponentëve thelbësorë të komunikimit.</li> <li>- Identifikimi dhe përshkrimi i modeleve të komunikimit.</li> </ul>	<p>Nxënësit kuptojnë procesin e komunikimit.</p> <p>Nxënësit dinë komponentët thelbësorë të komunikimit.</p> <p>Nxënësit mund t'i identifikojnë dhe përshkruajnë modelet e komunikimit</p>
<b>2. Çka janë elementet e komunikimit?</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hyrje në komunikim dhe elemente të komunikimit.</li> <li>- Faktorët që ndikojnë në arsimin për të rritur.</li> </ul>	<p>Nxënësit dinë forma dhe elemente të ndryshme të komunikimit;</p> <p>Nxënësit mund të praktikojnë forma të ndryshme të komunikimit.</p>
<b>3. Komunikimi verbal</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptuarit e komunikimit verbal.</li> <li>- Identifikimi dhe përshkrimi i parimeve kyçe të komunikimit verbal.</li> </ul>	<p>Nxënësit e kuptojnë komunikimin verbal dhe parimet kyçe.</p> <p>Nxënësit mund të praktikojnë forma të ndryshme të komunikimit verbal.</p>
<b>4. Komunikimi joverbal</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kuptuarit dhe të nxënit e komunikimit joverbal.</li> <li>- Demonstrimi i komunikimit joverbal dhe përshkrimi i rolit të tij në procesin e komunikimit.</li> <li>- Të kuptuarit dhe shpjegimi i parimeve të komunikimit joverbal.</li> </ul>	<p>Nxënësit kuptojnë elementet e komunikimit joverbal.</p> <p>Nxënësit kuptojnë parimin e komunikimit joverbal.</p> <p>Nxënësit mund t'i analizojnë shenjat joverbale. Nxënësit mund të praktikojnë forma të ndryshme të komunikimit joverbal.</p>
<b>5. Gjuha paraverbale</b>	Të kuptuarit dhe të nxënit e gjuhës paraverbale.	Nxënësit kuptojnë elementet e gjuhës paraverbale.
<b>6. Komunikimi në grup</b>	Të kuptuarit dhe të nxënit e komunikimit në grup.	<p>Nxënësit e dinë se çfarë është komunikimi në grup.</p> <p>Nxënësit mund të përfshijnë elemente të komunikimit joverbal dhe paraverbal në diskutimin në grup.</p>

## 1.1 Çka është komunikimi

Komunikimi është një proces konstant dhe i vazhdueshëm i cili është një element thelbësor i botës në të cilën ekzistojnë të gjitha gjallesat. Nevoja për komunikim është po aq e fortë sa edhe nevoja biologjike për ujë, ushqim dhe riprodhim. Nevoja për të komunikuar me njerëzit e tjerë dhe gjithçka që na rrethon është pjesë e natyrës njerëzore. Me ndihmën e komunikimit, njeriu shkëmben dhe ndan vlera shpirtërore dhe emocionale, qoftë në formën e dialogut me “Unin” e vet të dytë ose në procesin e marrëdhënieve të ndërsjella me njerëzit përreth. Komunikimi është nevojë individuale dhe kolektive.



Fjala komunikim rrjedh nga fjala latine *communis*, që do të thotë e përbashkët, e ndërsjellë. Komunikimi është sinonim i shkëmbimit, ndarjes, ndërveprimit ose jetës në një komunitet. Përfaqëson transferimin e mesazheve simbolike dhe marrjen e reagimeve. Me ndihmën e komunikimit ne transferojmë më shumë se informacion, ne transferojmë ndër të tjera ide, ndjenja, qëndrime, besime, vlera dhe gjendje emocionale.

Enciklopedia e përkufizon komunikimin si “shkëmbim të formave të ndryshme të kuptimit mes individëve ose grupeve përmes një sistemi të përbashkët të simboleve ose gjuhës”. Mund të kuptohet edhe si dërgimi i mesazheve kuptimplote nga një person tek tjetri. Këto mesazhe mund të shprehen me gojë ose me shkrim, mund të jenë verbale ose joverbale, të vetëdijshme ose të pavetëdijshme, mund të shprehen përmes mediave të ndryshme ose përmes përdorimit të shqisave të ndryshme. Komunikimi u mundëson individëve ose grupeve të mësojnë gjëra të reja, të binden për diçka, të kërkojnë informacion, të marrin informacion ose të shprehin ndjenjat e tyre. Komunikimi përfshin simbolet, gjestet, rregullat, praktikat, kulturat, traditat, mënyrën e veshjes, etj.

Zhvillimi i komunikimit është pjesë integrale e evolucionit të njerëzimit dhe proceseve shoqërore. Nga shenjat dhe sinjalet, karakteristike për agun e njerëzimit, tek shkëmbimi verbal me gojë dhe përmes fjalës së shkruar, deri tek komunikimi masiv dhe revolucioni i informacionit, komunikimi është zhvilluar në një komponent i domosdoshëm dhe i qenësishëm i civilizimit tonë, një instrument për transmetimin e përvojës individuale dhe shoqërore, njëkohësisht agjent dhe pasojë. Ai përcakton marrëdhëniet mes njerëzve dhe lidhjen e tyre me natyrën, duke e formuar kështu njeriun si qenie shoqërore. Ai u siguron njerëzve një ndjenjë të përkatësisë, zvogëlon vetminë dhe frustrimet, duke i ndihmuar njerëzit të përshtaten me mjedisin e tyre.

Në të njëjtën kohë, komunikimi është një shkathtësi që individët e fitojnë spontanisht, qoftë pa bërë përpjekje (siç është edhe përvetësimi i gjuhës amtare, pranimit i zhargonit ose shprehjeve simbolike) ose duke bërë përpjekje dhe përmes procesit të arsimit, duke kontribuar në shfaqjen të një profili të veçantë të individit. Përvetësimi i shkathtësive të komunikimit përcakton kryesisht identitetin e një personi, personalitetin e tij ose të saj. Kështu, njerëzit shpesh projektojnë përshtypjen e një individi të ndrojtur, dinak, arrogant, perceptues, agresiv, të tërhequr ose ndërhyrës. Këto sjellje të ndryshme të komunikimit janë një reflektim i individit, i mënyrës së tij/saj të të menduarit, qëndrimeve dhe madje edhe kulturës.

Në arsimin për të rritur, komunikimi përfshin forma të ndryshme shkëmbimi mes pjesëmarrësve brenda një procesi arsimor. Është parakusht i rëndësishëm për arritjen e një bashkëpunimi efikas, efektiv dhe krijues mes pjesëmarrësve, dhe gjithashtu për sigurimin e cilësisë së përgjithshme të procesit të arsimit. Është një kompleks i ndërlikuar i marrëdhënieve socio-psikologjike, motivuese dhe morale, të cilat janë pjesë përbërëse e përpjekjeve arsimore.

Në procesin e edukimit me nxënës të rritur, është shumë e rëndësishme që si nxënësit ashtu edhe mësuesit t'i dinë dhe t'i kuptojnë shenjat dhe simbolet e komunikimit, pasi është një parakusht i rëndësishëm për një bashkëpunim të suksesshëm dhe krijues të bazuar në barazi.

Ekzistojnë tre lloje themelore të komunikimit:

1. **komunikimi intrapersonal** (dialogu me "Unin" e dytë ose me vetveten);
2. **komunikimi ndërpersonal** (ndërveprimi i ndërsjellë i dy ose më shumë personave "ballë për ballë" me mundësinë e reagimit të menjëhershëm); dhe
3. **komunikimi masiv ose sistemik**, i cili përdor mjete të ndryshme teknike dhe është i orientuar në një gamë të gjerë të përdoruesve të mundshëm.

Ekzistimi i llojeve të ndryshme të komunikimit lejon një numër të mundësive dhe situatave të ndryshme në procesin e arsimit. Në këtë kontekst, komunikimi ndërpersonal ka një rëndësi të veçantë, sepse përmes tij kryhet procesi i mësimit dhe të nxënësve. Është një mjet për arsim të suksesshëm. Ndhomon për të kuptuar sjelljen e pjesëmarrësve dhe lehtëson shkëmbimin e ideve, ndjenjave dhe mendimeve të tyre me pjesëmarrësit e tjerë në procesin e arsimit.

Komunikimi ndërpersonal:

- përfshin sjelljen verbale dhe joverbale;
- përfshin sjellje spontane, të praktikuar dhe të planifikuara, ose një kombinim të mundshëm të tyre;
- është zhvillimor dhe jo statik;
- lehtëson reagimin, ndërveprimin dhe koordinimin e menjëhershëm;
- vendos rregulla të brendshme dhe të jashtme;
- përfaqëson një veprimtari; dhe
- mund të përfshijë besime (Reardon, 1998).

Komunikimi ndërpersonal mund të jetë:

- **i drejtpërdrejtë** (i menjëhershëm) dhe
- **i tërthortë** (përmes ndërmjetësve - mjeteve teknike. d.m.th. media).

Komunikimi brenda procesit arsimor nuk duhet të jetë gjithmonë një veprim i vetëdijshëm i pjesëmarrësve. Ndodh edhe kur ata nuk janë të vetëdijshëm se po komunikojnë, dhe madje edhe kur nuk dëshirojnë të komunikojnë. Edhe kur nuk flasin, ata po ndajnë disa informacione. Ndodh edhe kur ata nuk interesohen, kur e injorojnë diçka ose dikë, kur heshtin, dhe kur në mënyrë të pavetëdijshme dërgojnë mesazhe me mënyrën se si vishen, ulen, ecin, bëjnë gjeste pa vetëdije, etj. Për këtë arsye, kush merr pjesë në arsimin për nxënës të rritur, veçanërisht mësuesit, duhet t'i presë mesazhet që ata i dërgojnë në mënyrë të pavetëdijshme, të cilat duhet të jenë në përputhje me mesazhet që transmetohen me vetëdije, në mënyrë që të mund të merren në mënyrën e duhur nga marrësit e synuar.

Procesi i arsimit kërkon transmetimin e llojeve të ndryshme të informacionit. Vëmendje e duhur duhet t'i kushtohet jo vetëm përmbajtjes së informacionit, por edhe mënyrës së transmetimit. Është e rëndësishme të merret parasysh nëse mënyra e transmetimit të informacionit është e pranueshme apo jo për ata që e marrin informacionin.

**Tabela 1.1: Sugjerim për zbatimin kësaj nën-teme:**

<b>Nën-tema</b>	<b>Çka është komunikimi</b>
<b>Synimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizimi i komunikimit dhe përshkrimi i komunikimit si proces.</li> <li>- Identifikimi dhe përshkrimi i komponentëve thelbësorë të komunikimit.</li> <li>- Identifikimi dhe përshkrimi i modeleve të komunikimit</li> </ul>
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, diskutime, punë në grupe, prezantime, gjenerim idesh, vëzhgim.
<b>Korniza kohore</b>	30 min.
<b>Burimet e kërkuara</b>	Letër tabelle, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor, LCD
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim në Power Point, filma, incizim zanor
<b>Procedura</b>	<p>Vëzhgoni disa komunikime ndërpersonale; mbani mend sjelljet e përdorura, si verbale, ashtu edhe joverbale.</p> <p>Vëzhgoni dhe mendoni për faktorët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kush janë komunikuesit?</li> <li>- Cilat mesazhe u shkëmbyen?</li> <li>- Çfarë zhurme (nëse ka) e shtrembëron mesazhin?</li> <li>- Si jepet reagimi?</li> <li>- Cili është konteksti i komunikimit?</li> </ul> <p>Duke vëzhguar të tjerët - duke bërë një përpjekje të vetëdijshme për të kuptuar si ndodh komunikimi - ju do të mendoni për mënyrën si <i>komunikoni</i> dhe do të jeni më të vetëdijshëm për mesazhet që dërgoni. Ju lutemi t'i ndani rezultatet tuaja me kolegët e kursit.</p>


***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Gjenerim idesh (i cili rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e tekstit me përkufizime të ndryshme të komunikimit...

## 1.2 Çka janë elementet e komunikimit?

Në mënyrë që të vazhdojë, çdo komunikim duhet të përfshijë së paku dy persona. Komunikimi nuk është një proces i drejtpërdrejtë në të cilin dërguesi i dërgon një mesazh marrësit që merr mesazhin përkatës. Një situatë e tillë ndodh shumë rrallë. Edhe në një proces arsimor në të cilin mësimitdhënësi ligjëron dhe nxënësit dëgjojnë në mënyrë pasive, asnjëherë nuk ka transmetim të njëanshëm të mesazheve. Reagimet nuk duhet domosdoshmërisht të përcillen me gojë ose me shkrim nga nxënësit te mësimitdhënësi. Edhe reagimet e tyre “të heshtura”, të shprehura përmes komunikimit joverbal (duke buzëqeshur, duke u vrenjtur, lëvizjet e trupit ose kokës, etj.), paraqesin reagime për mësimitdhënësin.

Kështu, komunikimi është gjithmonë një proces ndërveprues i dyanshëm dhe kompleks, në të cilin dërguesi dhe marrësi i ndryshojnë vazhdimisht rolet e tyre.



### Elementet kryesorë të komunikimit:

#### a) Dërguesi:

Dërguesi është personi që dërgon mesazhin me qëllim të transmetimit të informacionit tek personi (personat) e tjerë.

#### b) Mesazhi:

Mesazhi është objekti i komunikimit. Mund të jetë një ide, të dhëna, opinion, qëndrim, ndjenjë, rend, propozim, etj. Mesazhi jo gjithmonë duhet të jetë informacion dhe nuk ka pse të jetë në formën e një shprehje verbale specifike. Mund të jetë joverbal dhe mund të shprehet përmes shprehjeve të fytyrës, tonit të zërit, gjesteve të gjuhës së trupit. Një sjellje e tillë joverbale transmeton informacione shtesë rreth vetë mesazhit, duke krijuar kështu kontekstin emocional të mesazhit dhe duke kontribuar në efektin përfundimtar të të kuptuarit dhe pranimin të tij. Në praktikën arsimore, komunikimi verbal dhe joverbal më së shpeshti shkojnë krah për krah. Edhe në rastin e mesazhit të dizajnuar në mënyrë ideale, ai mund të kuptohet ose të pranohet keq ose gabimisht nga marrësit, pikërisht për shkak të kontekstit emocional të mesazhit kryesor. Gjuha joverbale që shoqëron të folurin verbal shpesh mund t'i bezdisë

nxënësit dhe të shkaktojë refuzimin e mesazhit kryesor. Zëri i mprehtë dhe i gërvishtur i një mësimdhënësi, sjellja arrogante e trupit, gjestet e papërshtatshme ose manifestime të tjera të papërshtatshme, mund t'i zvogëlojë efektet e komunikimit të tij/saj me nxënësit.

**c) Kodimi:**

Përmbajtja e komunikimit është teorike dhe jo substanciale. Transmetimi i tij kërkon përdorimin e simboleve specifike, të tilla si shkronja, fjalë, imazhe, gjeste dhe veprime. Transformimi i përmbajtjes në simbole quhet kodim. Kur kodon mesazhin, dërguesi duhet të përqendrohet tek marrës (marrësit) dhe të marrë parasysh dituritë e tyre paraprake, aftësitë, besimet, etj. Ai/ajo duhet të kujdeset që mesazhi të dekodohet siç duhet nga marrësi i synuar në mënyrë që të nxirret kuptimi i duhur i tij.

**d) Kanali i komunikimit:**

Dërguesi zgjedh kanalin e komunikimit, d.m.th. mediumin, përmes të cilit e dërgon mesazhin. Ai/ajo duhet të vendosë për mënyrën më të mirë dhe më efektive për transmetimin e mesazhit. Ekzistojnë një numër i llojeve të kanaleve që mund të zgjidhen, kanale formale ose joformale për transmetimin e fjalëve të folura, materialeve të shkruara, paraqitjeve grafike ose materialit të dizajnuar elektronikisht, duke përfshirë: transmetimin me zë të mesazhit në situatë ballë për ballë, përmes Internetit, radios, televizionit, me postë, etj. Në një situatë ballë për ballë vendosen kontakte të të folurit dhe pamore, ndërsa përdorimi i një telefoni për të komunikuar imponon kufizimin vetëm në të folur.

**e) Marrësi:**

Marrësi është personi që e merr mesazhin dhe për të cilin është menduar. Ky nuk ka pse të jetë një person. Në arsimin për të rritur, situata më e shpeshtë është kur një dërgues transmeton një mesazh për një grup nxënësish të rritur. Shpesh, një grup i dërgon një mesazh tjetrit.

**f) Dekodimi:**

Marrësi përpiqet ta kuptojë mesazhin në mënyrën më të mirë të mundshme në mënyrë që të arrijë objektivat e dëshiruara. Ai/ajo i deshifron simbolet e përdorura nga dërguesi për të interpretuar kuptimin e mesazhit dhe që ta kuptojë atë plotësisht. Ai/ajo është përgjegjës për ofrimin e reagimit ndaj dërguesit. Mund të ndodhë që mesazhi i koduar të mos deshifrohet mirë nga marrësi. Nëse ndodh, kjo varet më së shumti nga dërguesi i mesazhit, d.m.th. nga fakti nëse e ka përgatitur mirë apo nëse ai/ajo i ka marrë parasysh kapacitetet e marrësit (dituri paraprake, përvojë, bindje, qëndrime dhe vlera) për ta deshifruar me sukses mesazhin dhe për ta nxjerrë kuptimin e tij.

**g) Reagimi:**

Reagimet duhet ta informojnë dërguesin nëse marrësi e deshifroi me sukses përmbajtjen e mesazhit dhe e kuptoi atë me të njëjtin kuptim që i ka dhënë dërguesi. Reagimi mund të sigurohet në formën e një mesazhi të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm; mund të shprehet drejtpërdrejt dhe me gojë, duke thënë "A mund ta përsërisni, nuk e kuptova mirë këtë", ose "Po, e kuptoj tani!", ose joverbalisht në formën e gjesteve të dukshme ose të lehta, pohimi me kokë, shprehjet e fytyrës ose ndryshimet në sjelljen e trupit. Një reagim i tillë i mundëson dërguesit të mesazhit të vetë-korrigjojë ose rregullojë, adaptojë, konfirmojë ose plotësojë mesazhin, në mënyrë që ta përmirësojë komunikimin.

**h) Zhurma**

Ky është një faktor që pengon transmetimin e mesazhit. Shpesh bëhet fjalë për një lloj zhurme, e cila mund të jetë e brendshme, që vjen nga vetë grupi, ose e jashtme, e shkaktuar nga reshjet e shiut, bubullimat, rrëmuja e shkaktuar nga persona që nuk marrin pjesë në procesin e arsimit, zhurma e makinave, etj. Këto pengesa ose vështirësi, në varësi të intensitetit të tyre, mund ta pengojë

komunikimin dhe transferimin e mesazheve, dhe në disa raste edhe ta ndërpresin komunikimin. Edhe gjuha e papërshtatshme e trupit e mësimit, përdorimi i zhargonit të ndërlikuar, mungesa e vëmendjes ose interesit të nxënësit dhe dallimet kulturore, mund të vlerësohen si “zhurmë” në kontekstin e komunikimit ndërpersonal. Pra, çdo thyerje ose mospërputhje që lind në procesin e komunikimit mund të konsiderohet si zhurmë.

### i) Konteksti

Çdo komunikim ndikohet nga konteksti në të cilin ndodh. Përveç kontekstit të situatës në të cilën zhvillohet ndërveprimi, siç janë klasa arsimore, laborator, punësoria, apo mjedisi i jashtëm, duhet të marrim parasysh edhe kontekstin shoqëror, duke përfshirë rolet, përgjegjësitë dhe statusin e pjesëmarrësve. Në komunikim ndikojnë edhe klima emocionale dhe pritjet e nxënësit për ndërveprimin.

Komunikimi është një proces dinamik. Është konstant, i pakthyeshem dhe kontekstual. Asnjëherë nuk mund të veçojmë një element dhe të lëmë pas dore të tjerët.

**Tabela 1.2: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Çka janë elementet e komunikimit
Synimi	Të kuptuarit e elementeve kyçe të komunikimit dhe lidhja dhe ndërveprimi i tyre.
Metodat dhe teknikat	Ligjëratë, diskutime, moderim, prezantime, punë në grup.
Korniza kohore	60 min
Burimet e kërkuara	Letër tabelle, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	<p>Vendosni së bashku me nxënësit tuaj për një temë specifike për komunikimin ndërpersonal dhe personat që do të komunikojnë. Caktoni disa nxënës që të mbajnë shënime në lidhje me të shprehurit e përdorur verbal të komunikuesve gjatë diskutimit për temën.</p> <p>Ata duhet të vëzhgojnë me kujdes dhe të marrin parasysh faktorët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kush ishin komunikuesit?</li> <li>- Cilat mesazhe u shkëmbyen?</li> <li>- Cili ishte konteksti i komunikimit?</li> <li>- Cilat kanale komunikimi u përdorën?</li> <li>- Cili ishte reagimi i marrësve të mesazheve?</li> <li>- Cila zhurmë (nëse ka) i pengoi mesazhet?</li> <li>- Si u dha reagimi?</li> </ul> <p>Pas përfundimit të komunikimit, secili mbajtës i shënimeve duhet t'i paraqesë grupit atë që ai/ajo vuri re.</p> <p>Duke vëzhguar komunikimin e dikujt tjetër, nxënësit duhet të bëjnë një përpjekje të vetëdijshme për ta kuptuar procesin e komunikimit. Ata duhet të reflektojnë për mënyrat si komunikojnë dhe çfarë lloj mesazhi transmetojnë, dhe si e bëjnë këtë.</p>

#### **Sugjerime didaktike**

Kjo njësi e të nxënësit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Vëzhgim, demonstrim ndërveprues (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të elementeve të komunikimit...

### 1.3 Komunikimi verbal

Mendimi i parë që të vjen në mendje kur diskutojmë për termin komunikim është se është një proces në të cilin të paktën dy persona shkëmbejnë simbole zanore, d.m.th. ata komunikojnë verbalisht dhe në mënyrë të ndërsjellë shkëmbejnë informacion me ndihmën e të folurit. Sidoqoftë, duhet të jemi të vetëdijshëm se ky është vetëm një nga shumë nivele në të cilat ndodh komunikimi, dhe bazuar në të gjithë treguesit, ai ka ndikimin më të vogël në procesin e komunikimit.

1. Asnjëherë mos përdorni metafora ose ndonjë figurë tjetër stilistike që jeni mësuar t'i shihni në tekste të shtypura;
2. Asnjëherë mos përdorni një fjalë të gjatë nëse një fjalë e shkurtër është po aq e përshtatshme;
3. Nëse është e mundur ta heqësh një fjalë, atëherë hiqe;
4. Asnjëherë mos përdorni formën pësore nëse mund të përdorni formën vetvetore;
5. Asnjëherë mos përdorni fraza të huaja, një fjalë që keni mësuar ose zhargon, nëse mund ta zëvendësoni me një fjalë ekuivalente nga të folurit e përditshëm;
6. Thyej cilindo prej rregullave të mësipërme para se të thuash ndonjë gjë të pasjellshme.

**George Orwell**

Komunikimi verbal bazohet në disa parime themelore<sup>1</sup>:

- Gjuha ka rregulla - gjuha është një kod, një koleksion simbolesh, shkronjash ose fjalësh me kuptime arbitrare që janë rregulluar sipas rregullave të sintaksës dhe përdoren për të komunikuar.
- Realiteti ynë formësohet nga gjuha jonë - Gjuha është si syzet e diellit, sepse e ngjyros mënyrën si e shohim botën.
- Gjuha është arbitrare dhe simbolike - Fjalët, nuk kanë ndonjë kuptim të qenësishëm. Njerëzit u japin kuptim, dhe kuptimet e tyre ndryshojnë me kalimin e kohës. Simbolet arbitrare, përfshirë shkronjat, numrat dhe shenjat e pikësimit, përfaqësojnë konceptet në përvojën tonë.
- Gjuha është abstrakte - Fjalët përfaqësojnë aspekte të mjedisit tonë dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në atë mjedis. Ato mund të përshkruajnë një ide apo koncept të rëndësishëm, por vetë akti i etiketimit dhe thirrjes së një fjale thjeshton dhe shtrembëron konceptin tonë të vetë sendit.
- Gjuha organizon dhe klasifikon realitetin - Ne përdorim gjuhën për të krijuar dhe shprehur njëfarë kuptimi të rendit në botën tonë. Shpesh grupojmë fjalë që përfaqësojnë koncepte nga afërsia e tyre fizike ose ngjashmëria e tyre me njëra tjetrën.

Për ta përmirësuar komunikimin tonë verbal, duhet t'u përmbahemi disa parimeve kyçe:<sup>2</sup>

- Përcaktoni terminologjinë
- Zgjidhni fjalë të sakta
- Konsideroni audiencën tuaj

<sup>1</sup> Komunikimi për suksesin e biznesit. Shih: <http://2012books.lardbucket.org/pdfs/communication-for-business-success.pdf>

<sup>2</sup> Po aty

- Kontrolloni tonin tuaj
- Kontrolloni të kuptuarit
- Jini të orientuar nga rezultatet
- 

**Tabela 1.3: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**


<b>Nën-tema</b>	<b>Komunikimi verbal</b>
<b>Synimi</b>	Të kuptuarit e komunikimit verbal dhe identifikimi dhe përshkrimi i parimeve kyçe të komunikimit verbal.
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, diskutime, moderim, prezantime, punë në grup.
<b>Korniza kohore</b>	30 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	Letër table, lapsa me ngjyra, projektor
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	Renditni pesë vetura që i përdorin njerëz që i njihni dhe diskutoni për secilën, duke përmendur nëse e perceptoni se makina thotë diçka për ta apo jo. Ndani dhe diskutoni me nxënësit. Nxënësit përshkruajnë një proces të thjeshtë, nga krehja deri tek hapja e një shisheje, në terma sa më të saktë që të jetë e mundur. Prezantohet për klasën.

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
Debat (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve)

## 1.4 Komunikimi joverbal

Nga pikëpamja e historisë së evolucionit, fjala nuk ka qëndruar kurrë vetëm dhe gjithmonë është shoqëruar me nivele të tjera të komunikimit, po aq të forta dhe të rëndësishme për rrjedhën e komunikimit. Përvoja na tregon se çdo gjuhë verbale shoqërohet me një gjest të caktuar, pozicion të trupit, shprehje të fytyrës, tonin dhe mprehtësinë e zërit, etj. Të gjithë këta elemente shoqëruar të gjuhës verbale përbëjnë dy nivelet e tjera të gjuhës së komunikimit, joverbal dhe paraverbal.



Është vërtetuar se gjuhët joverbale dhe paraverbale lënë përshtypje më të madhe në proceset e komunikimit dhe të nxënimit sesa gjuha verbale.

Kur komunikojmë me të tjerët, marrim dhe dërgojmë sinjale pa zë. Ne dërgojmë mesazhe të forta me të gjitha gjestet joverbale që bëjmë, mënyrën si qëndrojmë/ulemi, sa shpejt ose sa me zë flasim, sa larg qëndrojmë, ose çfarë lloj kontaktesh pamore bëjmë. Këto mesazhe nuk ndalen as kur ndalemi së foluri. Edhe kur heshtim, komunikojmë jo verbalisht.

Ndonjëherë, ato që themi dhe ato që tregojmë përmes sinjaleve joverbale mund të jenë krejtësisht të ndryshme. Në një rast të tillë, marrësi i mesazhit duhet të zgjedhë nëse do t'u besojë fjalëve tona apo asaj që kemi treguar me gjuhën tonë joverbale. Në shumicën e rasteve, zgjedhja është në favor të gjuhës joverbale, sepse është gjuha natyrale dhe e pavetëdijshme që pasqyron ndjenjat, qëllimet dhe besimet tona të vërteta.

Le të shohim tre situata të ndara:

### Situata 1:

Nëse mësimdhënësi/ja, me kurrizin e tij/saj të kthyer nga nxënësit e rritur, thotë: “Disa prej jush bënë detyra shumë të mira”, ai/ajo përdor kanal verbal për të përcjellë mesazhin tek nxënësit e rritur. Sidoqoftë, përveç mesazhit të shprehur me zë, nxënësit marrin shumë pak informacion shtesë që u nevojiten për të deshifruar dhe kuptuar si duhet kuptimin e tij të vërtetë.

### Situata 2:

Nëse mesazhi i njëjtit transmetohet nga mësimdhënësi me fytyrë nga nxënësit e rritur dhe i shoqëruar me ndjenja, gjeste, tonin e zërit, theksime dhe lëvizjen e syve, duke thënë: “Disa prej jush (duke i hedhur sytë tek nxënës specifikë të tij/saj) kanë bërë detyra shumë të mira ( buzëqeshje)”, atëherë mesazhi ka shumë më tepër “brumë” dhe u jep nxënësve mundësinë që ta kuptojnë plotësisht kuptimin e tij dhe të marrin shumë informacion shtesë (kush janë ata nxënës, sa të mirë ishin, nëse mësimdhënësi është i kënaqur, etj.).

### Situata 3:

Nëse mësimdhënësi e shoqëron të njëjtin mesazh me fytyrë nga nxënësit e rritur dhe me shprehje të zemëruar të fytyrës, sarkazëm dhe gjeste nervoze, i njëjti mesazh merr një kuptim krejtësisht të ndryshëm për nxënësit. Ai nuk është më pozitiv, nuk lavdëron por kritikon dhe shpreh pakënaqësinë e mësimdhënësit. Në këtë mënyrë, komunikimi joverbal bëhet më i sigurt dhe i vërtetë se ai verbal.

Në rastet 2 dhe 3, mësimdhënësi ka komunikuar jo vetëm verbalisht, por edhe joverbalisht me nxënësit, duke përfshirë një mesazh të folur dhe sinjale fizike për të shprehur ndjenjat, opinionet, pajtimin, kënaqësinë e tij/saj, etj.

Në përgjithësi, ndryshe nga sinjalet në gjuhën verbale, sinjalet në komunikimin joverbal ndodhin në nivel të nënndërgjegjeshëm; ato janë shumë të drejtpërdrejta, instinktive dhe të menjëhershme dhe janë më të vështira për t'u kontrolluar. Me ndihmën e sinjaleve joverbale, mesazhi bëhet më i qartë, "më i pasur" dhe më i saktë për marrësit, si dhe më tregues për dërguesit, pasi ato zbulojnë se çfarë mendon ai/ajo.

Kur sinjalet tona joverbale përputhen me fjalët që shqiptojmë, ato rrisin besimin, qartësinë dhe mesazhin që dërgojmë. Kur nuk përputhen, ato krijojnë tension, mosbesim dhe konfuzion. Një komunikues i mirë duhet t'i kushtojë vëmendje të duhur sinjaleve joverbale të të tjerëve, si dhe të vetes.

Të folurit joverbal lehtëson:

**Vërtetësinë:** mund të vërtetojë vërtetësinë e mesazhit gojor.

**Përsëritjen:** mund të përsërisë mesazhin që dërgojmë me gojë.

**Kundërshtinë:** mund të kundërshtojë mesazhin që po përpiqemi të përcjellim.

**Zëvendësimin:** mund të zëvendësojë të folurin verbal ose mesazhin verbal.

**Besimin:** mund të tregojë se e besojmë atë që themi gojarisht.

**Plotësimin:** mund të plotësojë mesazhin gojor.

**Theksimin:** mund të theksojë rëndësinë e mesazhit, për shembull trokitjet mbi tavolinë ose përdorimi i një zëri të ngritur.


## Elementet e komunikimi joverbal:

### Pozicioni i trupit


Ky lloj komunikimi joverbal përfshin gjeste, pozicionin e trupit, kokës, shenjat, lëvizjet e duarve, qëndrimin dhe lëvizjet e lehta.

Lëvizja e trupit mund të përdoret për të forcuar ose theksuar atë që thuhet gojarisht. Kjo mund të tregojë nëse jemi të interesuar, të vëmendshëm, të mërziur, me vetëbesim, a na intereson apo jo, apo nëse kemi dyshime ose jemi të hapur, ose kemi pritshmëri, apo...

Shpesh, shenja përgjithësisht të njohura, siç


është shenja "OK"  përdoren për

komunikim, çka është e pranueshme. Sidoqoftë, duhet pasur kujdes që të mos përdoren shenja të cilat në një kontekst tjetër kulturor mund të keqinterpretohen dhe të dëmtojnë komunikimin.



## Shprehja e fytyrës

Fytyra e njeriut është shumë shprehëse dhe mund të shprehë shumë emocione pa mbështetjen e gjuhës verbale.



## Gjestet

Gjestet mund të theksojnë përmbajtjen verbale, si për shembull ironi apo serioze.



Boredom Gesture




Interested, Evaluation Gesture

## Drejtimi i shikimit

Me ndihmën e shikimit mund të shprehet një spektër i gjerë i emocioneve, nga dashuria tek urrejtja, mërzitja, neveria, dominimi, servilizmi ose provokimi.

Drejtimi i shikimit dhe vendosja e kontaktit pamor është një lloj jashtëzakonisht i rëndësishëm i komunikimit joverbal. Ruajtja e kontaktit me sy është gjithashtu e rëndësishme për ruajtjen e rrjedhës së diskutimit dhe për vlerësimin e përgjigjes së personit tjetër.



## Veshjet, stolitë, objektet

Shpesh, veshjet dhe objektet që njerëzit veshin flasin shumë rreth tyre, përveç të tjerash, për stilin, karakterin, profesionin, besimet, origjinën ose kulturën e tyre. Në procesin e të nxënësve, duhet të tregojnë kujdes që veshja ose objektet të mos jenë provokuese, të mos shpërqendrojnë vëmendjen e nxënësve dhe të mos shkaktojnë komente.

## Distanca

Mbajtja e distancës ndërmjet komunikuesve shpesh shihet si diçka e parëndësishme, duke harruar që distanca shumë e madhe mund të shkaktojë pengesa në komunikim dhe ulje të motivimit të bashkëbiseduesve, ndërsa distanca shumë e vogël mund të shkaktojë ndjenja të pakëndshme dhe shqetësuese. Në përgjithësi pranohet që duhet të mbahet një distancë prej të paktën një hapi.

- Distanca intime (nga prekja deri në 45 cm)
- Distanca personale (nga 45 cm deri në 1.2 m)
- Distanca sociale (nga 1.2 m deri në 3.6 m)

## Efekti i aureolës

Efekti i aureolës pasqyron përshtypjen e parë që lëmë kur takojmë një person për herë të parë, dhe ajo mund të reflektohet gjatë gjithë marrëdhënieve të tyre të ndërsjella dhe të ndikojë ndjeshëm në komunikim. Mund të përmirësojë por edhe të pengojë komunikimin. Shfaqja e Efektit të aureolës ndikohet nga pamja e përgjithshme e personit dhe përshtypja që ai/ajo lë: ngjashmëria me personat me të cilët ndajmë kujtime dhe emocione të mira ose të këqija, lartësia, pesha, lëvizjet, qëndrimi, tiparet e fytyrës, ngjyra e syve ose e flokëve, era, zëri, veshjet dhe detajet.

**Tabela 1.4: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Komunikimi joverbal
Synimi	<ul style="list-style-type: none"><li>– Të kuptuarit dhe të nxëniet e komunikimit joverbal.</li><li>– Demonstrimi i komunikimit joverbal dhe përshkrimi i rolit të tij në procesin e komunikimit.</li><li>– Të kuptuarit dhe shpjegimi i parimeve të komunikimit joverbal.</li></ul>
Metodat dhe teknikat	Ligjëratë, diskutime, moderim, prezantime.
Korniza kohore	60 min
Burimet e kërkuara	Letër tabelle, lapsa me ngjyra, projektor, televizor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint dhe televizor
Procedura	Zgjidhni një personalitet televiziv që e admironi. Çfarë dinë nxënësit për këtë person? Nxënësit e shikojnë këtë person për disa minuta me zërin e ulur dhe mbajnë shënime për shprehjet joverbale që vëzhgojnë. Ngrijeni zërin. Nxënësit mbajnë shënime për tonin e tij/saj të zërit, ritmin dhe shprehjet e tjera të dëgjueshme. Filloni një diskutim me nxënësit, rreth: <ul style="list-style-type: none"><li>– <b>Pozicioni i trupit:</b> A është trupi i qetë apo i ngurtë dhe i palëvizshëm? A janë supet e tensionuara dhe të ngritura, apo pak të pjerrëta?</li><li>– <b>Shprehja e fytyrës:</b> Çfarë tregon fytyra? A është si maskë dhe pa shprehje, apo emocionale dhe e mbushur me interes?</li><li>– <b>Gjestet:</b> A shoqërohet gjuha verbale me gjeste? A janë gjestet në sintoni me gjuhën verbale apo jo?</li><li>– <b>Drejtimi i shikimit:</b> A po bëhet kontakti me sy? Nëse po, a është tepër intensiv apo siç duhet?</li><li>– <b>Veshjet, objektet:</b> A ju irriton veshja apo jo?</li><li>– <b>Distanca:</b> A ka ndonjë kontakt fizik? A është i përshtatshëm për situatën?</li><li>– <b>Të folurit:</b> A dëgjoni tinguj që tregojnë kujdes ose shqetësim?</li></ul>

### **Sugjerime didaktike**

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
Demonstrim i gjuhës së trupit (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të komunikimit joverbal...

## **1.6 Gjuha paraverbale**

Përveç gjuhës verbale dhe joverbale, ekziston një lloj i tretë i shprehjes, përkatësisht gjuha paraverbale. Ajo përfshin të gjitha sinjalet e komunikimit të përfshira në volumin, ritmin dhe intonacionin e gjuhës verbale.

Gjuha paraverbale shkon më thellë në zbulimin e folësit. Na ndihmon të gjejmë shumë për vlerat, përvojat, ndjenjat, paragjykimet, frikën, ëndrrat dhe besimet e tij/saj.

Kur folësi është i sigurt për veten e tij, ai/ajo është i qetë dhe i sigurt. Zëri i tij/saj është i qartë dhe i këndshëm për t'u dëgjuar. Nga ana tjetër, kur është nervoz ose agresiv, ai/ajo flet më shpejt dhe shpesh me zë më të hollë. Frika dhe pasiguria manifestohen nga zëri më i ulur por më i hollë, kurse droja nga zëri i paqartë dhe shpesh i shuar

Sinjalet paraverbale nuk janë plotësisht të drejtpërdrejta ose të qarta. Gjatë komunikimit emocionet më të lehta për t'u zbuluar në zë janë frika dhe zemërimi. Sidoqoftë, ato mund të na japin informacion shtesë për bashkëbiseduesin tonë; për shembull nëse ai/ajo flet në një dialekt që zbulon origjinën ose kulturën e tij. Sinjalet paraverbale janë një tregues i shkëlqyeshëm për gjithçka që mendimi ynë i ndërgjegjshëm po përpiqet të fshehtë dhe nëse dikush po thotë të vërtetën apo jo.



- Të folurit me zë tepër të lartë krijon një përshtypje agresioni dhe zemërimi.
- Të folurit shumë të qetë është e lidhur me drojën, frikën ose personalitetin e dobët.
- Të folurit hundor (kur nuk shkaktohet nga një ftohje) mund t'i atribuohet dembelizmit ose arrogancës.
- Klithmat na bëjnë të dukemi të dobët ose hysterikë.
- Të folurit e rrëmbyer dhe me vendosmëri është i lidhur me persona dinamikë por edhe të pandjeshëm.
- Të folurit e butë krijon një përshtypje të butësisë dhe ndjeshmëri.

## Elemente të rëndësishëm të gjuhës paraverbale

### Ritmi:

Ritmi në të cilin flasim është i rëndësishëm për procesin e të nxënës. Nëse duam të veçojmë informacione të rëndësishme, atëherë duhet të flasim ngadalë, në mënyrë që nxënësit të mund të na kuptojnë mirë dhe të kuptojnë rëndësinë e informacionit për ta. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë se duhet të flasim ngadalë, sepse dëgjuesi do të lodhej shpejt dhe do të humbte interesin.

Të folurit e shpejtë siguron dinamizëm dhe vendosmëri, por dëgjuesit lodhen shpejt.

### Pauzat:

Përdorimi i pauzave gjatë të folurit është një mënyrë tjetër për të theksuar rëndësinë e informacionit. Pauza gjithmonë vjen pas informacionit të deklaruar. Sidoqoftë, pauzat nuk duhet të jenë shumë të gjata; mjafton që ato të zgjasin 3 deri në 5 sekonda.

### Emocionet:

Emocionet theksohen më lehtë në fjali të shkurtra. Fjalitë e gjata janë më të përshtatshme për mëtime.

### Besimet:

Gjuha paraverbale duhet të tregojë nëse dërguesi i mesazhit i beson apo jo. Të folurit me pasion i shoqëruar nga emocione pozitive u dërgon sinjale të qarta dëgjuesve se folësi i beson ato që ai/ajo thotë, dhe nuk mund të ketë dyshim për sinqeritetin e tij/saj. E folura e tillë mund të motivojë dhe të krijojë besim mes komunikuesve.

**Tabela 1.5: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Gjuha paraverbale
Synimi	Të kuptuarit dhe të nxënës e gjuhës paraverbale.
Metodat dhe teknikat	Ligjëratë, diskutime, moderim, prezantime.
Korniza kohore	30 min
Burimet e kërkuara	Letër tabelle, lapsa me ngjyra, projektor, televizor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint dhe televizor
Procedura	Zgjidhni një personalitet tjetër televiziv që e admironi. Çfarë dinë nxënësit për të shprehurit e tij/saj paraverbal? Nxënësit shikojnë disa minuta dhe mbajnë shënime për ndjenjat e tyre. Filloni një diskutim me nxënësit, për vlerat, përvojat, ndjenjat, paragjykimet, frikën, ëndrrat dhe besimet e saj/tij:

### **Sugjerime didaktike**

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
Lojë rolesh (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të komunikimit paraverbal...

## **1.7 Komunikimi në grup**

Komunikimi mes dy personave quhet dialog, kurse komunikimi brenda një grupi më shumë se dy persona quhet komunikim në grup. Në procesin e arsimit, grupi nuk duhet të jetë më i madh se 12 pjesëmarrës, sepse komunikimi efektiv është i vështirë për t'u arritur në grupe më të mëdha. Grupi karakterizohet nga marrëdhënie të forta ndërvepruese, vendosmëria e përbashkët drejt synimit, dhe ndjenja e përkatësisë dhe respektit të ndërsjellë. Komunikimi verbal dhe joverbal janë komponentë përbërës të komunikimit në grup.

Komunikimi i suksesshëm në grup është thelbësor në arsimin për të rritur. Për ta arritur atë, duhet të sigurohemi që anëtarët e grupit mund të vendosin kontakt me sy mes njëri tjetrit, që të gjithë mund të dëgjojnë të gjithë të tjerët dhe të shkëmbejnë ide me çdo anëtar tjetër të grupit. Zakonisht, pozicionimi i anëtarëve të grupit në një rreth (qoftë ulur ose në këmbë) mund t'i plotësojë këto kërkesa.



Kur synimi parësor i trajnimit është që mësuesi/trajneri të transmetojë dituri të reja te të gjithë anëtarët e grupit, ose kur nuk është e nevojshme që ata të mbajnë kontakte pamore, është e dëshirueshme të përdoret një aranzhim i ndryshëm i uljes. Në një rast të tillë, mësuesi/trajneri siguron informacione dhe anëtarët e grupit japin përgjigje individuale.

**Tabela 1.6: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

<b>Nën-tema</b>	<b>Komunikimi në grup</b>
<b>Synimi</b>	Të kuptuarit dhe të nxëniet e komunikimit në grup.
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, diskutime, punë në grup, moderim, prezantimet
<b>Korniza kohore</b>	30 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	Letër tabele, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	Luaj “Më gënje”, një lojë në të cilën secili person krijon tre deklarata (njëra është gënjeshtër) dhe i tregon të tre deklaratat një kolegu të kursit ose grupit. Dëgjuesit duhet ta marrin me mend se cila thënie është gënjeshtër.

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxëniet mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Teknikat Buzz (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të komunikimit në grup

## **Tema 2: Stilet e komunikimit**

Tema e dytë trajton temën më të gjerë të stileve të komunikimit, e cila mund të vrojtohet nga këndvështrime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme. Ajo ka disa nën-tema specifike të përqendruara në elemente të ndryshme të Temës kryesore dhe janë paraqitur në Udhëzues me përshkrime të synimeve të të nxënit dhe rezultateve të të nxënit.

Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe diturive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënit. Koha optimale për zbatimin e kësaj teme është 1 ditë.

Qëllimi kryesor i kësaj teme është të kuptohet komunikimi si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur, dhe larmia e tij në aspektin e formave dhe zbatimit, si dhe rëndësia e tij për të nxënit efektiv dhe zhvillimin personal.

**Tabela 2:** Nën-temat, synimet e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për zbatimin e temës:

**STILET E KOMUNIKIMIT**

*Synimi i të nxënit:* Të kuptuarit e domethënies dhe rëndësisë së Komunikimit si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur dhe diversitetin e tij në aspektet e: Struktura, organizimi, elementet kyçe, parimet dhe modelet e komunikimit dhe zhvillimi i shkathtësive të komunikimit për të nxënë më mirë dhe për të jetuar së bashku.

*Rezultati i përgjithshëm i të nxënit:* Pas përfundimit të kësaj teme, nxënësit e njohin diversitetin dhe shumëllojshmërinë e formave të arsimit dhe të nxënit të të rriturve, kuptojnë funksionet themelore të arsimit për të rritur dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në arsimin për të rritur.

Nën-tema	Synimi	Rezultati
<p><b>1. Stili i komunikimit</b></p>	<p>Identifikim dhe përshkrim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Stili i komunikimit agresiv.</li> <li>- Stili i komunikimit pasiv</li> <li>- Stili i komunikimit pasiv-agresiv</li> <li>- Stili i komunikimit të vendosur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit kuptojnë procesin e komunikimit.</li> <li>- Nxënësit i dinë komponentët thelbësorë të komunikimit.</li> <li>- Nxënësit mund t'i identifikojnë dhe përshkruajnë modelet e komunikimit</li> <li>- Nxënësit përmirësojnë shkathtësitë e tyre të vendosmërisë për komunikim</li> </ul>
<p><b>2. Gjinia dhe komunikimi</b></p>	<p>Identifikimi dhe përshkrimi i një larmie shkathtësish praktike komunikimi të përshtatshme për një komunikim të suksesshëm ndër-gjinor për të mbajtur marrëdhënie të shëndetshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit dinë një shumëllojshmëri të shkathtësive praktike të komunikimit të përshtatshme për një komunikim të suksesshëm ndër-gjinor</li> <li>- Nxënësit kanë ulur nivelin e shqetësimit në komunikim kur diskutojnë çështje gjinore.</li> </ul>
<p><b>3. Kultura dhe komunikimi</b></p>	<p>Prezantimi dhe analizimi i ndikimit të dallimeve kulturore në komunikim</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit përmirësojnë shkathtësitë dhe strategjitë e tyre për bashkëpunim multikulturor dhe punë ekipore.</li> <li>- Nxënësit do të njohin dhe demonstrojnë sjelljet që përfaqësojnë mendje të hapur.</li> </ul>
<p><b>4. Mediat e komunikimit</b></p>	<p>Prezantimi dhe analizimi i llojeve të ndryshme të mediave të komunikimit në arsimin për të rritur</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit janë në gjendje të dizajnojnë komunikimin përmes mediave të ndryshme.</li> <li>- Nxënësit i dinë implikimet e mediave të ndryshme në komunikim.</li> <li>- Nxënësit janë në gjendje të përdorin teknologjinë për të komunikuar në mënyrë efektive në mjedise dhe kontekste të ndryshme.</li> </ul>

## 2.1. Stili i komunikimit agresiv

Komunikuesit agresivë nuk kanë frikë t'i shprehin ndjenjat dhe opinionet e tyre dhe përpiqen t'i plotësojnë nevojat e tyre me çdo kusht, nëse është e nevojshme edhe përmes cenimit të të drejtave të tjerëve. Komunikuesi agresiv është i prirur ndaj abuzimit verbal dhe/ose fizik.

Në komunikim, ata duan t'i dominojnë të tjerët dhe t'i kontrollojnë ata; ata shpesh janë impulsivë, të ashpër dhe kërcënues. Janë të zhurmshëm dhe nuk janë dëgjues të mirë, ata kanë një prag të ulët tolerance dhe ju pëlqen t'i kritikojnë dhe poshtërojnë të tjerët dhe t'i fajësojnë për këtë. Gjuha e tyre trupore është kërcënuese dhe arrogante; ata nuk janë shumë të shoqërueshëm dhe ndihen rehat në një atmosferë frike dhe urrejtjeje, të cilën e shkaktojnë vetë.



Komunikuesi agresiv do të thotë, besojë ose sillet kështu:

- "Do të bëhet si them unë, nami le të bëhet."
- "Jam i zhurmshëm, komandant dhe i fortë".
- "Reagoj në sekondë."
- "Mund t'ju dominoj dhe t'ju frikësoj."
- "Mund t'i shkel të drejtat tuaja."
- "Ju nuk vleni asgjë."
- "Është i gjithë faji juaj".
- "Jam superior dhe kam të drejtë dhe ju jeni inferior dhe e keni gabim."
- "Më takon."

## 2.2. Stili i komunikimit pasiv

Komunikuesit pasivë bëjnë përpjekje të shmangin shprehjen e opinionëve dhe ndjenjave të tyre, kanë vështirësi në identifikimin dhe plotësimin e nevojave të tyre, nuk ngrihen për të drejtat dhe ndonjëherë madje heqin dorë prej tyre. Më shpesh, ata vendosin nevojat e njerëzve të tjerë përpara vetes dhe përpiqen të lënë përshtypje tek të tjerët.

Kur komunikojnë ata flasin butë, kërkojnë falje shpesh, shmangin kontaktin me sy dhe shfaqin pozicion pasiv të trupit. Shpesh shprehin ankth, sjellje depressive, zemërim të fshehur dhe konfuzion.

Nuk reagojnë hapur ndaj sulmeve dhe tërhiqen në situata që rezultojnë në reagime të zemëruara. Por nëse shkelet pragu i tyre i lartë i tolerancës, ata mund të reagojnë me dhunë dhe të shpërthejnë, dhe gjithashtu mund të jenë të prirur për incidente. Pas një episodi të mundshëm, komunikuesi pasiv e vë në dyshim vetveten, pendohet dhe ka turp për veprimet e tij/saj.



Një komunikues pasiv do të thotë, besojë ose sillet kështu:

- "Jam i dobët".

- “Nuk jam në gjendje të kujdesem për veten.”
- “Nuk jam në gjendje të mbroj të drejtat e mia.”
- “Më shkelin të gjithë.”
- “Njerëzit nuk i konsiderojnë kurrë ndjenjat e mia”.

### 2.3. Stil komunikimi pasiv-agresiv

Komunikuesit pasivë-agresivë janë pjesëmarrës në komunikim në dukje pasiv. Sidoqoftë, pas këtij pasiviteti fshihen zemërimi, zhgënjimi, hidhërimi ose ndjenja e pafuqisë. Këta komunikues u rezistojnë në mënyrë pasive kërkesave të jashtme, ndihen në “çark” dhe të paaftë të merren direkt me shkakun e hidhërimit të tyre, gjë që sjell një ndjenjë të paaftësisë, shfaqje të lehta të zemërimit, zgjatje të argumentit, kokëfortësi, dembelizëm dhe joefikasitet.



Kur komunikojnë, komunikuesit pasivë-agresivë shpesh tërhiqen pa bërë pyetje. Gjuha e tyre joverbale shpesh është në kundërshtim me gjuhën e tyre verbale. Ata e mbulojnë zemërimin dhe hidhërimin e tyre me sarkazëm ose përdorin shprehje të fytyrës që bien ndesh me ndjenjat e tyre (qeshin kur janë të zemëruar). Ato duken bashkëpunuese por qëllimisht shkaktojnë ankth dhe ndërprerje të komunikimit përmes “sabotimit” të lehtë.


Në proceset e të nxënies, për shkak të ndjenjës së pafuqisë dhe mungesës së besimit në kompetencat e tyre, ata shpesh përpiqen të krijojnë pengesa që nuk u lejojnë të tjerëve t’i arrijnë synimet e tyre.


Komunikuesi pasiv-agresiv do të thotë, besojë ose silltet kështu:

- “Do të dukem bashkëpunues, por nuk jam.”
- “Jam i dobët dhe inatçi, kështu që sabotoj, irritoj dhe prish”.
- “Jam i pafuqishëm të merrem direkt me ty, kështu që duhet të përdor luftën guerile.”

### 2.4. Stili i komunikimit të vendosur

Komunikimi i vendosur është spontan, i drejtpërdrejtë, i përgjegjshëm dhe i sinqertë. Individët i shprehin opinionin dhe ndjenjat e tyre në mënyrë të qartë dhe i mbrojnë fort të drejtat dhe nevojat e tyre, pa i cenuar të drejtat e të tjerëve në proces. Këta individë respektojnë veten, kohën e tyre, nevojat e tyre emocionale, shpirtërore dhe fizike, i dalin zot vetes dhe janë të përqendruar tek synimi, por në të njëjtën kohë respektojnë të drejtat e të tjerëve dhe kujdesen për ruajtjen e marrëdhënies.





Personi që zotëron shkathtësi të vendosmërisë komunikon hapur, sinqerisht dhe drejtpërdrejt dhe i shpreh idetë e tij, nuk tërhiqet, por gjithashtu nuk sulmon. Ai/ajo përballet me të tjerët, por gjithashtu bën çdo përpjekje për të gjetur një zgjidhje të përbashkët për situatat e konfliktit dhe merr përgjegjësinë për veprimet e tij/saj, pa ua hedhur fajin të tjerëve.

Komunikuesi i vendosur do të thotë, besojë ose sillet kështu:

- "Kam besim se kush jam."
- "I respektoj të drejtat e të tjerëve."
- "Kemi njësoj të drejtë të shprehemi me respekt ndaj njëri tjetrit."
- "Flas qartë, me ndershmëri, dhe për temën."
- "Jam përgjegjës për plotësimin e nevojave të mia duke qenë i respektueshëm."
- "Nuk mund t'i kontrolloj të tjerët, por mund ta kontrolloj veten time."
- "Për mua ka shumë rëndësi të respektohen të drejtat e mia."
- "E kuptoj që kam zgjedhje në jetën time dhe i konsideroj mundësitë e mia."
- "Askush nuk më ka borxh asgjë, përveç nëse janë pajtuar vetë të ma japin".
- "Jam përgjegjës për lumturinë time."

## Stilet e komunikimit

	<b>Pasiv</b>	<b>Agresiv</b>	<b>Pasiv-agresiv</b>	<b>I vendosur</b>
Aktiv për të arritur synimin vetanak?	Jo, strategji joefektive	Po, por në kurriz të të tjerëve	Po, por zakonisht tepër vonë dhe në mënyrë të papërshtatshme	Po, dhe në mënyrë të përshtatshme
Me respekt?	Komunikon apati ose nënshtrim	Jo, qëllimi është të lëndohen të tjerët	Jo, kryesisht fajëson	Po, edhe kur mbrojnë sigurinë e vetes
Dëgjimi i të tjerëve?	Ndoshta, por nuk përgjigjet në mënyrë aktive	Me gjasë i intereson më shumë këndvështrimi i vet	Ndoshta, por me qëllime të fshehura	Po, pastaj përgjigjet në kohën e duhur
Komunikon besimin?	Jo	Po, ndoshta tepër	Ndoshta kur vepron në mënyrë agresive	Po, për të vendosur kufijtë e duhur
Përdor komunikimin joverbal?	Po, tregon dobësi dhe cenueshmëri	Po, nga gjestet e kërcënimit deri tek lëndimi i të tjerëve	Po, e përdor për të manipuluar të tjerët	Po, për të forcuar komunikimin e duhur verbal
Përshtypja që u jepet të tjerëve?	Dobësi, apati	“Mangup”, “i poshtër”	Vështirë për t’u lexuar, i paparashikueshëm	E lehtë të merresh vesh me të, ka vetëbesim, është bashkëpunues
Përforcohet nga arritja e synimeve?	Po, përkohësisht, nëse synimi është të shmangët konflikti	Po, kënaqësi e menjëhershme, rezultat i dobët afatgjatë	Po, në kurriz të të tjerëve	Po, dhe përmirëson marrëdhëniet
Shembuj të ndërveprimit verbal	Nuk më intereson I heshtur	Hiqmu sysh Je budallë	Vetë e ke fajin Duhej të kische... Sarkazëm	Deklaratat “Unë” Kur është një kohë e mirë për të folur?

**Tabela 2.1: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

<b>Nën-tema</b>	<b>Stili i komunikimit</b>
<b>Synimi</b>	Identifikim dhe përshkrim: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Stili i komunikimit agresiv.</li> <li>- Stili i komunikimit pasiv</li> <li>- Stil komunikimi pasiv-agresiv</li> <li>- Stili i komunikimit të vendosur</li> </ul>
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, diskutime, punë në grup, moderim, prezantimet
<b>Korniza kohore</b>	90 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	Letër tabelle, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	<p><u>Vetë-vlerësimi</u></p> <p>Çdo nxënës duhet të bëjë vetëvlerësimin e mëposhtëm duke iu përgjigjur këtyre deklaratave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në përgjithësi jeni pasiv dhe heshtni. Asnjëherë nuk e deklaroni opinionin tuaj, si dhe atë që dëshironi ose keni nevojë, ose e bëni rrallë.</li> <li>- E keni të vështirë të thoni “Jo”</li> <li>- I mbani gjërat të kyçura brenda jush dhe në fund shpërtheni.</li> <li>- Sipas jush, mënyra e vetme për të arritur atë që ju nevojitet është duke qenë agresivë.</li> <li>- Mendoni se të tjerët përfitojnë nga ju ose ju japin tepër punë.</li> <li>- Në fund dorëzoheni dhe bëni si duan të tjerët.</li> <li>- E ndjeni se nuk respektoheni nga të tjerët.</li> <li>- Keni pak ose aspak respekt për veten, sepse nuk i komunikoni nevojat, dëshirat ose opinionet tuaja.</li> </ul>

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Kapelet e De Bono (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të stilit të komunikimit...

## 2.5. Gjinia dhe komunikimi

Një nga faktorët që ndikon në komunikim është gjinia e komunikuesit. Burrat dhe gratë kanë “rregulla të fshehta” që janë unike për gjininë e tyre përkatëse. Secila gjini është një “kulturë” më vete me rregulla “të padukshme” që janë unike për të. Një sjellje specifike që duket e natyrshme dhe e përshtatshme për njërin gjini, mund të duket e habitshme dhe e papranueshme për gjininë tjetër. Kjo “kulturë” e ndryshme shfaqet mes personave të seksit të ndryshëm që kanë jetuar në të njëjtën familje, kanë ndjekur të njëjtën shkollë dhe rriten në të njëjtin mjedis. Natyrisht që ka përjashtime, por nuk janë aq të zakonshme sa të kundërshtojnë ekzistencën e përgjithshme të dy kulturave të ndryshme mes grave dhe burrave.



Të kuptuarit e rregullave të padukshme për secilën gjini mund të ndihmojë në zgjedhjen e mënyrës më të mirë të mundshme të komunikimit.

- Stili i komunikimit. Në komunikimin joverbal, tundja e kokës do të thotë që gruaja është duke dëgjuar dhe jo se pajtohet, por burrat kujtojnë se ajo është dakord. Kur gruaja flet dhe burri nuk përgjigjet dhe qëndron në një pozitë neutrale në lidhje me gjuhën e trupit të tij, gruaja mund të mendojë se është i mërzitur dhe se ai nuk është i interesuar. Kjo mund të shkaktojë probleme komunikimi. Ajo mund të përsërisë atë që tha ose të pyesë “A e kuptove?” Nga ana tjetër, burri mund ta interpretojë këtë si një shenjë pasigurie ose dëshirë e tepruar për të folur.
- Mënyra e përpunimit të informacionit. Gratë, kur marrin vendime, shpesh shqyrtojnë opsionet dhe mundësitë e tjera, ndërsa burrat kanë tendencë ta përpunojnë informacione nga brenda derisa të marrin një vendim. Për shkak të kësaj, gratë shpesh besojnë se burrat janë të papërgjegjshëm dhe nuk reagojnë ndaj sugjerimeve, ndërsa burrat shpesh besojnë se gratë kërkojnë miratim sepse nuk janë të sigurta për atë që bëjnë.
- Marrëdhënia ndaj detyrave. Gratë së pari janë të orientuara drejt ndërtimit të marrëdhënieve dhe më pas drejt zgjidhjes së detyrës. Ato e dinë kë të pyesin dhe nuk hezitojnë t’u kërkojnë të tjerëve të punojnë. Burrat kanë një tendencë të jenë më të orientuar drejt detyrave dhe përqendrohen në përfundimin e saj të drejtpërdrejtë. Ata ndërtojnë marrëdhënie gjatë realizimit të detyrës.
- Gratë shpesh përdorin kontakt të drejtpërdrejtë me sy në komunikim. Ajo dëshiron të krijojë një marrëdhënie të përshtatshme, kurse burri do ta interpretojë këtë si një sfidë dhe shfaqje të pushtetit. Burrat e kuptojnë kontaktin e gjatë të syve si shumë personal ose agresiv, ndërsa gratë e kuptojnë shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë të syve si rezervim nga ana e burrit ose si një shenjë se ai po fsheh diçka.

**Tabela 2.2: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Gjinia dhe komunikimi
Synimi	Identifikimi dhe përshkrimi i një larmie shkathtësish praktike komunikimi të përshtatshme për një komunikim të suksesshëm ndër-gjinor për të mbajtur marrëdhënie të shëndetshme
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, punë në grup, moderim, prezantime, rast studimor ose teknikë Albatros.
Korniza kohore	30 min
Burimet e kërkuara	lapsa me ngjyra, letër
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	<p>Jepuni nxënësve një përshkrim të shkurtër të librit “Ana Karenina” nga L.N. Tolstoy. Mbajeni fokusin tek veprimet e Ana Kareninës dhe marrëdhëniet e saj me burrin dhe dashnorin e saj, pa ofruar opinionin apo gjykimin tuaj.</p> <p>Zgjidhni dy nxënës (mashkull dhe femër) të cilët do të marrin shënime për opinionet kryesore të nxënësve. Mashkulli duhet të regjistrojë opinionet e nxënësve femra, dhe femra duhet të regjistrojë opinionet e nxënësve meshkuj.</p> <p>Diskutoni me nxënësit tuaj opinionet e tyre mbi veprimet e Ana Kareninës. A janë të arsyeshme veprimet e saj apo jo?</p> <p>Në fund, mbajtësit e shënimeve të lexojnë opinionet e tyre. Diskutoni ndryshimet që shfaqen në opinionet e nxënësve meshkuj dhe femra.</p> <p>Ose</p> <p><b>Albatrosi:</b> është një aktivitet joverbal me lojë rolesh që mund të përfshijë një larmi temash, siç janë marrëdhëniet mashkull-femër dhe privilegji. Pjesëmarrësve u kërkohet të shikojnë një lojë të shkurtër rolesh dhe pastaj të përshkruajnë atë që panë. Shumica do të interpretojnë ato që panë dhe do të fillojnë t’i gjykojnë personazhet në rol vetëm me ato që kanë parë, ndërkohë që nuk kanë dëgjuar asgjë. Ky ushtrim jep një shembull të mirë se si njerëzit u japin kuptim ngjarjeve unike bazuar në përvojat e tyre personale.</p>


**Sugjerime didaktike**

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Rast studimor (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të gjinisë në komunikim...

## 2.6. Kultura dhe komunikimi

Dialogu ndërkulturor është një proces që përfshin shkëmbim të hapur dhe respektues mes individëve, grupeve dhe organizatave me prejardhje të ndryshme kulturore ose pikëpamje për botën. Ndër synimet e tij janë: të zhvillohet i kuptuar më i thellë të këndvështrimeve dhe praktikave të ndryshme; të rritet pjesëmarrja (ose liria për të bërë zgjedhje); të sigurohet barazi; dhe të përmirësohen proceset krijuese.<sup>3</sup>

Në të njëjtën kohë, mungesa e njohurive për një kulturë tjetër mund të çojë, në rastin më të mirë, në gabime të sikletshme ose zbavitëse në komunikim. Individët që merren me njerëz nga kultura të tjera dëshirojnë të mësojnë se si të përmirësojnë performancën e tyre përmes përmirësimit të shkathtësive të tyre të komunikimit.



Është e rëndësishme që praktikatat të formësohen për të parë përtej stereotipit, kundërshtimit binar, thjeshtësimit, rregullsisë dhe pritshmërisë, dhe të shikohen detajet, interpretimi diskriminues, angazhimi personal dhe kritik, dhe ndjeshmëria ndaj përfaqësimeve të shumta në botë. Përmes eksplorimit të identiteteve të tjera kulturore, ofrohen mundësi për të njohur pikat e ngjashmërisë mes kulturave që mund jetë të fshehura ose jo menjëherë të dukshme. Fokusi është në eksplorimin ku takohen kulturat dhe zhvillojnë dituri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që mundësojnë ndërveprimin dhe negociimin mes tyre. Ky proces i të kuptuarit të të tjerëve kërkon vetë-reflektim dhe konfrontim dhe dekonstruktiv të pikëpamjeve stereotipike nganjëherë të ngulitura thellë. Ai sfidon si nxënësit ashtu edhe mësuesin që të kuptojnë se si ndërtohen pikëpamjet dhe të vlerësojnë se pikëpamjet për veten janë ndërtuar në lidhje me mënyrën se si ne i shohim të tjerët.

Komunikimi ndërkulturor është sfidues. Dhe ndërsa disa nga njohuritë për kulturën, rregullat, besimet, vlerat, fobitë dhe ankthet mësohen në mënyrë të qartë, shumica e informacioneve thithen nëndërgjegjshëm.

I gjithë komunikimi ndërkombëtar është i ndikuar nga dallimet kulturore. Edhe zgjedhja e mediumit të komunikimit mund të ketë tone kulturore.

Mësuesin duhet të jenë të përgatitur për të lehtësuar në mënyrë efektive të nxënësve për çdo nxënësit individual, pavarësisht nga ngjashmëritë apo dallimet e tyre kulturore.

Arsimtarët, aktivistët dhe të tjerët duhet të luajnë një rol më aktiv në rishqyrtimin e të gjitha praktikave arsimore dhe se si ato ndikojnë në të nxënësve të gjithë nxënësit: metodat e vlerësimit, pedagogjitë, psikologjinë dhe praktikatat e këshillimit, materialet arsimore dhe librat shkollorë, etj.

<sup>3</sup> Përmbledhje e Politikave Kulturore dhe Tendencave në Evropë,  
<http://www.culturalpolicies.net/web/intercultural-dialogue.php> (12.11.2011)

**Tabela 2.3: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

<b>Nën-tema</b>	<b>Kultura dhe komunikimi</b>
<b>Synimi</b>	Prezantimi dhe analizimi i ndikimit të dallimeve kulturore në komunikim
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjërata, diskutime, punë në grup, moderim, Ecotonos: Një simulim për bashkëpunimin mes kulturave
<b>Korniza kohore</b>	60 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	lapsa me ngjyra, letër
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ecotonos i thyen stereotipat dhe pengesat e zakonshme. Ecotonos mund të përdoret shumë herë me të njëjtët njerëz duke zgjedhur një problem të ri dhe ndryshorë të ndryshëm, me secilën përsëritje që ofron këndvështrime të reja dhe të ndryshme ndërkulturore.</li> </ul> <p>Hapat</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit formojnë tre grupe dhe krijojnë kulturat e tyre.</li> <li>- Pjesëmarrësit fillojnë të punojnë në grupet e tyre monokulturore</li> <li>- Pastaj përzieni grupet për të vazhduar detyrën në mënyrë multi-kulturore.</li> </ul>

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 BAFA BAFA, Lojë rolesh (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të komunikimit ndërkulturor

## 2.7. Mediumi i komunikimit

Njerëzit në të vërtetë janë duke u bërë më socialë dhe më ndërveprues me të tjerët, por stili i komunikimit ka ndryshuar kështu që ne nuk po takohemi ballë për ballë aq shpesh sa dikur.

Kur ndryshon një medium i komunikimit, ndryshojnë edhe praktikat dhe përvojat tona të komunikimit. Teknologjia e të shkruarit e çliroi komunikimin njerëzor nga mediumi i ndërveprimit ballë për ballë. Ky ndryshim ndikoi si në procesin ashtu edhe në përvojën e komunikimit, pasi personat nuk kishin më nevojë të ishin fizikisht të pranishëm për të komunikuar me njëri-tjetrin. Teknologjia e shtypshkronjës promovoi më tej mediumin e shkrimit duke mekanizuar krijimin dhe shpërndarjen e fjalës së shkruar. Kështu filloi forma e re e komunikimit në masë të pamfleteve, gazetave dhe librave të lirë, në kontrast me mediumin e dokumenteve dhe librave të shkruar me dorë. Kohët e fundit, mediumi i teknologjisë digjitale e ka ndryshuar përsëri procesin dhe përvojën e komunikimit njerëzor.<sup>4</sup>



Disa nga metodat e mëparshme të përdorura për komunikim ishin pamore dhe zanore në formën e gjeesteve, tingullit dhe fotografive/vizatimeve. Teknologjia sot i ka shndërruar këto tinguj dhe gjeeste për të prodhuar të folur, video, filma, posterë dhe teatër. Evolucioni i mjeteve të ndryshme ka hapur një potencial të gjerë për komunikim. Me këtë bollëk mjeteve dhe metodash për t'u përdorur, komunikuesi mund ta ketë të vështirë të zgjedhë një të përshtatshëm.

Mediumi i komunikimit u referohet mjeteve për të dhënë dhe marrë të dhëna ose informacion. Mediumi i komunikimit vepron si një kanal komunikimi për lidhjen e pajisjeve të ndryshme informatike në mënyrë që të bashkëveprojnë me njëra tjetrën.

Mediumi i përdorur për të dërguar një mesazh mund të shkojë nga zëri i një individi, shkrimi, veshmbathja dhe gjuha e trupit, tek format e komunikimit masiv siç janë televizioni dhe Interneti.

Kanalet tradicionale të mediave masive si TV, radio dhe revista, nga ana tjetër, promovojnë komunikim një me shumë. Mediat bashkëkohore të komunikimit lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave mes një numri të madh të individëve në distanca të gjata përmes postës elektronike, telekonferencave, forumeve online, etj.

Është e rëndësishme të jesh i vetëdijshëm për kategoritë e mediave vizive, sepse arsimtarët profesionistë për të rritur kanë mjaft raste për t'i; ato përfshijnë: foto, kukulla, dramë, shfaqje rruge dhe lojë rolesh, kaseta zanore, video, media transmetuese dhe telekonferenca.<sup>5</sup>

<sup>4</sup> Paula S. Tompkins, *Etika e Praktikimit të Komunikimit: Zhvillimi, dallimi dhe vendimmarrja*. Routledge, 2016

<sup>5</sup> Unesco, *Paketa e të Nxënësve për të Nxënës Pjesëmarrës të të Rriturve*, Dokumentacioni dhe Rrjetëzimi për Informacion (Paldin) Shpërndarja e Dokumentacionit dhe Rrjetëzimi, Kursi 02, Njësia 13

- Kontakti telefonik - kërkon shkathtësi të mira verbale dhe vetëdije për tonet e zërit si komunikim joverbal.
- Letra - kërkon shkathtësi shkrimi.
- E-mail - duhet të jetë i shkurtër dhe të hyjë drejt e në temë, të mos humbet në fjalë boshe. Mund të kërkojë përcjellje të shpeshtë.
- Njoftim për shtyp - kërkon shkathtësi për të shkruar, bashkëpunim të mediave dhe kohë.

**Tabela 2.4: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Mediumi i komunikimit
<b>Synimi</b>	Prezantimi dhe analizimi i llojeve të ndryshme të mediave të komunikimit në arsimin për të rritur
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, diskutime, punë në grup, moderim,
<b>Korniza kohore</b>	30 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	lapsa me ngjyra, letër,
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	<p><b>Palosja e letrës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Jepini të gjithëve një fletë letre.</li> <li>- Thuajini të gjithëve që të mbyllin sytë dhe të ndjekin udhëzimet tuaja.</li> <li>- Filloni të jepni udhëzime se çfarë të bëjnë me letrën, p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> <li>o paloseni përgjysmë</li> <li>o paloseni këndin e poshtëm të majtë mbi këndin e sipërm të djathtë</li> <li>o kthejeni 90 gradë në të majtë</li> <li>o paloseni përsëri</li> <li>o grisni një gjysmë rrethi në mes të anës së djathtë etj.....</li> </ul> </li> <li>• Pasi të keni dhënë mjaft udhëzime (më shumë se 10 të paktën për një sukses të madh), thuajini të gjithëve që të hapin sytë dhe të shpalosin copën e tyre të letrës.</li> <li>• Edhe pse të gjithë morën të njëjtat udhëzime dhe kishin të njëjtin material fillestar, pothuajse të gjithë do të kenë një rezultat të ndryshëm.</li> <li>- Përsëriteni ushtrimin; tani jepni atyre udhëzimet e njëjta përmes një fotografie/vizatimi.</li> <li>- Kontrolloni dhe krahasoni rezultatet. Diskutoni se cili medium është më i përshtatshëm për transmetimin e të njëjtit informacion.</li> </ul>

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
Rast studimor (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të mediave të komunikimit

### Tema 3: Teoria e komunikimit dhe pengesat në komunikim

Tema e tretë trajton fushën më të gjerë të arsimit për të rritur, e cila mund të vrojtohet nga këndvështrime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme. Kjo temë trajton gjithashtu fushën më të gjerë të pengesave të komunikimit. Ajo ka disa nën-tema specifike të përqendruara në elemente të ndryshme të temës kryesore dhe janë paraqitur në Udhëzues me përshkrime të synimeve të të nxënit dhe rezultateve të të nxënit.

Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe diturive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënit. Koha optimale për zbatimin e kësaj teme është 1 ditë.

Qëllimi kryesor i kësaj teme është të kuptohet Teoria e komunikimit dhe pengesat në komunikim si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur, dhe larmia e tyre në aspektin e formave dhe zbatimit, si dhe rëndësia e tyre për komunikim efektiv.

**Tabela 3:** Nën-temat, synimet e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për zbatimin e temës: **TEORIA E KOMUNIKIMIT DHE PENGESAT NË KOMUNIKIM**

<p><i>Synimi i të nxënit:</i> Të kuptohet domethënia dhe rëndësia e komunikimit si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur, dhe larmia e tij në aspektin e : strukturës, organizimit, elementeve kyçe, parimeve dhe modeleve të komunikimit, dhe zhvillimit të shkathtësive të komunikimit për të nxënë më mirë dhe për të jetuar së bashku.</p> <p><i>Rezultati i përgjithshëm i të nxënit:</i> Pas përfundimit të kësaj teme, nxënësit e njohin diversitetin dhe shumëllojshmërinë e formave të arsimit dhe të nxënit të të rriturve, kuptojnë funksionet themelore të arsimit për të rritur dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në arsimin për të rritur.</p>		
Nën-tema	Synimi	Rezultati
1. Teoria e komunikimit	Prezantimi i teorive bazë të komunikimit dhe implikimeve të tyre për procesin e të nxënit të të rriturve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit e dinë thelbin dhe parimet e teorive bazë të komunikimit dhe i lidhin ato me të nxënit e të rriturve.</li> <li>- Nxënësit janë në gjendje t'i zbatojnë teoritë e komunikimit.</li> </ul>
2. Pengesat në komunikim	Paraqitja e pengesave në komunikim dhe implikimet e tyre në procesin e komunikimit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit janë në gjendje t'i njohin dhe shpjegojnë pengesat në komunikim.</li> <li>- Nxënësit janë në gjendje t'i parandalojnë pengesat në komunikim.</li> </ul>

### 3.1. Teoria e komunikimit

Teoritë ofrojnë të kuptuarit abstrakt të procesit të komunikimit. Shumica e humanistëve besojnë se njerëzit kanë kontroll mbi sjelljen e tyre; ata besojnë se njerëzit bëjnë *zgjedhje të vetëdijshme* për të komunikuar për të përmbushur synimet e tyre. Teoricienët që mbajnë këtë qëndrim quhen pragmatistë sepse besojnë se njerëzit janë praktikë dhe se ata e planifikojnë sjelljen e tyre. Shkurt, pragmatistët besojnë se qeniet njerëzore nuk janë reaktorë pasivë ndaj situatave, por aktorë dinamikë. Atëherë, humanistët priren të përqendrohen në zgjedhjet që bëjnë njerëzit.

Idetë e John Dewey mbi arsimin, përvojën dhe komunikimin përbëjnë tre shtyllat kryesore të arsimit për të rritur dhe të nxënit gjatë gjithë jetës. Dewey e konsideroi arsimin si një proces të rritjes së kuptimit, përgjegjësisë sociale dhe pjekurisë dhe thoshte, “i gjithë edukimi i mirëfilltë vjen përmes përvojës”. Përvoja jep kuptim; një person mund të gjejë kuptime të shumta të një sendi, madje edhe të pafundme, dhe ta përdorë atë në përputhje me rrethanat. Kuptimi gjithashtu mund të tregojë pasojat dhe marrëdhëniet e ngjarjeve dhe gjërave. Gjatë gjithë jetës së tyre, njerëzit kërkojnë të kuptojnë botën e tyre dhe të ndajnë (komunikojnë) kuptimet e tyre. Edukimi dhe komunikimi nënkuptojnë kështu një proces shoqëror dhe historik të kuptimit dhe qëllimeve të përbashkëta. Sipas filozofisë së Dewey, arsimi, komunikimi dhe përvoja përbëjnë një treshe në një mjedis demokratik dhe shërbejnë për të ruajtur vazhdimësinë e një kulture. Arsimi, komunikimi dhe përvoja janë kështu mjete të fuqishme për mobilizimin e një komuniteti drejt të nxënit gjatë gjithë jetës dhe drejt transformimit shoqëror. Dewey gjithashtu na siguron elementet kryesore të idealit të tij demokratik i cili konsiston në (a) ekzistencën e qëllimeve të vërteta të përbashkëta brenda anëtarëve të një organizate ose një komuniteti; (b) liria për të komunikuar me njëri tjetrin dhe me grupet e tjera; dhe (c) përvoja të vërteta edukative, të cilat promovojnë rritjen personale dhe sociale.<sup>6</sup>



Për Paulo Freire, verbalizmi është një fjalë boshe, që do të thotë fjalë pa veprim. Sipas tij, transformimi nuk mund të ndodhë vetëm me veprim, kërkon edhe reflektim. Transformimi i bazuar në aktivizëm të pastër është i pamundur, sepse pa reflektim nuk mund të ketë asnjë angazhim për transformimin; do të ishte një veprim i zbrazët. Transformimi kërkon praktikë, e cila është veprim dhe reflektim. Vetëm praktika e mundëson të bëhet transformimi.<sup>7</sup>



Freire (1972: 62) pohoi se ‘Dialogu nuk mund të ekzistojë pa përlësi’. Nuk mund të dialogoni nëse e vendosni veten mbi një tjetër, duke e parë veten si pronar të së vërtetës. Dialogu kërkon besim te njerëzimi. “Besimi është një kërkesë apriori për dialog.” Për Freire (1972: 63-72), “Duke u bazuar tek dashuria, përlësia dhe besimi, dialogu bëhet një marrëdhënie horizontale, për të cilën besimi i ndërsjellë ndërmjet dialoguesve është pasoja logjike”. Dialogu kërkon më tej shpresë në mënyrë që të ekzistojë. “Humbja e shpresës është një formë heshtjeje, për të mohuar botën dhe për të ikur prej saj”. Më në fund, një


<sup>6</sup> Unesco, Paketa e të Nxënit për të Nxënit Pjesëmarrës të të Rriturve, Dokumentacioni dhe Rrjetëzimi për Informacion (Paldin) Shpërndarja e Dokumentacionit dhe Rrjetëzimi, Kursi 01, Njësia 4

<sup>7</sup> Po aty

‘dialog i vërtetë nuk mund të ekzistojë nëse nuk përfshin të menduarit kritik’. ‘Pa dialog nuk ka komunikim dhe pa komunikim nuk mund të ketë edukim të vërtetë’.<sup>8</sup>


## Teoria bazë e komunikimit

Teoria matematike e komunikimit është një teori shumë me ndikim dhe quhet teori elektronike e komunikimit. Kjo ide thekson problemet teknike të transmetimit të një mesazhi nga një dërgues te një marrës dhe ndërhyrjes së mundshme. Ajo përdor gjuhën e elektronikës. Mesazhi fillon me një burim informacioni, mendjen e dërguesit që kodon një mesazh në fjalë dhe fjali. Mesazhi transmetohet si sinjal përmes një kanali, ku mund të shtrembërohet nga zhurma.




Si hap i fundit, marrësi (dëgjuesi ose lexuesi) e deshifron mesazhin. Kjo teori prezanton idetë e dërguesve dhe marrësve dhe ndërhyrjeve të mundshme. Ajo thekson një aspekt të rëndësishëm të komunikimit: saktësinë. Dobia e saj është e kufizuar. Dikush mund të shprehë një ide me saktësi, por tjetri mund të mendojë se ai nuk ka të drejtë të flasë.

Teoria e komunikimit në mjedisin shoqëror është e shkencëtarëve socialë dhe të sjelljes. Ajo thotë se duhet të kemi parasysh situatën, kontekstin social në të cilin do të punojmë. Kur punojmë dhe komunikojmë së bashku, ne të gjithë marrin pjesë në një situatë sociale, brenda asaj situate; secili pajtohet të luajë role të caktuara - siç janë “kompromisbërësi”, “nismëtar” ose “inkurajuesi” - bazuar në pjesën që luajnë në aktivitet. Secili prej nesh ka një status të caktuar të përshkruar zyrtarisht, siç është titulli i punës. Ne duhet të kuptojmë rregullat, ose “kulturën” e mjedisit në mënyrë që të komunikojmë: si rregullat zyrtare - siç janë politikat dhe praktikrat e ndërmarrjes - ashtu edhe ato rregulla të pashkruara në lidhje me kë, si, kur, dhe për sa kohë është e përshtatshme për ne të komunikojmë brenda një organizate të caktuar. Brenda një mjedisi të caktuar, teoria e mjedisit social është e dobishme sepse shton dimensionin e rëndësishëm të situatës specifike shoqërore. Një mesazh i përshtatur bukur mundet të dështojë në arritjen e objektivit të tij nëse i shkruani personit të gabuar në kohën e gabuar.



Teoria retorike e komunikimit bazohet në mjetet e mundshme të bindjes. Thotë se procesi i komunikimit nuk është linear, por rrethor. Komunikimi nuk është vetëm dërgimi i një mesazhi që do të pritët, por prodhon një përgjigje. Pra, një folës që është i interesuar ta bindë audiencën e tij/saj duhet të marrë parasysh tre prova retorike: logjike, emocionale dhe etike. Edhe audiencia është thelbësore për bindjen efektive. Edhe sillogjizmi retorik, që kërkon nga publiku të sigurojë pjesë të një fjalimi që mungon, përdoret në bindje.



<sup>8</sup> Po aty

Teoria e akomodimit të komunikimit shqyrton motivimet themelore dhe pasojat e asaj që ndodh kur dy folës ndërrojnë stilet e tyre të komunikimit. Teoricienët e akomodimit në komunikim argumentojnë se gjatë komunikimit, njerëzit do të përpiqen të akomodojnë ose të rregullojnë stilin e tyre të folurit me të tjerët. Kjo bëhet në dy mënyra: divergjenca dhe konvergjenca. Grupet me krenari të fortë etnike ose racore shpesh përdorin divergjencën për të nxjerrë në pah identitetin e grupit. Konvergjenca ndodh kur ekziston një nevojë e fortë për miratim shoqëror, shpesh nga individë të pafuqishëm.

Teoria e shkëmbimit social argumenton se forca madhore në marrëdhëniet ndërpersonale është plotësimi i interesit të të dy njerëzve. Teoricienët e shkëmbimit social pohojnë se interesi vetjak nuk është domosdoshmërisht një gjë e keqe dhe se ai në të vërtetë mund t'i forcojë marrëdhëniet. Qasja e Shkëmbimit Social shikon shkëmbimet ndërpersonale si analoge me shkëmbimet ekonomike ku njerëzit janë të kënaqur kur marrin një kthim të drejtë për shpenzimet e tyre.

Teoria e gjykimit shoqëror<sup>9</sup> deklaron që ju keni një deklaratë ose mesazh dhe ju e pranoni ose e refuzoni bazuar në hartën tuaj kognitive. Ju e pranoni ose refuzoni një mesazh të bazuar në përfshirjen e egos suaj, dhe nëse ai bie brenda pragut tuaj të pranimit.

Konstruktivizmi<sup>10</sup> argumenton se njerëzit me kognicion kompleks në perceptimin e tyre për të tjerët kanë një kapacitet më të madhe për komunikim të sofistikuar që do të arrijë rezultate pozitive. Ata mund të përdorin një logjikë të dizajnit të mesazheve retorike që krijon mesazh me personin në qendër dhe që njëkohësisht ndjek synime të shumta komunikimi.

Konstruktivizmi lejon të vërteta të shumëfishta në varësi të aftësive të komunikuesit dhe marrësit për krijimin dhe kuptimin e mesazheve komplekse kognitive. Disa njerëz (humanistë) kanë aftësinë për të vepruar duke përdorur logjikën retorike të projektimit, ndërsa të tjerët (shkencorë) janë të detyruar të reagojnë përmes përdorimit të logjikës ekspresive ose konvencionale të dizajnit. Kjo teori është e vetëdijshme për vlerën, sepse ndërsa njeh kapacitetin për ndikimin e vlerës, ajo nuk mbështet ndonjë model të veçantë.

Ata që janë me kognicion më kompleks në formimin e tyre të mesazheve, janë më të aftë të arrijnë synimet e tyre të komunikimit ndërpersonal. Këta njerëz janë gjithashtu më të përshtatshëm për interpretimin e mesazheve në një mënyrë më të qartë.

---

<sup>9</sup> Sherif, M., & Hovland, C.I. (1961). Gjikimi shoqëror. New Haven, CT: Yale University Press.

<sup>10</sup> Delia, J. O'Keefe, B., & O'Keefe, D. (1982). Qasja konstruktiviste ndaj komunikimit. Teoria e komunikimit njerëzor. New York: Harper and Row, 147-91.

**Tabela 3.1: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

<b>Nën-tema</b>	<b>Teoria e komunikimit</b>
<b>Synimi</b>	Prezantimi i teorive të komunikimit dhe implikimeve të tyre për procesin e të nxënësve të rriturve.
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, diskutime, punë në grup, moderim,
<b>Korniza kohore</b>	30 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	lapsa me ngjyra, letër,
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	Mësimdhënësi do të jetë përgjegjës për lehtësimin e një mësimi që tregon një teori dhe parim specifik të komunikimit. Gjatë kësaj kohe, nxënësit do të jenë përgjegjës për (a) shpjegimin e themeleve të teorisë dhe parimeve të komunikimit, (b) aplikimin e teorisë dhe parimeve në komunikimin në jetën reale dhe komunikimin në grup, (c) diskutimin se si teoria informon hulumtimin dhe praktikën, dhe (d) angazhimin e nxënësve në një mënyrë ndërvepruese për të përmirësuar të kuptuarit e teorisë.

***Sugjerime didaktike***


Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Rast studimor (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të teorisë së komunikimit...

## 3.2. Pengesat në komunikim

Llojet e përgjithshme të pengesave për komunikim efektiv:

### – Pengesat gjuhësore

Edhe gjatë komunikimit në një gjuhë, terminologjia e përdorur në mesazh mund të bëhet pengesë për të kuptuarit e duhur dhe të plotë nga nxënësit. Nëse një mesazh përmban një numër të madh frazash specifike, shkurtime ose terminologji profesionale, ekziston risku që ai të mos kuptohet nga nxënësit që nuk e njohin terminologjinë e përdorur. Ndonjëherë, përdorimi i dialekteve ose frazave lokale ose rajonale mund të keqkuptohet ose madje të konsiderohet fyes.



Të folurit në mënyrë të paqartë, me zë shumë të ulët ose shumë të lartë, ekzistenca e dallimeve ose vështirësive për të kuptuar thekse të panjohura ose përdorimi i zhargonit mund të jenë pengesa serioze për komunikimin.

### – Pengesat emocionale

Disa njerëz mund të kenë vështirësi për të shprehur emocionet e tyre, dhe tema të veçanta mund t'i bëjnë të ndjehen në siklet.

Gjendja psikologjike e komunikuesve ndikon në mënyrën si dërgohet, pranohet dhe kuptohet mesazhi. Për shembull, nëse një nxënës është nën stres, i irrituar, i trishtuar, i zemëruar ose i preokupuar nga problemet personale, atëherë ai/ajo nuk do ta pranojë një mesazh të dhënë, ose pranimi i tij/saj ndryshon nga situata kur ai/ajo nuk do të jetë në këtë gjendje psikologjike. Për më tepër, nxënësit me vetë-vlerësim të ulët mund të jenë më pak ndërhyrës dhe si të tillë mund të mos ndihen të qetë në atë komunikim. Njerëz të tillë shpesh janë të trembur dhe e fshehin gjendjen e tyre emocionale, dhe në disa raste janë të prirur për të lexuar nëntekste negative në mesazhet që iu dërgohen.



### – Prejardhje të ndryshme

Të gjithë nxënësit nuk janë të njëjtë. Ato mund të ndryshojnë, ndër të tjera, në prejardhjen dhe përvojën e tyre arsimore, fetare, gjinore dhe sociale. Këto ndryshime e bëjnë më të vështirë detyrën e mësimit kur transmetojnë mesazhe për ta. Dilemat përqendrohen në pyetjen se si mund të transmetohet përmbajtja e një mesazhi të vetëm në mënyrë që të gjithë marrësit të mund ta pranojnë dhe të kuptojnë kuptimin e tij të vërtetë pavarësisht nga dallimet që ekzistojnë mes tyre.

### – Mungesa e vëmendjes, interesit, ose devijimi i vëmendjes së marrësit

Arsimi për të rritur kryesisht kushtëzohet nga niveli i motivimit të nxënësve. Nëse motivimi për të nxënë është i ulët, atëherë edhe gatishmëria e të rriturve për të marrë pjesë në të nxënë është e ulët. Ata do të tregojnë vëmendje dhe interes të dobët për atë që u transmetohet si mesazh. Individë të tillë janë të prirur për tërheqjen e vëmendjes.

Ndonjëherë, vëmendja e tyre mund të tërhiqet për shkak të lidhjeve të caktuara shoqërore, të tilla si një ngjarje e rëndësishme që preokupon vëmendjen e tyre në një moment të veçantë.

Ulja e interesit dhe vëmendja e dobët mund të shkaktohet nga dërguesi i mesazhit. Nëse mesazhi nuk është zgjedhur mirë, nëse është i formatuar dobët ose i dërguar përmes kanalit të gabuar, atëherë ai mund të shkaktojë rënie të interesit dhe vëmendjes së marrësit.

#### – Zgjedhja e gabuar e mediumit

Ekziston një medium i duhur për secilin mesazh, përmes të cilit mund të arrijë më së miri tek objektivi i tij. Nëse mesazhi kodohet dhe dërgohet përmes një mediumi që është i papërshtatshëm për marrësin, atëherë mesazhi nuk mund të deshifrohet dhe nuk mund të arrijë tek objektivi i dëshiruar. Një shembull i zgjedhjes së gabuar të mediumit është përdorimi i Internetit me marrës të cilët nuk kanë njohuri për këtë medium.

#### – Dallimet në perceptim dhe këndvështrim

Dallimet në perceptim dhe pikëpamje mund të vijnë nga përvoja, qëndrime, kultura dhe vlera të ndryshme mes dërguesit dhe marrësit të mesazhit.

#### – Paaftësia fizike

Rrjedha e komunikimit mund të priset nëse marrësi i mesazhit ka probleme dëgjimi ose pengesa në të folur. Risetë moderne teknologjike mund të ndihmojnë në kapërcimin e kësaj pengese komunikimi.

#### – Pengesat fizike

Një numër i pengesave fizike mund të pengojnë komunikimin, kryesisht kushte të papërshtatshme të punës në dhomën ku kryhet procesi i arsimit dhe që rrjedhin nga faktorë të tillë si dhoma e vogël, ndriçimi i dobët, temperatura e pa rregulluar, prania e zhurmës, ngjarjet e objekteve që largojnë vëmendjen, distanca gjeografike mes dërguesit dhe marrësit, etj.



Megjithëse teknologjia moderne shpesh përdoret për të ulur ndikimin e pengesave fizike, avantazhet dhe disavantazhet e secilit kanal komunikimi duhet të shqyrtohen me kujdes në mënyrë që të zgjidhet më i përshtatshmi, ai që ndër të tjera ndihmon në eliminimin e pengesave fizike.

#### – Pengesat fizike në komunikimin joverbal

Shpesh, paaftësia për të vërejtur shenjat joverbale, gjestet, qëndrimin e trupit dhe gjuhën e trupit, mund ta bëjë komunikimin më pak efektiv. Kjo është një mangësi e madhe e komunikimit që kalon nëpër disa kanale indirekte, të tilla si telefoni ose tekstet e shkruara.

#### – Pritjet dhe paragjykimet

Pritjet e ndryshme nga efektet e komunikimit ose të nxënit e përgjithshëm mund t'i çojnë marrësit në supozime ose stereotipa të gabuara. Njerëzit shpesh dëgjojnë atë që ata presin të dëgjojnë, dhe jo atë që thuhet, gjë që mund t'i çojë në përfundime të gabuara.

#### – Dallimet kulturore

Normat e ndërveprimit shoqëror ndryshojnë shumë në kultura të ndryshme, dhe kështu ndryshojnë edhe mënyrat me të cilat njerëzit i shprehin emocione.

**Tabela 3.2: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

<b>Nën-tema</b>	<b>Pengesat në komunikim</b>
<b>Synimi</b>	Paraqitja e pengesave në komunikim dhe implikimet e tyre në procesin e komunikimit.
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjërata, diskutime, punë në grup, moderim,
<b>Korniza kohore</b>	60 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	tabelë e bardhë, lapsa me ngjyra, stilolaps dhe letër për secilin nxënës,
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndajeni grupin në ekupe prej 3 ose 4 personash.</li> <li>- Secilit ekipi i kërkohet të gjejë një zgjidhje praktike për heqjen e pengesave të dëgjimit, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>o Personat që punojnë në zyra ose ambient të izoluar</li> <li>o Ballafaqimi me një klient që flet shumë</li> <li>o Puna në një vend pune të zhurmshëm</li> <li>o Ballafaqimi me një klient të irrituar</li> <li>o Ballafaqimi me shpërqendrimet vizive në vendin e punës</li> </ul> </li> <li>- Çdo ekip ka 10 minuta kohë për të gjetur të paktën një zgjidhje për secilin skenar.</li> <li>- Në fund të aktivitetit, një përfaqësues nga secili ekip i shkruan idetë e tyre në tabelë dhe shpjegon si i gjeti zgjidhjet ekipi i tij/saj.</li> </ul>

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
Obelisku ZIN (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të teorisë së komunikimit...

## Tema 4: Parimet e komunikimit

Tema e katërt trajton temën më të gjerë të parimeve themelore të komunikimit, e cila mund të vëzhgohet nga këndvështrime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme. Kjo temë adreson edhe parime specifike të komunikimit efektiv verbal. Nën-temat specifike përqendrohen në elemente të ndryshme të temës kryesore dhe janë paraqitur në Udhëzues me përshkrime të synimeve të të nxënit dhe rezultateve të të nxënit.

Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe diturive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënit.

Qëllimi kryesor i kësaj teme është të kuptohen parimet e komunikimit dhe metodat për komunikim efektiv verbal si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur, dhe larmia e tyre në aspektin e formave dhe zbatimit, si dhe rëndësia e tyre për të nxënit efektiv dhe zhvillimin personal.

**Tabela 4:** Nën-temat, synimet e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për zbatimin e temës: **PARIMET E KOMUNIKIMIT**

<i>Synimi i të nxënit:</i> Të kuptuarit e domethënies dhe rëndësisë së parimeve të Komunikimit si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur dhe e zhvillimit të shkathësive të komunikimit për të nxënë më mirë dhe për të jetuar së bashku.		
<i>Rezultati i përgjithshëm i të nxënit:</i> Pas përfundimit të kësaj teme, nxënësit e dinë diversitetin dhe larminë e parimeve të komunikimit dhe mund t'i zbatojnë ato në pjesëmarrje aktive në arsimin për të rritur.		
Nën-tema	Synimi	Rezultati
<b>5. Parimet themelore të komunikimit</b>	Prezantimi dhe analizimi i parimeve themelore të komunikimit ndërpersonal	Nxënësit e dinë thelbin e parimeve themelore të komunikimit ndërpersonal dhe i lidhin ato me të nxënit e të rriturve
<b>6. Parimet e komunikimit efektiv verbal</b>	Prezantimi dhe analizimi i parimeve të komunikimit efektiv verbal.	<ul style="list-style-type: none"><li>- Nxënësit janë në gjendje të njohin dhe shpjegojnë parimet e komunikimit efektiv verbal.</li><li>- Nxënësit kanë kompetenca për një komunikim efektiv verbal.</li></ul>

## 4.1. Parimet themelore të komunikimit

Komunikimin ndërpersonal mbështetet në disa parime, siç vijon:

- komunikimi ndërpersonal është i pashmangshëm,
- komunikimi ndërpersonal është një proces i pakthyeshëm,
- komunikimi ndërpersonal është i ndërlikuar,
- komunikimi ndërpersonal është kontekstual.

Parimi i parë thekson se komunikimi ndërpersonal është i pashmangshëm dhe përbëhet nga më shumë se fjala, dhe ka të bëjë edhe me tonin e zërit, gjestet, gjuhën e trupit dhe sjelljen, shprehjen e fytyrës dhe të ngjashme.



Parimi i dytë tregon se komunikimi ndërpersonal është një proces i pakthyeshëm, dhe ndikimi i këtij parimi është i pashmangshëm. Deklarata e transmetuar mund të plotësohet, shtohet, korrigohet, mohohet ose pohohet, por ajo kurrë nuk mund të merret mbrapsht nga vendi ku është dërguar ose të fshihet sikur të mos kishte ekzistuar kurrë.

Parimi i tretë thekson kompleksitetin e komunikimit. Për shkak të numrit të madh të ndryshorëve të përfshirë në procesin e komunikimit ndërpersonal, ky është një proces i ndërlikuar dhe kompleks. Një mesazh që transmetohet ofron më shumë se një mënyrë për interpretimin dhe kuptimin e tij, dhe si rregull ai që zgjidhet është ai që krijon dëmin më të vogël.

Parimi i katërt specifikon kontekstualitetin e komunikimit ndërpersonal dhe hedh poshtë mundësinë që ai të kryhet në izolim. Ai tregon se komunikimi ndërpersonal e përfshin gjithnjë kontekstin relativ, kontekstin e situatës, kontekstin psikologjik, kontekstin kulturor dhe kontekstin mjedisor.

Përveç këtyre parimeve parësore, puna arsimore me të rriturit duhet të marrë parasysh edhe ato në vijim:

- plotësia,
- konciziteti,
- qëllimi,
- konkretësia,
- qartësia,
- mirësjellja,
- korrektësia,
- ndërveprimi, dhe
- dinamizmi

Mesazhi që u dërgohet nxënësve të rritur është i plotë vetëm kur i përmban të gjitha faktet që ju nevojiten për të demonstruar veprimin që mësimdhënësi pret. Është me rëndësi se cili dhe çfarë lloj mesazhi, kujt dhe në çfarë mënyrë dërgohet. Duhet mbajtur parasysh se çdo nxënës i rritur ndikohet fuqimisht nga nevojat, qëndrimet, emocionet, statusi, origjina dhe kultura e tij/saj, ndër të tjera. Për ta ruajtur plotësinë e mesazhit, mësimdhënësi duhet të marrë parasysh që gjithmonë t'u përgjigjet pyetjeve të parashtruara dhe të japë mesazhe dhe/ose informacion shtesë nëse e konsideron të nevojshme ose nëse dikush e kërkon.

Konciziteti në komunikim siguron kursim të kohës si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit e rritur. Duke eliminuar fjalët e panevojshme, mësimdhënësi do të arrijë të veçojë ato ide që dëshiron të transmetojë dhe të nxjerrë në pah rëndësinë e tyre. Duhet pasur kujdes për të shmangur përsëritjet e panevojshme dhe të përfshihen mesazhe që janë të rëndësishme për nxënësit e rritur.

Qëllimi i mesazhit i referohet përgatitjes paraprake dhe ndryshimit të rolit të mësimdhënësit. Ai/ajo duhet ta vërë veten në vendin e nxënësve dhe të supozojë ose imagjinojë se si do të reagojnë ndaj mesazhit përkatës, me të gjitha dituritë paraprake, paragjykimet, dëshirat, problemet, rrethanat dhe emocionet e tyre të veçanta. Pastaj ai/ajo duhet të vlerësojë se si t'i trajtojë reagimet e tyre. Mesazhi në një rast të tillë mund të modifikohet, ndryshohet, plotësohet ose fshihet.

Konkretësia në komunikim kërkon që mesazhi të jetë i saktë, i përcaktuar dhe realist, jo i përgjithshëm, i turbullt ose i paqartë.

Qartësia: Mësimdhënësi/ja dëshiron që nxënësi i rritur t'i interpretojë fjalët dhe mesazhet e tij/saj me të njëjtin kuptim që ai/ajo kishte planifikuar. Që kjo të ndodhë, fjalët dhe mesazhet duhet të formulohen në atë mënyrë që të sigurohet që nxënësi i rritur të kuptojë atë që mësimdhënësi po përpiket të transmetojë. Duke pasur parasysh që të gjithë nxënësit e rritur kanë përvoja të ndryshme, fjalët dhe mesazhet shpesh kanë kuptime të ndryshme për nxënës të ndryshëm. Kjo e bën aplikimin e këtij parimi jashtëzakonisht sfidues. Për të shmangur vështirësi të tilla, mësimdhënësi duhet të zgjedhë fjalë të shkurtra dhe të njohura, të ndërtojë fjali efektive, të sigurojë që mesazhi të jetë i lehtë për t'u kuptuar, lexuar dhe dëgjuar, si dhe të përfshijë shembuj, ilustrime dhe ndihma të tjera, sipas nevojës.

Mirësjellja ndihmon në forcimin e lidhjes mes mësimdhënësit dhe nxënësit të rritur. Ajo duhet të jetë autentike, jo thjesht mirësjellje mekanike. Për këtë qëllim, përveç të qenit të sigurtë në komunikim, mësimdhënësi duhet të shfaqin takt dhe kujdes; ai/ajo duhet të përdorë lavdërime, kur është e nevojshme, dhe të shmangë frazat që irritojnë, lëndojnë ose poshtërojnë nxënësit e rritur.

Për të zbatuar parimin e korrektësisë, mësimdhënësi nuk duhet të kujdeset vetëm për formulimin e duhur gramatikor dhe ortografik të mesazhit. Një mesazh mund të jetë gramatikisht i saktë, por prapë mund të shkaktojë bezdi ose fyerje mes nxënësve të rritur. Prandaj, mësimdhënësi duhet t'i kushtojë vëmendje regjistrit gjuhësor, duke përdorur frazat që nuk janë as shumë të lehta dhe as shumë të vështira, duhet të sigurojë që ai/ajo përdor vetëm fakte, fjalë dhe demonstrime të sakta, dhe duhet të përmbahet nga përdorimi i frazave diskriminuese.

Mësimdhënësi duhet të sigurojë ndërveprim në vend të një procesi të transferimit të drejtpërdrejtë të mesazhit. Caktimi i detyrave që duhen bërë, ose vetëm dëgjimi nga ana e nxënësve të rritur, nuk janë të mjaftueshëm. Nxënësi i rritur nuk duhet të vihet në pozicionin e një marrësi pasiv të mesazhit. Ndërveprimi duhet të lehtësojë përpunimin e mesazhit, shkëmbimin e ideve, mendimeve, mirëkuptimit, etj., ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësve dhe mes vetë nxënësve. Ndërveprimi gjithashtu ul pasigurinë e nxënësve të rritur.

Mësimdhënësi duhet të demonstrojë dinamizëm, entuziazëm, përfshirje dhe fleksibilitet në komunikimin me nxënës të ndryshëm të rritur dhe në kontekste të ndryshme.

**Tabela 4.1: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**


<b>Nën-tema</b>	<b>Parimet themelore të komunikimit</b>
<b>Synimi</b>	Prezantimi dhe analizimi i parimeve themelore të komunikimit ndërpersonal
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, diskutime, punë në grup, moderim,
<b>Korniza kohore</b>	60 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	Tabelë e bardhë, lapsa me ngjyra, stilolaps dhe letër për secilin nxënës
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	Mësimdhënësi do të jetë përgjegjës për lehtësimin e një mësimi që tregon një parim themelor të komunikimit ndërpersonal. Gjatë kësaj kohe, nxënësit do të jenë përgjegjës për (a) shpjegimin e themeleve të parimeve të komunikimit, (b) aplikimin e parimeve në komunikimin në jetën reale dhe në grup, (c) diskutimin se si parimet informojnë hulumtimin dhe praktikën, dhe (d) angazhimin e nxënësve në një mënyrë ndërvepruese për të përmirësuar të kuptuarit e parimeve të komunikimit.

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Obelisku ZIN (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të parimeve të komunikimit...

## 4.2. Parimet e komunikimit efektiv verbal

**Opinioni personal.** Jini të vendosur në mbrojtjen e të drejtave dhe nevojave tuaja. Duke e nënvlerësuar veten, ju inkurajoni edhe të tjerët t'ju nënvlerësojnë. Theksoni të drejtat tuaja dhe prisni që të tjerët t'i respektojnë. Mos hiqni dorë, shtroni pyetje, bëni përmbledhje dhe parafrazoni.



**Fokusi tek problemi, dhe jo te personi.** Mos e merrni gjithçka personalisht dhe shprehni vetëm opinionet dhe nevojat tuaja. Është më mirë të përqendroheni në zgjidhjen e problemit sesa të kritikoni dhe/ose kontrolloni të tjerët.

**Kritika.** Gjithmonë jini pozitiv kur jepni ose merrni kritika. Ajo duhet të rezultojë nga dëgjimi, analizimi dhe sqarimi juaj i kujdesshëm dhe jo nga reagimi juaj instinktiv. Nëse bashkëbiseduesi e pranon me vështirësi kritikën që po i jepni dhe reagon emocionalisht, përpiquni ta kuptoni dhe të përdorni një gjuhë më të moderuar.

Aftësia për të pranuar kritikë është një virtyt dhe shkathtësi; nëse kritika është e saktë dhe e konstatuar mirë, do t'ju lejojë të korrigjoni sjelljen tuaj. Prej saj vetëm mëson.

**Të jesh bashkëpunues dhe jo manipulues.** Jini vetvetja - të sinqertë dhe të hapur për komunikim me të tjerët. Mundohuni të demonstroi një dëshirë për bashkëpunim, por mbani identitetin dhe integritetin tuaj.

**Dërgimi i mesazheve "Unë".** Mos hezitoni të shprehni ndjenjat tuaja në mënyrë të qartë, por edhe në mënyrë të moderuar. Në këtë mënyrë, ju do të tregoni efektin që një veprim i caktuar ka pasur tek ju. Mos fajësoni ose fyeni askënd dhe mos e mbingarkoni komunikimin me ndjenjat tuaja.

**Bashkekzistencë dhe jo ekzistencë veçmas.** Megjithëse marrëdhëniet mes nxënësve të rritur shënohen me kufij të caktuar në lidhje me ndërveprimin e tyre, është e rëndësishme të tregoni ndjeshmëri ndaj të tjerëve. Nëse nuk tregoni kujdes dhe gatishmëri për të bashkekzistencë, atëherë as ata nuk do ta bëjnë.

**Refuzimi.** Tregoni qartë mospajtimin dhe refuzimin tuaj kur ju bëhen kërkesa të paarsyeshme. Pranimi, pavarësisht nga mospajtimi juaj i brendshëm, mund t'ju çojë në një kurth - nuk do të jeni në gjendje të përmbushni atë që ju kërkohet, ose do ta përmbushni duke e paguar me shqetësimin tuaj të brendshëm. Refuzimi duhet të jetë i qartë dhe i vendosur dhe nuk duhet të shoqërohet me shumë shpjegime, justifikime ose falje. Ofroni zgjidhje të tjera të mundshme.

**Bëhuni fleksibël.** Jini të hapur për ide, opinione dhe këndvështrime të tjera. Shumica e qasjeve të ndryshme dhe mënyrave të zgjidhjes së problemeve rrisin krijimtarinë dhe inovacionin.

**Paraqiteni veten si të barabartë dhe jo si superior.** Edhe kur jeni në gjendje të tregoni epërsinë tuaj, përqendrohuni në atë që ju dhe të tjerët mund të kontribuoni së bashku në këtë çështje.

**Përdorimi i përgjigjeve afirmuese.** Përgjigjuni të tjerëve duke e respektuar plotësisht përvojën e tyre. Falënderojini për kontributin e tyre dhe afirmoni të drejtën e tyre për ndjenjat e tyre, edhe nëse nuk jeni dakord. Bëni pyetje.

**Përdorimi i reagimeve.** Përdorni reagimet në mënyrë që bashkëbiseduesi të jetë i sigurt që e keni kuptuar mirë. Ndoshta për shkak të pengesave të caktuara gjatë komunikimit, bashkëbiseduesi nuk ju ka dëgjuar mirë ose ju e keni keqkuptuar. Nëse komunikimi vazhdon pa reagime, mund të lindin keqkuptime ose mund të ndërpritet, të marrë drejtim tjetër ose edhe të përfundojë. Reagimi ka një efekt motivues dhe gjithashtu korrigjues. Ai jo vetëm që rrit komunikimin, por edhe e kontrollon në mënyrë që të mos ndërpritet, dhe ndoshta e korrigjon.

Një reagim i duhur kërkon që ta lavdërojmë dhe shpjegojmë se çfarë është e dobishme për një pjesëmarrës, duke u përqendruar, ndër të tjera, në ato që ai/ajo ka bërë, arritur ose thënë. Deklarata të tilla specifike janë të domosdoshme edhe në situatat kur një pjesëmarrës kritikohet ose vlerësohet. Në raste të tilla, synimi i reagimit është t'i lejojë pjesëmarrësit t'i kuptojë dhe korrigjojë gabimet e veta. Për këtë qëllim, reagimi jepet në formën e mëposhtme: "Unë besoj se ju mund të arrini rezultate më të mira..." ose "E gjithë kjo është inkurajuese, por duhet të marrim parasysh edhe... ose "Ndoshta duhet të dëgjojmë opinionet e një ose dy njerëzve më shumë për këtë pyetje..." ose "Propozoj që të konsideroni edhe një herë..." "Do të ishte mirë sikur të punonit pak më shumë për këtë pyetje..."

Ju merrni reagime verbale, ato që thonë njerëzit, dhe reagime joverbale, çfarë ju thonë gjuha e trupit të tyre dhe veprimet.

Ne mund të dallojmë lloje të ndryshme të reagimeve:

**Reagime konfirmuese:** Marrësi i informacionit thjesht pranon marrjen e informacionit.

**Reagime korrigjuese/afirmative:** Një reagim korrigjues siguron korrigjim të deklaratës ose pajtohet me të.

**Reagime shpjeguese:** Përveç konfirmimit dhe pohimit të deklaratës, personi jep arsye për opinionin ose pikëpamjen e vet.

**Reagime diagnostikuese:** Ofron sqarime në lidhje me këtë temë edhe pse nuk mund të jetë gjithnjë logjik apo i duhur.

**Reagime shtjelluese:** Përfshini referencë për përvojat personale, studime ose hulumtime - dhe informacione të tjera që mund ta ndriçojnë diskutimin.

#### **Parimet e reagimit efektiv:**

**Qartësia:** Reagimet duhet të jenë të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme.

**Shpejtësia:** Reagimi duhet të sigurohet sa më shpejt që të jetë e mundur pas marrjes së mesazhit.

**Validiteti:** Reagimi duhet të jetë i besueshëm dhe i vlefshëm për ta bërë atë efektiv

**I kërkuar:** Reagimi është më i efektshëm kur është i kërkuar sesa kur jepet vullnetarisht.

**Tabela 4.2: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

<b>Nën-tema</b>	<b>Parimet e komunikimit efektiv verbal</b>
<b>Synimi</b>	Prezantimi dhe analizimi i parimeve të komunikimit efektiv verbal
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, diskutime, punë në grup, moderim
<b>Korniza kohore</b>	60 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	Tabelë e bardhë, lapsa me ngjyra, letra
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	<p><b>Dëshmitarët okularë</b></p> <p>Ky ushtrim tregon si ndryshon ose shtrembërohet një histori në varësi të treguesit. Mënyra si kryhet aktiviteti konfirmon hulumtimet që tregojnë se dëshmitarët okularë të krimeve i shohin ngjarjet të filtruara përmes përvojave të tyre të së kaluarës dhe jo me një sy objektiv.</p> <p>Përgatituni për këtë ushtrim të lojës së roleve duke shtypur tregimin e mëposhtëm, në mënyrë që të mund ta projektoni në ekran në fund të aktivitetit:</p> <p>‘Një kamion që ecte drejt jugut po kthehej djathtas, ndërsa një makinë sportive që ecte drejt veriut po përpiquej të kthehej majtas. Kur të dy vozitësit e kuptuan se po përpiqeshin të ktheheshin në të njëjtën korsi, ata të dy i ranë borisë por vazhduan kthesën pa ngadalësuar. Në fakt, makina sportive u duk se shpejtoi pak para përplasjes.’</p> <p>Nxirrini nga klasa katër dëshmitarë dhe një “polici” dhe pastaj ia lexoni skenarin e mësipërm një dëshmitari në dhomë, të cilit nuk i lejohet të mbajë shënime. Dëshmitarët jashtë klasës nuk duhet të kenë dituri për ngjarjen. Thirrni një nga dëshmitarët nga jashtë dhe kërkoni nga dëshmitari që sapo e ka dëgjuar ngjarjen që t’ia tregojë dëshmitarit të dytë. Pas kësaj, thirrni një dëshmitar të tretë dhe kërkoni të dytit që t’ia tregojë të tretit ngjarjen. Vazhdoni derisa të gjithë dëshmitarët ta kenë dëgjuar ngjarjen. Në fund, thirrni policin të hyjë dhe të regjistrojë informacione nga dëshmitari i fundit në një tabelë, nëse është e mundur. Krahasoni historinë që regjistron polici me tregimin origjinal. Kërkojuni pjesëmarrësve dhe vëzhguesve të përshkruajnë se si janë ndier gjatë këtij ushtrimi. Diskutoni se çfarë përfundimesh kanë nxjerrë nga ky aktivitet.</p>

**Sugjerime didaktike**

Kjo njësi e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Dramë (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të parimeve të komunikimit

## Tema 5: Metodatat dhe teknikat e komunikimit

Tema e pestë trajton fushën më të gjerë të metodave dhe teknikave të komunikimit, e cila mund të vrojtohet nga këndvështrime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme. Ajo ka katër nën-tema specifike: dëgjimi aktiv, diskutimi në grup, prishësit e komunikimit, dhe komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve, duke u fokusuar në elementë të ndryshëm të temës kryesore dhe të paraqitur në Udhëzime me përshkrime të synimeve të të nxënësve dhe rezultateve të të nxënësve.

Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe diturive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënësve.

Qëllimi kryesor i kësaj teme është të kuptohen metodatat dhe teknikat e komunikimit si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur, dhe larmia e tyre në aspektin e formave dhe zbatimit, si dhe rëndësia e tyre për të nxënësve efektiv dhe zhvillimin personal.

**Tabela 5:** Nën-temat, synimet e të nxënësve dhe rezultatet e të nxënësve për zbatimin e temës:

### METODAT DHE TEKNIKAT E KOMUNIKIMIT

*Synimi i të nxënësve:* Të kuptuarit e domethënies dhe rëndësisë së metodave dhe teknikave të ndryshme të komunikimit, si pjesë e rëndësishme e arsimit për të rritur, dhe larmia e tyre në aspektin e : strukturës, organizimit, elementeve kyçe, parimeve dhe modeleve të komunikimit, dhe zhvillimit të shkathhtësisë të komunikimit për të nxënë më mirë dhe për të jetuar së bashku.

*Rezultati i përgjithshëm i të nxënësve:* Pas përfundimit të kësaj teme, nxënësit do të njohin diversitetin dhe larminë e metodave dhe teknikave të komunikimit, do të jenë në gjendje të përdorin një larmi metodash dhe teknikash të komunikimit në arsimin për të rritur.

Nën-tema	Synimi	Rezultati
<b>1. Dëgjimi aktiv</b>	Shpjegimi i karakteristikave kryesore të dëgjimit aktiv.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit i dinë se karakteristikat kryesore të të dëgjuarit aktiv mund t'i ndërlidhin me të nxënësve e të rriturve.</li> <li>- Nxënësit janë në gjendje të vlerësojnë dhe artikulojnë përgjigjet e duhura të dëgjimit për një sërë situatash/kontekstesh komunikimi.</li> <li>- Nxënësit janë dëgjues aktiv.</li> </ul>
<b>2. Diskutim në grup</b>	Prezantimi dhe analizimi i diskutimit në grup.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit kanë kompetenca për diskutimin në grup.</li> </ul>
<b>3. Prishësit e komunikimit</b>	Zbulimi dhe analizimi i prishësve të komunikimit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit i dinë prishësit kryesorë të komunikimit</li> </ul>
<b>4. Komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve</b>	Prezantimi i teorive dhe strategjive për menaxhimin e konflikteve dhe negociatat për kontekste të ndryshme.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit janë në gjendje t'i menaxhojnë situatat e konfliktit në procesin e komunikimit.</li> </ul>

Në komunikimin me nxënësit e rritur, përdorni metodën më të përshtatshme të komunikimit. Një mënyrë për ta bërë këtë është t'i bëni vetes pyetjet e mëposhtme.

- Cili është qëllimi i mesazhit tuaj? A planifikoni të thoni diçka të re? A informoni? A planifikoni të ndryshoni pikëpamjen e tij/saj? Ta bindni?
- Cilat fakte duhet të paraqiten për të arritur efektin tuaj të dëshiruar?
- Çfarë veprimi, nëse ka, prisni që ajo/ai të ndër marrë?
- Cilat ide, opinione dhe përfundime të përgjithshme duhet të theksohen?
- A jeni plotësisht në dijeni për të gjitha informacionet e rëndësishme?
- Cila metodë, apo kombinim i metodave, do të funksionojë në mënyrë më efektive për këtë situatë? Kontakti personal - kërkon shkathtësi për gjetjen e kohës dhe ndërpersonale.

## 5.1 Dëgjimi aktiv

Në mënyrë që komunikimi verbal të kryhet me efikasitet, dëgjimi aktiv është po aq i nevojshëm sa të folurit. Dëgjimi është një nga shkathtësitë më të rëndësishme që duhet të posedojnë pjesëmarrësit në komunikim. Me ndihmën e të dëgjuarit, ne marrim mesazhin që na drejtohet, mund ta kuptojmë, dhe të dërgojmë reagime.



Nëse shkathtësitë tona të dëgjimit aktiv janë të zhvilluara, ne mund ta kuptojmë se çfarë po na thotë bashkëbiseduesi, të tregojmë mirëkuptim, të kontrollojmë emocionet tona dhe t'u përgjigjemi mesazheve që kemi marrë. Dëgjimi aktiv është i rëndësishëm për arsimin për të rritur pasi lehtëson, ndër të tjera, (vetë)motivim shtesë, mirëkuptim të ndërsjellë, empati dhe ndërtimin e besimit mes pjesëmarrësve në komunikim.

Dëgjimi aktiv është e kundërta e dëgjimit selektiv ose pasiv dhe përfshin: përqendrimin e vëmendjes tek dërguesi i mesazhit, vendosjen e vetes në situatën e bashkëbiseduesit, deshifrimin dhe të kuptuarit e mesazhit në mënyrën e sugjeruar nga bashkëbiseduesi, memorizimin dhe interpretimin.

Personi që dëgjon në mënyrë aktive:

- **Vendos kontakt me sy** me bashkëbiseduesin duke e bërë të qartë për të se po e dëgjon me kujdes.
- **Tregon interes.** Ai/ajo i tregon bashkëbiseduesit se çka që po i thotë është e rëndësishme për të, dhe se për momentin vëmendjen e ka të përqendruar aty.
- **Ndjek gjuhën e tij/saj joverbale,** d.m.th. i kushton vëmendje dhe regjistron sinjalet që bashkëbiseduesi i dërgon me qëllim të pasurimit të mesazhit të vet të folur (lëvizjet e duarve, pozicioni i pjesëve të trupit, ngjyra dhe toni i zërit, pauzat në të folur, shprehjet e fytyrës).
- **Ofron gjeste reagimi.** Me një tundje të thjeshtë të kokës, shprehje të kënaqur të fytyrës, lëvizje të duarve ose përkulje të lehtë të trupit përpara, ne i tregojmë bashkëbiseduesit që e kuptojmë çfarë po thotë dhe e mbështesim atë.
- **Nuk e ndërpret folësin** në mënyrë që të kritikojë ose prezantojë pikëpamjet e tij/saj.

- **Shton pyetje.** Pyetjet duhet të parashtrohen kur dëgjuesi nuk e dëgjoji mirë bashkëbiseduesin ose diçka nuk është e qartë. Përndryshe, bashkëbiseduesi mund të mendojë se mesazhet e tij/saj ishin të qarta dhe të kuptuara mirë nga dëgjuesi.
- **Parafrazon dhe përfundon.** Parafrazimi është i dobishëm për të mbajtur fokusin dhe intensitetin e komunikimit. Nëse një nxënës thotë “E kam të vështirë të mësoj”, mësimdhënësi duhet të përfundojë “Ju duhen më shumë përpjekje për ta mësuar këtë” dhe të parafranojë. Reagimet e dërguara qartë i tregojnë bashkëbiseduesit se po e dëgjojmë në mënyrë aktive dhe po e motivojmë të thotë atë që është e rëndësishme. Në një komunikim të tillë, është shumë e rëndësishme të mos jepni gjykime përpara, siç janë “Nuk besoj se është e vështirë” ose “Pra, nuk jeni i aftë ta mësoni këtë”. Një reagim i tillë mund ta demotivojë dhe ta bëjë pasiv bashkëbiseduesin.
- **Bisedon rreth ndjenjave.** Asnjë komunikim verbal nuk është pa ndjenja. Ndjenjat mund të nxiten drejtpërdrejt (nga përmbajtja e mesazhit, qëndrimi i bashkëbiseduesit, pengesat në kanalit e komunikimit) ose tërthorazi (nga paragjykimet, problemet personale, gjendja fizike ose mjekësore, etj.). Nuk këshillohet të flisni për ndjenjat gjatë komunikimit, dhe veçanërisht në prani të personave të tjerë. Në një rast të tillë, bashkëbiseduesi mund të ndihet i lënduar ose i turpëruar dhe si rezultat mund të përfundojë komunikimin. Është më mirë të flitet vetëm për vetëm pas përfundimit të komunikimit. Kështu ne tregojmë dhembshuri, respektojmë dinjitetin e personit dhe ndërtojmë besim.
- **Përdor mesazhe “Unë”.** Mesazhi “Unë” është një deklaratë e sigurtë dhe personale që një person përdor në një situatë kur bashkëbiseduesi shfaq ndjenjat e shkaktuara nga ndonjë sjellje e papërshtatshme. Një shembull për një mesazh të tillë është: “Nuk e keni mësuar mirë këtë dhe unë jam i shqetësuar se do të jetë e vështirë që ta bëni në praktikë!”, Ose “Jeni në ankth kur flisni për këtë temë. Po, ndonjëherë më kap ankthi edhe për këtë”. Duke përdorur mesazhe “Unë”, ne ndihmojmë bashkëbiseduesin të hapet plotësisht dhe lirshëm, duke e avancuar kështu komunikimin.

**Dëgjuesi aktiv duhet të kujdeset:**

- të dëgjojë më shumë dhe të flasë më pak;
- të tregojë me gjuhën e trupit të tij/saj se ai/ajo është një dëgjues i interesuar dhe i vëmendshëm;
- të mos dëgjojë në mënyrë selektive;
- të mos përgjigjet në pyetje me pyetje të tjera;
- të mos mbarojë fjalitë e njerëzve të tjerë;
- të mos humbet në mendimet e tij/saj kur të tjerët flasin;
- të japë mbështetje emocionale;
- të mos ta dominojë diskutimin;
- të mos i ndërpresë të tjerët derisa të mbarojnë ato që thonë;
- të japë reagim;
- të mos ndërpresë të tjerët kur flasin;
- të analizojë dhe përmbledhë ato që u thanë;
- të udhëheqë diskutimin brenda kontekstit të asaj që u tha;
- të parafranojë;
- të përdorë mesazhe “Unë”.

## Teknika për të dëgjuarit aktiv

**Fokusimi.** Përqendrohuni te bashkëbiseduesit, mendimet dhe ndjenjat e tyre. Ndaloni komentet tuaja të brendshme, problemet tuaja dhe mendoni vetëm për bashkëbiseduesin; përqendroni vëmendjen tuaj të plotë tek ajo/ai.

**Gjuha e trupit.** Përkuleni lehtazi trupin tuaj përpara, bëni kontakt me sy dhe jepni sinjale joverbale të cilat i dërgojnë mesazh bashkëbiseduesit që po e dëgjoni me vëmendje dhe jeni të interesuar për atë që ai/ajo thotë.

**Vëzhgimi.** Kushtojini vëmendje mesazheve joverbale të dërguara nga bashkëbiseduesi dhe “kapini ato”. Mos humbisni asgjë. Identifikoni gjuhën e trupit dhe shenjat joverbale në mënyrë që të kuptoni thelbin e bashkëbiseduesit.

**Dëgjimi i plotë dhe jo në fragmente.** Dëgjoni thelbin e mesazhit të folur, detajet e tij, idetë kryesore që mbart dhe kuptimin e tyre. Mundohuni të kuptoni plotësisht se çfarë po ju përcjell bashkëbiseduesi. Mos reagoni ndaj fjalëve, termave ose frazave të vetme që përdor bashkëbiseduesi. Përndryshe, mund të humbisni thelbin e mesazhit.

**Parafrazimi.** Për të mos përsëritur ato që janë thënë tashmë, duhet të parafrazoni dhe theksoni pjesët më të rëndësishme. Kujdesuni që të mos dilni nga ideja themelore e bashkëbiseduesit.

**Shprehja e empatisë.** Vendosni veten dhe imagjinoni se si do të ndiheni në situatën e tyre. Mundohuni t’i kuptoni. Verbalizoni përmbajtjen emocionale por mos lejoni që të tërhiqeni plotësisht në të gjitha problemet e tyre dhe përgjegjësitë me të cilat përballen.

**Parashtrimi i pyetjeve.** Përdorni pyetje për të sqaruar të kuptuarit e mesazhit. Duke bërë pyetje ju tregojnë se jeni i interesuar për ato që thuhet.

**Tabela 5.1: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Dëgjimi aktiv
Synimi	Shpjegimi i karakteristikave kryesore të dëgjimit aktiv
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, punë në grup, moderim, dëgjim aktiv
Korniza kohore	60 min
Burimet e kërkuara	Tabelë e bardhë, lapsa me ngjyra, letra
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	Kjo teknikë është një mënyrë e shkëlqyeshme për të siguruar që pjesëmarrësit të dëgjojnë njëri tjetrin dhe mund të ndihmojë që grupi të shkojë drejt konsensusit duke zvogëluar keqkuptimet dhe duke sqaruar arsyetimin e pjesëmarrësve të ndryshëm. Teknika është veçanërisht e dobishme kur opinionet në një grup ndahen ashpër. Një pjesëmarrës në njërin anë të debatit deklaron qëndrimin e tij. Një pjesëmarrës në anën tjetër të debatit pastaj përmbledh, me fjalët e tij/saj, ato që tha pjesëmarrësi i parë. Pjesëmarrësi i parë pastaj komenton përmbledhjen, duke korigjuar gabimet, keqkuptimet ose lëshimet. Ekzistojnë ndryshime të teknikës, për shembull: për 5 minuta flet personi A, B dëgjon (pa diskutim); për 2 minuta B përmbledh, A dëgjon (pa diskutim); për 1 minutë A korigjon, B dëgjon (pa diskutim).

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

Punë në dyshe (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);

Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të dëgjimit aktiv...

## 5.2 Diskutim në grup

Diskutimi në grup është një formë e një shkëmbimi ndërveprues sistematik dhe verbal të informacionit, qëndrimeve dhe opinioneve për çdo temë, problem apo situatë të caktuar mes anëtarëve të një grupi që ndajnë disa synime të përbashkëta. Ndihton në zhvillimin e këndvështrimeve më të mira për pyetjet për të cilat ekzistojnë opinione të ndryshme. Përballja e opinioneve dhe pikëpamjeve të ndryshme rreth një problemi çon në shfaqjen e një panorame shumë më të qartë, problemi bëhet më i qartë dhe “i ekspozuar”, gjë që nga ana tjetër çon në të kuptuar më të mirë. Thënë thjesht, qëllimi i një diskutimi në grup është diskutimi për një temë specifike dhe/ose problem në detaje. Mund të ketë të bëjë me një situatë komunikimi, dhe u lejon pjesëmarrësve të shprehin qëndrimet dhe opinionet e tyre dhe t'i ndajnë ato me pjesëmarrësit e tjerë.



Diskutimi në grup është një shkëmbim i strukturuar i ideve. Secili pjesëmarrës ka mundësinë të shprehë opinionin e tij/saj dhe të bëjë komente për opinionet e anëtarëve të tjerë të grupit. Anëtarët e grupit duhet ta dëgjojnë njëri tjetrin me kujdes dhe të përdorin shprehjet dhe gjetet verbale, gjuhën e qartë dhe një stil bindës.

Diskutimi në grup karakterizohet nga një dinamikë specifike në grup, e cila nënkupton ndërveprim në komunikimin një me një dhe grup me grup. Secili anëtar i grupit duhet të zhvillojë ndërveprim të orientuar drejt synimit ose të orientuar drejt grupit.

Diskutimi në grup ndihmon edhe në proceset e zgjidhjes së problemeve, vendimmarrjes dhe vlerësimit të personalitetit. Në çdo situatë të zgjidhjes së problemeve, shqyrtohen perceptimet e pjesëmarrësve të ndryshëm dhe propozohen zgjidhje të mundshme. Opsioni më i mirë duhet të zgjidhet nga grupi. Derisa të merret një vendim, të gjitha pyetjet diskutohen hapur, analizohen, interpretohen dhe vlerësohen.

### Karakteristikat e diskutimit në grup

Që një diskutim në grup të jetë i suksesshëm, është e nevojshme që arritja e synimit të ketë rëndësi vendimtare.

Karakterizohet nga:

**Ekzistimi i një synimi të qartë:** Pjesëmarrësit duhet ta dinë synimin e diskutimit në grup në mënyrë që ata të mund të përqendrohen dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në arritjen e tij. Si rregull, synimi i diskutimit në grup shpjegohet nga mësimdhënësi ose ai që bën propozimin. Në arsimin për të rritur, çdo pjesëmarrës mund të bëjë një propozim.

**Motivimi:** Kur ekziston një nivel i lartë motivimi mes anëtarëve, diskutimi është i frytshëm dhe anëtarët e grupit vendosin interesat e grupit mbi interesat e tyre.

**Rregullat:** Para se të fillojë diskutimi, mësimdhënësi dhe pjesëmarrësit vendosin rregullat. Ata vendosin se si do ta organizojnë prezantimin e opinioneve individuale, si do të bëhet shkëmbimi i opinioneve dhe

si do të arrihet konsensusi. Nëse ata nuk arrijnë ta bëjnë këtë, mund të ndodhë që disa nga anëtarët e grupit të imponojnë rregullat e tyre dhe të mbizotërojnë, duke e bërë të gjithë diskutimin pa kuptim.

**Atmosfera e ngrohtë:** Diskutimi në grup duhet të ndodhë në një atmosferë bashkëpunuese dhe miqësore në mënyrë që të shmangët konfrontimi mes anëtarëve të grupit.

**Shkathtësitë e komunikimit:** Sukses i diskutimit në grup varet nga përdorimi efikas i teknikave të komunikimit. Të folurit e qartë, përdorimi i gjuhës së thjeshtë, mbajtja e përqendrimit në diskutim dhe toleranca, janë parakushte për diskutimin në grup, si për çdo komunikim tjetër verbal. Gjuha joverbale është një element integral i diskutimit në grup dhe duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur, veçanërisht gjuhës së trupit.

**Përfshirja:** Është e nevojshme që të gjithë anëtarët në diskutimin në grup të marrin pjesë aktive; mësimdhënësi jo vetëm që duhet t'i inkurajojë, por ata gjithashtu duhet të inkurajojnë njëri tjetrin.

**Shkathtësitë udhëzuese:** Mësimdhënësi duhet të zotërojë shkathtësi të ndryshme, të nevojshme për realizimin e suksesshëm të diskutimit në grup, siç janë aftësitë organizative, iniciativa, prezantimi logjik, aftësia për të inkurajuar, aftësia për të përmbledhur diskutimin.

**Tabela 5.2: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Diskutim në grup
Synimi	Prezantimi dhe analizimi i diskutimit në grup.
Metodat dhe teknikat	Ligjëratë, diskutime, punë në grup, moderim
Korniza kohore	30 min
Burimet e kërkuara	Tabelë e bardhë, lapsa me ngjyra, letra,
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	Mund të shpërndani një grup kartelash me 15 vlera (personaliteti) të shkruara mbi to dhe t'i jepni secilit person. Pastaj, kërkoni nga secili nxënës t'i rendisë sipas përparësisë, dhe hidhni pesë, dhe më pas hidhni 5 të tjera. Pastaj, ata mund të diskutojnë në grupe nga 5-7, cilat janë 5 kartelat e tyre të mbetura dhe si lidhen me pikëpamjet e tyre të menaxhimit të projektit. Secili grup mund t'i raportojë të gjithë klasës. Ndani motivuesit, diskutimin në grup, stilet e komunikimit.

**Sugjerime didaktike**

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Teknikat BUZZ (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
 Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të diskutimit në grup


### 5.3 Prishësit e komunikimit

Ndonjëherë gjatë një komunikimi, komunikues të caktuar prezantojnë elementë të ndryshëm, që përmes “mesazheve të tyre të fshehura” mund të ndikojnë negativisht në motivimin e bashkëbiseduesit, të shkaktojnë tension, madje të prishin vetë komunikimin. Këta elementë mund të futen në komunikim me vetëdije, por më shpesh ndodhin pa vetëdije.



Mënyra të caktuara të verbalizimit mbartin risk të lartë të vendosjes së një dëmtuesi në bisedë, të dëmtimit të marrëdhënies, shkaktojnë të ndjenjave të papërshtatshmërisë, zemërimit ose varësisë tek personi tjetër, ose të gjitha këto. Si rezultat i një ose më shumë pengesave, të tjerët mund të bëhen më të nënshtuar dhe të bindshëm. Ose ato mund të bëhen më rezistentë, rebelë dhe argumentues. Këto pengesa në bisedë kanë tendencë të zvogëlojnë vetëvlerësimin e të tjerëve dhe të minojnë motivimin. Bllokimet janë të përhapura në kulturën tonë; ato përdoren në mbi 90 për qind të bisedave ku njëri ose të dy personat kanë një problem ose kanë nevojë të fortë.<sup>11</sup>

Thomas Gordon hartoi një listë gjithëpërfshirëse që ai e quan “duzina e pistë” e prishësve të komunikimit. Këto përgjigje të padëshirueshme përfshijnë:<sup>12</sup>



Sipas: Thomas Gordon

**Kritika:** Bërja e një vlerësimi negativ të personit tjetër, veprimeve ose qëndrimeve të tij. “Vetë e bërë - nuk mund të fajësoni askënd tjetër për rrëmujën në të cilën ndodhni.”

<sup>11</sup> Robert Bolton, Ph.D. (2009): Shkathtësitë njerëzore, A Book Touchstone, New York, London, Toronto, Sydney, f. 62

<sup>12</sup> Po aty, fq. 46-57

**Vënia e epiteve:** “Poshtërimi” ose stereotipa të personit tjetër “çfarë rrote!” “Tamam si grua...” “Kryt si vo.” “Ju punëtorët e krahut jeni të gjithë njëlloj.” “Jeni thjesht një mashkull i pandjeshëm.”

**Diagnostikimi:** Analizimi pse një person sillet në atë formë; bën si psikiatër amator. “Unë ju lexoj si librin - po bëni atë vetëm për të më irrituar.” “Vetëm se keni shkuar në koleg, mendoni se jeni më mirë se unë.”

**Lavdërimi vlerësues:** Bërja e një gjykimi pozitiv për personin tjetër, veprimet ose qëndrimet e tij. “Gjithmonë ke qenë vajzë e mirë. E di që do të më ndihmoni me lëndinën sonte.” Mësimdhënësi i thotë nxënësit adoleshent: “Je poet i madh.”

**Urdhërimi:** Komandimi i personit tjetër që të bëjë atë që dëshironi. “Bëji detyrat e shtëpisë tani.” “PSE?” Sepse ashtu them unë...”

**Kërcënimi:** Përpjekja për të kontrolluar veprimet e tjetrit duke e paralajmëruar për pasoja negative që do t’i shkaktoni. “Do ta bësh ose *ndryshe*...” “Ndaloni zhurmën tani ose do ta mbaj tërë klasën pas orari.”

**Moralizimi:** Të treguarit një personi tjetër se çfarë *duhet* të bëjë. “Predikimi” për tjetrin. “Nuk duhet të shkosh në divorc; mendo se çfarë do të ndodhë me fëmijët.” “Duhet t’i thuash që të vjen keq.”

**Pyetje të tepruara/të papërshtatshme:** Pyetjet e mbyllura shpesh janë pengesa në marrëdhënie; këto janë ato që zakonisht mund të përgjigjen me disa fjalë - shpesh me një po ose jo të thjeshtë. “Kur ndodhi?” “Ju vjen keq që e bëtë?”

**Këshillimi:** Të dhënit një personi tjetër një zgjidhje për problemet e tij/saj. “Po të isha unë, me siguri do t’ia tregoja vendin.” “Kjo është e lehtë për t’u zgjidhur. Së pari...”

**Devijimi:** Shmangia e problemeve të tjetrit përmes shpërqendrimit. “Mos u fikso aty, Sara. Le të flasim për diçka më të këndshme.” ose; “Kujton se dole keq?! Prit të dëgjosh çfarë më ndodhi mua.”

**Argumenti logjik:** Përpjekja për të bindur tjetrin me fakte ose logjikë, zakonisht pa marrë parasysh faktorët e përfshirë emocionalë. “Shiko faktet; nëse nuk do ta kishe blerë atë makinë të re, mund ta kishim bërë pagesën për shtëpinë.”

**Sigurimi:** Përpjekja për të ndaluar emocionet negative që po përjeton personi tjetër. “Mos u shqetëso, do bëhet mirë.” “E gjitha do të funksionojë në fund.”

Zvogëlimi i efekteve anësore të “prishësve të komunikimit” kërkon që komunikuesit të kenë shkathtësi për parandalimin e tyre dhe shkathtësi për eliminimin e tyre nëse paraqiten. Për këtë, është e nevojshme që ata të jenë në gjendje t’i identifikojnë prishësit e komunikimit dhe të merren me efikasitet me ta. Për të shmangur situatat e pakëndshme të shkaktuara nga “prishësit”, ne duhet t’i qasemi shfaqjes së problemit përmes zgjidhjes konstruktive të problemit, për shembull me veprimet e mëposhtme<sup>13</sup>:

---

<sup>13</sup> Šefika Alibabić; Katarina Popović; Emir Avdagić. Doracaku andragogjik për punën me të rriturit, *DVV International* - Zyra e Shkupit, 2013

- Qëndroni të qetë, pa emocione dhe mbani kontrollin mbi veten dhe situatën;
- Rikonsideroni synimin e bisedës, faktet dhe përmbajtjen;
- Sqaroni në mënyrë racionale dhe me saktësi, jepni informacion shtesë;
- Jini të sqartë dhe të hapur në prezantimin dhe shpjegimin;
- Demonstroni vetë-kritikë, pranim të plotë, mirënjohje;
- Shprehni energji pozitive, mirësi, inkurajim të bashkëbiseduesit;
- Shprehni empatinë, dhembshurinë, mirëkuptimin, identifikimin me të tjerët;
- Inkurajoni ndryshimin e roleve (të dy drejtimet - veten në vendin tuaj... Ju në vendin tim...);
- Demonstroni mirësjellje, respektoni standardet e përcaktuara të sjelljes;
- Shprehni lavdërim, mbështetje, komplimente, pranim të mundshëm të të tjerëve;
- Tregoni humor, të qeshura!
- Kërkoni dhe përmbajuni profesionalizmit dhe standardeve profesionale;
- Shfaqni heshtjen, injorimin e plotë; (Injorimi i “zërit të heshtur”)
- Lëreni plotësisht situatën;
- Përdorni “vrasësin e vrasësve” të zgjedhur me kujdes, nëse duket se ka shanse të mira ta “vras” konfliktin që po shfaqet;
- Me uljen e tensionit, devijoni dhe minimizoni problemin;
- Shkoni në ekstreme, bëni parodi jo të dëmshme;
- Jini proaktivë, ofroni zgjidhje konstruktive;
- Bëni thirrje për bashkëpunim;
- Reagoni me këmbëngulje dhe bindje.

Komunikimi i mirë dhe efektiv është i mundur vetëm kur bashkëbiseduesit e respektojnë njëri tjetrin dhe janë të hapur për pikëpamje të ndryshme. Duke ofruar këshilla eksperte dhe shembuj të prishësve të komunikimit, dëshirojmë t’u dërgojmë një mesazh atyre që sillen ashtu, në atë mënyrë që të mund ta korrigjojnë sjelljen e tyre. Ne u dërgojmë të njëjtin mesazh të tjerëve në të njëjtën kohë, në mënyrë që të parandalojmë që ata të bëhen komunikues joproduktivë.

**Tabela 5.3: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Prishësit e komunikimit
Synimi	Zbulimi dhe analizimi i prishësve të komunikimit.
Metodat dhe teknikat	Ligjërata, diskutime, punë në grup, moderim, lojë
Korniza kohore	60 min
Burimet e kërkuara	Tabelë e bardhë, lapsa me ngjyra, letra,
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	Bazuar në lojën e fëmijëve Nxehtë/Ftohtë. Kërkoni nga një vullnetar të largohet nga klasa; zgjidhni një objekt që është diku në dhomë, shpjegojani grupit se atyre u lejohet vetëm t’i tregojnë vullnetarit kur ai/ajo është duke u larguar nga objekti (ftohtë) dhe se duhet të bëjnë deklaratat shumë negative si “Hej, budallë - gabim je andej”. Matni kohën që duhet për të gjetur objektin (këshillë: përgatiteni vullnetarin tërësisht për këtë lloj komunikimi negativ). Përdorni një vullnetar tjetër, kërkoni që të dalë nga klasa dhe këtë herë përdorni vetëm komunikim pozitiv kur i afrohet më shumë objektit “Shkëlqyeshëm, je e mrekullueshme, vazhdo”. Matni kohën Pastaj, caktoni një vullnetar të tretë dhe lejoni grupin të përdorë komunikim negativ dhe pozitiv. Ata duhet ta gjejnë objektin shumë me shpejt krahasuar me 2 metodat e tjera. Të dy llojet e komunikimit mund të jenë të dobishëm për të ndihmuar në udhëheqjen e dikujt në rrugën e duhur për të arritur synimet e tyre. Kjo është gjithashtu koha e duhur për të hapur një diskutim rreth prishësve të komunikimit.

#### **Sugjerime didaktike**

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
Lojë rolesh (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
Analizë e tekstit që diskuton prishës të tjerë të komunikimit

## **5.4 Komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve**

*Fjalët janë... burimi më i pashtershëm i magjisë. Të afta të lëndojnë dhe ta shërojnë atë lëndim.*  
Albus Dumbledore, "Harry Potter dhe Dhuratat e Vdekjes", JK Rowling

Kur lindin konflikte ose mosmarrëveshje të theksuara mes të paktën dy personave në procesin e komunikimit, lidhja bëhet e destabilizuar përkohësisht.

Secili person i qaset ndryshe menaxhimit të konflikteve. Disa përpiqen të distancohen nga konflikti dhe të veprojnë sikur nuk ekziston, të tjerët përballen direkt me të, ndërsa të tjerë përpiqen ta shmangin. Më shpesh faji për konfliktin i vihet "tjetrit". Ka edhe nga ata që ia vënë fajin vetes.



Kompromisi dhe bashkëpunimi janë mënyrat më konstruktive për ta kapërcyer konfliktin. Kompromisi kërkon gatishmëri për të ndarë fajin mes palëve, ndërsa bashkëpunimi pasqyron punën e ekipit dhe gatishmëri për të arritur një zgjidhje që respekton nevojat e të gjithëve. Këtu, konfliktit i qasesh me një mendim të qartë se çfarë është dhe si të arrihet në një rrugëdalje nga situata. Duke artikuluar qartë mendimet dhe nevojat, zgjidhja e konfliktit promovohet në një mënyrë të drejtpërdrejtë por jo kërcënuese.

Para se të përdorim zgjidhjen e konfliktit, duhet të bëjmë pauzë dhe të shqyrtojmë mendimet dhe nevojat dhe t'i reduktojmë në vetëm disa tema, pa favorizuar asnjërin nga bashkëbiseduesit. Duke iu afruar situatës së konfliktit me një portretizim të qartë, ne shfaqim interes për opinionet dhe nevojat e personit tjetër dhe gjetjen e një kompromisi. Kjo qasje lehtëson një proces të zgjidhjes konstruktive të konflikteve.

### **Hapat për zgjidhjen e suksesshme të konflikteve:**

- Shikoni dhe pranoni konfliktin si një mënyrë konstruktive për forcimin e marrëdhënieve;
- Pyete veten "A dua të shkaktoj ose të shmang konfliktin me personat të cilët më interesojnë?";
- Komunikoni në atë mënyrë që lehtëson zgjidhjen e problemeve dhe mirëmbajtjen e një klime bashkëpunimi;
- Jini të hapur; mos ikni nga konflikti;
- Tregoni kujdes në ato që thoni dhe si i thoni;
- Tregohuni dëgjues aktiv. Lejoni të tjerët të pranojnë se keni mirëkuptim për dëshirat dhe nevojat e tyre;
- Përmbliidhni ato që diskutuat dhe planifikoni për vazhdimin e komunikimit derisa të gjendet një zgjidhje.

**Në nivel personal:**

- Besoni në aftësitë tuaja për t'i trajtuar situatat e konfliktit përmes një komunikimi të ndërgjegjshëm dhe konstruktiv;
- Mos prisni që të tjerët ta shmangin konfliktin që t'u përshtaten interesave tuaja;
- Mos prisni që të tjerët ta zgjidhin konfliktin;
- Mos u përpiqni t'i befasoni të tjerët duke shkaktuar konflikt me ta;
- Shtypni ndjenjën tuaj të pafuqisë dhe vetëmohimit;
- Gjeni energjinë dhe jini krijues në komunikimin tuaj me të tjerët.

Zgjidhja e konflikteve kërkon të qasurit pa luftuar ndaj problemit ose keqkuptimit. Pavarësisht nga ndjenjat personale. Aftësia për të trajtuar konflikte pa përdorur dhunë ka një ndikim pozitiv mbi ne, na bën të ndihemi mirë dhe na mëson të respektojmë të tjerët.

Fyerjet, kërcënimet, dhuna fizike, frikësimi, bezdisja dhe format e tjera të komunikimit të çrregullt mund të sjellin pasoja të rënda, jo vetëm në procesin e komunikimit, por edhe tek ne vetë.

Komunikimi i mirë kërkon të jesh dëgjues i mirë, të respektosh opinionet dhe këndvështrimet e njerëzve të tjerë, të punosh së bashku dhe të mendosh për zgjidhje të përbashkëta.

**Tabela 5.4: Sugjerim për zbatimin e kësaj nën-teme:**

<b>Nën-tema</b>	<b>Komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve</b>
<b>Synimi</b>	Prezantimi i teorive dhe strategjive për menaxhimin e konflikteve dhe negociatat për kontekste të ndryshme.
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjërata, diskutime, punë në grup, moderim, skenarë lojë rolesh
<b>Korniza kohore</b>	30 min
<b>Burimet e kërkuara</b>	Letër table për të shkruar ndjenjat dhe idetë
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	<p>Kërkoni nga gjysmën e klasës të dalë nga dhoma për 2 minuta. Ndërkohë që ata janë jashtë, i tregoni grupit të mbetur të bashkohen me kolegët e tyre kur ata të hyjnë përsëri në dhomë dhe t'i kërkojnë partnerit të vet që të ngrejë krahët para tyre në mënyrë që pëllëmbët e tyre të jenë përballë tyre.</p> <p>Hapi 1: Pjesëmarrësit fillojnë të shtyjnë partnerët e tyre pa ndonjë sqarim që të përpiqen dhe t'i bëjnë ata të shkojnë në anën e kundërt të dhomës, kështu që instinktivisht partneri i tyre do të fillojë të rezistojë.</p> <p>Hapi 2: Secili pjesëmarrës duhet t'i kërkojë partnerit të vet me mirësjellje dhe t'u japë një arsye pse ata dëshirojnë ta shoqërojnë atë në anën tjetër të dhomës, në mënyrë që partneri i vet të shkojë me dëshirë pa ndonjë rezistencë.</p> <p>Ku është qëllimi? Ekzistojnë dy mënyra për të ndikuar tek njerëzit, siç e pamë nga ky aktivitet i thjeshtë. Nëse i shtyjme të tjerët në ato që duam të bëjnë, ata do të rezistojnë instinktivisht.</p>

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
Kapelet e De Bono, (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave të nxënësve);  
Analiza e teksteve që adresojnë çështje të tjera të zgjidhjes së konflikteve

## Tema 6: Parimet themelore teorike dhe karakteristikat kyçe të dinamikës së grupit dhe kulturës së grupit

**Tabela 6:** Nën-temat, synimet e të nxënit dhe rezultatet e të nxënit për zbatimin e temës: **Parimet themelore teorike dhe karakteristikat kyçe të dinamikës së grupit dhe kulturës së grupit**

<p><i>Synimi i të nxënit:</i> Hyrje në Parimet themelore teorike dhe karakteristikat kyçe të dinamikës së grupit dhe kulturës së grupit dhe të kuptuarit e domethënies dhe rëndësisë së dinamikës së grupit në arsimin për të rritur, dhe larmisë së tyre për sa i përket parimeve teorike, formave dhe karakteristikave të grupeve të të nxënit, dhe zhvillimit të shkathtësive për të nxënë më mirë dhe marrëdhënie më të mira në grup.</p> <p><i>Rezultati i përgjithshëm i të nxënit:</i> Pas zbatimit të kësaj teme, nxënësit e njohin diversitetin dhe shumëllojshmërinë e punës në grup në arsimin dhe të nxënit e të rriturve, kuptojnë funksionet themelore të dinamikës së grupit dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në arsimin për të rritur.</p>		
Nën-tema	Synimi	Rezultati
<b>7. Teoritë dhe parimet e punës në grup</b>	Prezantimi i teorive themelore dhe implikimeve të tyre për të kuptuarit e punës në grup në të nxënit e të rriturve	Nxënësit e dinë thelbin dhe parimet e teorive bazë të punës në grup dhe i lidhin ato me të nxënit e të rriturve
<b>8. Format dhe karakteristikat e grupeve të të nxënit</b>	Prezantimi dhe analizimi i formave dhe karakteristikave të grupeve të të nxënit	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Nxënësit i dinë karakteristikat e grupeve të të nxënit.</li> <li>– Nxënësit janë në gjendje të njohin dhe shpjegojnë të gjitha tiparet e rëndësishme të grupit të të nxënit.</li> </ul>

## 6.1. Teoria dhe parimi i punës në grup

Teoria e sistemeve përshkruan si sillen individët brenda një sistemi. Sipas teorisë grupet janë sisteme të hapura, të cilat ndikohen nga ndryshorë të pavarur si; hapja ndaj mjedisit, ndërvarësia, ndryshorët e inputeve, ndryshorët e procesit dhe ndryshoret e produktit. Teksa grupet konsiderohen sisteme, teoria e sistemeve na ndihmon të fillojmë të kuptojmë dinamikën e grupit. Teoria e sistemeve përfshin të kuptuarit se dinamika e grupit është një proces më kompleks sesa thjesht përmbledhja e karakteristikave individuale të secilit anëtar të grupit. Në vend të kësaj, dinamika e grupit kuptohet më së miri duke kombinuar karakteristikat e secilit anëtar të grupit, si ndikojnë veprimet e secilit anëtar të grupit në grup dhe si ndikojnë këto ndërveprime në grup tek secili anëtar i grupit. Kjo krijon një lak reagimesh ciklike dhe reciproke, i cili njëkohësisht ndikon në të gjithë anëtarët e grupit dhe të gjitha marrëdhëniet e grupit.



Teoria e fushës (Kurt Lewin) përshkruan efektet e tre stileve të ndryshme të udhëheqjes në rezultatet e punës në grup. Tre stilet e ndryshme u klasifikuan si demokratik, autokratik dhe laissez-faire. U zbulua se në grupin me drejtues autokratik, kishte më shumë pakënaqësi dhe sjelljet bëhen më agresive ose apatike. Në grupin me udhëheqës demokratik, kishte më shumë bashkëpunim dhe kënaqësi, ndërsa ata në grupin e udhëhequr nga laissez-faire nuk treguan ndonjë pakënaqësi të veçantë, por ata nuk ishin veçanërisht produktivë.

Teoria e fushës ka një ndikim në një gjeneratë studiuesish dhe mendimtarësh që merren me dinamikën e grupit. Në veçanti, dy ide kyçe që dolën nga teoria e fushës, argumentohet se janë thelbësore për një vlerësim të proceseve në grup; ato janë ndërvarësia e fatit dhe ndërvarësia e detyrave.

Modeli i kostelacionit ndërtohet nga një këndvështrim i sistemeve dhe thotë se për të qenë një grup i suksesshëm, duhet të marren parasysh të gjithë ndryshorët e mundshëm të dërguesit, marrësit dhe mesazhit, që ndodhin në një grup të vogël. Modeli pohon se ekziston një marrëdhënie mes komunikimit, udhëheqjes, synimeve, normave, roleve, kohezionit dhe situatës. Secili duhet të analizohet për të përcaktuar efektivitetin e grupit. Modeli i kostelacionit tregon qartë si mund të ndikojë një anëtar i një grupi tek të tjerët në grup bazuar në shkathtësitë e tij/saj të komunikimit. Ndërlidhshmëria e tipareve të komunikimit është thelbësore për efektivitetin e një anëtari të grupit, dhe vetëdija për këtë fakt, që portretizohet Beebe dhe Masterson, është shumë informuese nga pikëpamja komunikuese.

Parimet themelore të punës në grup që janë të rëndësishme për praktikën e të nxënit dhe mësimdhënies:

- Anëtarët e grupit duhet të kenë një ndjenjë të fortë të përkatësisë në grup.
- Grupi shfaqet dhe funksionon në bazë të motiveve të përbashkëta.
- Grupet mbijetojnë duke i vendosur anëtarët në hierarki funksionale dhe duke lehtësuar veprimin drejt synimeve.
- Ndryshimet në një pjesë të grupit mund të shkaktojnë stres në një person tjetër, stres i cili mund të zvogëlohet vetëm duke i eliminuar pjesët e lidhura ose duke lejuar ndryshimin rregullues në to.
- Informacioni në lidhje me nevojat për ndryshim, planet për ndryshime dhe pasojat e ndryshimeve duhet të ndahen nga anëtarët e një grupi.
- Marrëdhëniet ndër-grupore, organizimi në grup dhe pjesëmarrja e anëtarëve është thelbësore për efektivitetin e një grupi.

**Tabela 6.1: Sugjerim për zbatimin kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Teoria dhe parimi i punës në grup
Synimi	Prezantimi i teorisë themelore dhe implikimeve të saj për të kuptuarit e punës në grup në të nxënit e të rriturve
Metodat dhe teknikat	Ligjëratë, diskutime.
Korniza kohore	30 min.
Burimet e kërkuara	Tabela e zezë, burimet e shkrimit
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	Mësimdhënësi do të jetë përgjegjës për lehtësimin e një mësimi që tregon një teori dhe parim të veçantë të punës në grup. Gjatë kësaj kohe, nxënësit do të jenë përgjegjës për (a) shpjegimin e themeleve të teorisë dhe parimeve, (b) aplikimin e teorisë dhe parimeve në jetën reale dhe situata në grup, (c) diskutimin se si teoria informon hulumtimin dhe praktikën, dhe (d) angazhimin e nxënësve në një mënyrë ndërvepruese për të përmirësuar të kuptuarit e teorisë.

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Punë grup ose punë në dyshe (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave mes nxënësve);  
 Analiza e tekstit me përkufizime të ndryshme të punës në grup...

## 6.2. Format dhe karakteristikat e grupeve të të nxënit

Studimi i grupeve dhe proceseve të ndërveprimit që ndodhin atje ka paraqitur interes për shumë studiues në zhvillimin e teorisë dhe praktikës andragogjike. Marrëdhëniet që vendosen mes anëtarëve të grupit, ndërveprimi i tyre, niveli i komunikimit dhe klima socio-emocionale që mbizotëron brenda grupit kanë një rëndësi të veçantë për mbijetesën e grupit, por në mënyrë të barabartë, nëse jo më shumë, janë të rëndësishme për arritjen e synimeve dhe objektivave të grupit në tërësi dhe për arritjen e synimeve dhe objektivave individuale të anëtarëve të tij.

“Grupi është një formacion shoqëror i dallueshëm, i strukturuar, relativisht i përhershëm, koheziv, i bazuar në interesa të ndërsjella dhe vlera shoqërore, anëtarët e të cilit kanë rolet reciproke, falë synimeve të tyre të përbashkëta dhe në përputhje me standardet e pranuar të vlerësimit të normave të sjelljes”.<sup>14</sup>

Për ta përcaktuar thelbin e grupit në mënyrë më adekuate dhe të saktë, është e nevojshme që të merren parasysh disa karakteristika të tjera, siç janë:

- grupet kanë përmasa të përcaktuara dhe të matshme;
- secili grup është i ndarë në një mënyrë të caktuar, ka një qendër takimi dhe është i dallueshëm nga komunitetet, organizatat dhe institucionet e tjera shoqërore;
- Anëtarët e grupit janë të detyruar në hapësirë dhe kohë, ata marrin pjesë në një kohë të caktuar në realizimin e detyrave të grupit, pasi anëtarët e tij kryejnë funksione specifike;
- grupet posedojnë një shkallë të caktuar të lidhjes së brendshme fizike dhe shpirtërore; përveç lidhjes së brendshme, anëtarët e grupit ndajnë një ndjenjë të përgjegjësisë personale për anëtarët e tjerë të grupit;
- komunikimi mbahet brenda grupit mes anëtarëve të tij;
- synimet e përbashkëta çojnë në solidaritet mes anëtarëve të grupit;
- grupi ka një strukturë të brendshme - ka ndryshime mes roleve dhe statusit brenda grupit, dhe ndarje së brendshme të punës, lëvizshmërisë shoqërore, etj.

*Grupi i të nxënit është një komunitet mikro-social me lidhje të fortë të brendshme dhe konsistencë, të siguruar nga uniteti i nevojave arsimore dhe synimeve arsimore, me lidhje të forta ndërvepruese sociale (shoqëri, miqësi, solidaritet, opinion grupi), me strukturë të përshtatshme funksionesh dhe hierarki të marrëdhënieve, me vlera afërsisht të ngjashme shoqërore, dhe kështu edhe sjellje shoqërore.”<sup>15</sup>*

---

<sup>14</sup> Samolovcev, Borivoj, *Andragogji e përgjithshme*, Universiteti “Kiril dhe Metodi” - Shkup, 1981.

<sup>15</sup> Samolovcev, Borivoj, *Andragogji e përgjithshme*, Universiteti “Kiril dhe Metodi” - Shkup, 1981

*Ky përkufizim i përmban të gjitha tiparet domethënëse të grupit të të nxënit, përkatësisht:*

### a) Lidhja e brendshme dhe konsistenca

Lidhja e brendshme dhe konsistenca e grupit kanë një rëndësi të jashtëzakonshme që në fillim, në periudhën e krijimit të grupit të të nxënit dhe gjithashtu më vonë gjatë funksionimit të tij. Fuqia e tij e brendshme është baza në të cilën varet sjellja e përgjithshme shoqërore e anëtarëve të grupit, si dhe aftësitë e anëtarëve të tij për punën në grup dhe efektet përfundimtare të procesit të të nxënit.



Anëtarët e grupit përpiqen ta mbajnë grupin dhe të kontribuojnë në përmbushjen e synimeve të përbashkëta. Konsistenca ndikohet nga një numër faktorësh, më të rëndësishmit e të cilëve janë: përmasa e grupit, lloji i organizimit të grupit, atmosfera në grup dhe mënyra e punës. Lidhja e brendshme e një grupi është një shenjë e pjekurisë dhe aftësisë së tij për të përmbushur nevojat e anëtarëve të vet.

Lidhja brenda grupit përcaktohet në mënyra të ndryshme: si tërheqje reciproke e anëtarëve të grupit, si unitet i anëtarëve të grupit në lidhje me çështje të ndryshme dhe si koordinim i përpjekjeve të investuara nga anëtarët e grupit.

KOHEZIONI		
Burimet	Treguesit	Efektet
Themeli motivues i grupit	Dëshira për të mbetur në grup	Forca e grupit për t'i mbajtur anëtarët
Karakteristikat e grupit	Identifikimi me grupin	Fuqia e ndikimit të grupit
Pritjet e anëtarëve	Arritja e synimeve të grupit	Përfshirja e anëtarëve në zgjidhjen e detyrave në grup
	Besnikëria ndaj grupit	Ndjësia e sigurisë mes anëtarëve

Sipas Cartwright, 1968<sup>16</sup>

Nëse një person u bashkua me grupin e të nxënit duke pritur të plotësojë nevoja dhe synime specifike arsimore, dhe kjo nuk ndodhi, ka shumë gjasa që lidhja e tij/saj me grupin të bjerë.

### b) Uniteti i nevojave arsimore dhe synimeve arsimore

Të rriturit janë persona të pjekur, të aftë të marrin vendimet e tyre mbi bazën e konkluzioneve racionale, të motivuar nga nevoja të ndryshme dhe inkurajohen nga synimet që dëshirojnë të arrijnë. Edhe pse këto nevoja janë individuale për secilin anëtar të grupit të të nxënit, ato megjithatë paraqiten si një faktor që ndikon në procesin e bashkimit të anëtarëve të grupit. Megjithëse niveli i pritjeve është i ndryshëm për secilin anëtar, nevojat kanë një origjinë relativisht të ngjashme dhe bëhen një lidhje e fortë mes tyre.

<sup>16</sup> Dorwin Cartwright, Alvin Frederick Zander, Dinamika e Grupit, Harper & Row, 1968


### c) Ndërveprimi.

Ekzistimi i lidhjeve ndërvepruese sociale mes anëtarëve të grupit është i pashmangshëm, nëse marrim parasysh unitetin e synimeve arsimore dhe nevojave brenda grupit. Mësimdhënësi ka një pozicion qendror në vendosjen dhe zhvillimin e ndërveprimit në grup. Ai/ajo e organizon dhe drejton procesin e arsimit në grup dhe inicion reagimet e anëtarëve të grupit, duke stimuluar marrëdhëniet bashkëpunuese që zhvillohen mes tyre. Mësimdhënësi, i ndihmuar nga përzgjedhja e përmbajtjes dhe veçanërisht nga përzgjedhja e teknikave të punës, gradualisht ndikon në krijimin e marrëdhënieve bashkëpunuese që shpesh zhvillohen jashtë procesit të mësimdhënies dhe rriten në marrëdhënie të shkallës më të lartë - në miqësi.



### d) Struktura e zhvilluar e marrëdhënieve

Organizimi dhe struktura e marrëdhënieve në grup është një tjetër faktor i rëndësishëm për kohezionin në grup. Struktura e marrëdhënies varet nga rolet dhe funksionet e anëtarëve të grupit, dhe përbëhet nga mësimdhënësi dhe anëtarët e grupit. Me kohë, secili anëtar do të marrë një rol ose funksion në punën e grupit. Çfarë roli dhe funksioni merr secili anëtar i grupit varet kryesisht nga aftësitë, synimet dhe karakteristikat e tij/saj.



### e) Vlerat relativisht të përbashkëta shoqërore

Anëtarët e grupit posedojnë një orientim relativisht të përbashkët të vlerave, pra qëndrime të ngjashme ndaj vlerave themelore në shoqëri, dhe gjithashtu ndaj vlerave të grupit të të nxëniet të cilit i përkasin vetë.

### f) Rolet

Ekzistojnë tre aktivitete kryesore që mësimdhënësit e grupit duhet të menaxhojnë njëkohësisht:

- menaxhimi i grupit
- aktivitetet e menaxhimit
- menaxhimi i të nxëniet.

Në shumë situata të mësimdhënies në grup, roli i mësimdhënësit është ai i lehtësuesit të të nxëniet: udhëheqja e diskutimeve, bërja e pyetjeve të hapura, procesi udhëzues dhe detyrat, dhe mundësia i pjesëmarrjes aktive të nxënësve dhe angazhimi me ide. Prandaj mësimdhënësit duhet të jenë në gjendje të përvetësojnë një sërë rolesh dhe shkathtësish për t'iu përshtatur situatave specifike, shpesh gjatë të njëjtës seancë të mësimdhënies.

Për të kuptuar se si funksionon një grup është e nevojshme të shikohen rolet e anëtarëve individualë të grupit. "Rolet" përshkruajnë si sillen njerëzit, si kontribuojnë dhe lidhen me të tjerët, me fjalë të tjera në përpikëmi të kategorizojmë llojet e personalitetit në mënyrë që pikat e forta dhe të dobëta të mund të identifikohen dhe njihen në mesin e grupit.

**Lehtësuesi:** mban grupin në detyrë; lehtëson pjesëmarrjen e të tjerëve; ndihmon për të mbajtur kanale të hapura komunikimi; sugjeron procedura që lejojnë ndarjen e vërejtjeve.

**Iniciatori:** sugjeron mënyra për të zgjidhur një problem; propozon detyra ose synime; përcakton një problem në grup.

**Menaxheri i burimeve;** mbledh stilolapsa/letër etj.

**Energjizuesi:** stimulon anëtarët e grupit për të vepruar dhe ngritur nivelin e veprimeve të tyre.

**Dhënësi i opinionit:** ofron informacione përkatëse; deklaron një opinion; jep sugjerime dhe ide.

**Inkurajuesi:** është miqësor, i ngrohtë dhe reagues ndaj të tjerëve; tregon me anë të shprehjes së fytyrës ose vëren pranimit e kontributeve të të tjerëve.

**Sqaruesi dhe shtjelluesi:** pastron konfuzionin; përcakton termat; interpreton ide ose sugjerime; tregon alternativa dhe çështje para grupit.

**Harmonizuesi:** harmonizon dhe zgjidh konfliktet.

**Përmbledhësi:** ofron një vendim ose përfundim që grupi ta pranojë ose refuzojë; përsërit sugjerime pasi grupi t'i ketë diskutuar.

**Kompromis-gjetësi:** ofron një kompromis që jep status.

**Pasuesi:** pranon idetë e grupit dhe dëgjon diskutimin dhe vendimet e tyre

**Dominuesi:** mban monologë të gjatë; ndërpret të tjerët; përpiqet të udhëheqë grupin dhe të vendosë autoritet.

**Negativisti:** mban qëndrim negativ për çështjet; hedh poshtë idetë e sugjeruara nga të tjerët; argumenton shpesh dhe pa nevojë; është pesimist, nuk pranon të bashkëpunojë.

**Agresori:** përpiqet të marrë vëmendjen; kritikon ose fajëson të tjerët; prish rëndësinë ose pozicionin e të tjerëve në grup; tregon zemërim ose acarim ndaj grupit ose individëve.

**Tregimtari:** i pëlqen të tregojë histori të gjata të cilat nuk janë të rëndësishme për grupin.

**Ndërprerësi:** futen në brenda; flet njëkohësisht me të tjerët.

**Përfaqësuesi i ekipit:** merr pjesë në çdo mbledhje informacioni dhe flet me grupin për reagimet.

## **g) Përmasa e grupit**

Sa më i madh të jetë grupi, aq më e vështirë është të zhvillohet një ndërveprim efikas. Në raste të tilla është e nevojshme që grupi të ndahet në disa nëngrupe. Puna në grupe më të vogla lejon kontakt më të madh ndërmjet anëtarëve të grupit dhe i mundëson mësimdhënësit t'i monitorojë më lehtë. Grupet më të vogla zakonisht përbëhen nga 6 deri në 8 anëtarë.

**Tabela 6.2: Sugjerim për zbatimin kësaj nën-teme:**

<b>Nën-tema</b>	<b>Format dhe karakteristikat e grupeve të të nxënit</b>
<b>Synimi</b>	Prezantimi dhe analizimi i formave dhe karakteristikave të grupeve të të nxënit
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, diskutime, punë në grup, lojë rolesh, prezantime
<b>Korniza kohore</b>	60 min.
<b>Burimet e kërkuara</b>	Letër tabelle, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	<p>Ky ushtrim bëhet shpesh pasi një grup ka qenë së bashku për një periudhë kohe, në mënyrë që të jenë shfaqur rolet në grup. Ju i njoftoni grupit se do t'ju duhen disa prej tyre për të luajtur disa role që shpesh gjenden në grupe. Thoni se ju nevojiten tetë (gjashtë deri në dhjetë) vullnetarë për të luajtur role dhe ata do t'i tërheqin rolet e tyre rastësisht nga një kapelë (shportë). Secili rol përshkruhet dhe secili do të ketë një ose dy synime që demonstronjë disa karakteristika të rolit. Në prezantimin tuaj, bëjeni që të duket si argëtues, sepse ashtu është në shumicën e situatave.</p> <p>Lojtarët e roleve do të ulen në një rreth përballë njëri-tjetrit në mes të dhomës, ndërsa pjesa tjetër e grupit bëhen vëzhgues. Detyra e tyre do të jetë përcaktimi i secilit rol. Vëzhguesit pastaj do të tregojnë atë që vëzhguan dhe më pas aktorët do të tregojnë se si ishte të luante rolin.”</p>

***Sugjerime didaktike***

Kjo njësi e të nxënit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:

Obelisku ZIN (i cili është një formë tërheqëse, interesante dhe dinamike për të zbuluar se si merren vendimet dhe si merren rolet tipike në një grup)

Punë grup ose punë në dyshe (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave mes nxënësve).

## Tema 7: Dinamika e grupit

Tema 7 adreson temën më të gjerë të dinamikës së grupit (proceset, aktivitetet dhe ndryshimet që ndodhin në grup), si dhe fazat e formimit të grupit dhe fazat e zhvillimit të grupit, të cilat mund të vërehen nga këndvështrime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme. Ajo ka dy nën-tema specifike të cilat janë përqendruar në elemente të ndryshme të Temës kryesore dhe janë paraqitur në Doracak me përshkrime të synimeve të të nxënësve dhe rezultateve të të nxënësve. Arsimitarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe diturive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënësve.

Qëllimi kryesor i kësaj teme është të kuptohet komunikimi si pjesë përbërëse e arsimit për të rritur, dhe larmia e tij në aspektin e formave dhe zbatimit, si dhe rëndësia e tij për të nxënësve efektiv dhe zhvillimin personal.

**Tabela 7:** Nën-temat, synimet e të nxënësve dhe rezultatet e të nxënësve për zbatimin e temës

<i>Synimi i të nxënësve:</i> Hyrje në parimet themelore teorike dhe karakteristikat kyçe të dinamikës së grupit dhe kulturës së grupit dhe të kuptuarit e domethënies dhe rëndësisë së dinamikës së grupit në arsimin për të rritur, dhe larmisë së tyre për sa i përket parimeve teorike, formave dhe karakteristikave të grupeve të të nxënësve, dhe zhvillimit të shkathtësive për të nxënë më mirë dhe marrëdhënie më të mira në grup.		
<i>Rezultati i përgjithshëm i të nxënësve:</i> Pas zbatimit të kësaj teme, nxënësit e njohin diversitetin dhe shumëllojshmërinë e punës në grup në arsimin dhe të nxënësve e të rriturve, kuptojnë funksionet themelore të dinamikës së grupit dhe rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në arsimin për të rritur.		
Nën-tema	Synimi	Rezultati
<b>1. Fazat e formimit të grupit</b>	Prezantimi dhe analizimi i të gjitha fazave të formimit të grupit.	Nxënësit janë në gjendje të njohin dhe shpjegojnë të gjitha fazat e formimit të grupit.
<b>2. Fazat e zhvillimit të grupit</b>	Prezantimi dhe analizimi i të gjitha fazave të zhvillimit të grupit.	Nxënësit janë në gjendje të njohin dhe shpjegojnë të gjitha fazat e zhvillimit të grupit.

Një grup është i përbërë nga anëtarë, marrëdhëniet dhe ndikimet e ndërsjella të të cilave përbëjnë thelbin e funksionimit të grupit. Përpjekjet e anëtarëve për ruajtjen e grupit ose për arritjen e synimeve manifestohen përmes ndërveprimeve të tyre të ndryshme. Dinamika është e rëndësishme për grupin, proceset që ndodhin brenda grupit dhe ndryshimet që vijnë nga këto aktivitete dhe procese.

Dinamika e grupit pasqyron proceset, aktivitetet dhe ndryshimet që ndodhin në grup, mbi bazën e të cilave ekziston dhe funksionon vetë grupi, kryesisht ato që lejojnë që grupi të ekzistojë, të përmbushë detyrat e veta dhe të arrijë synimet e veta.

Nga pikëpamja e anëtarëve të grupit si individë dhe grup në tërësi, duhet të shqyrtohen dy lloje të proceseve që ndodhin në një grup. Së pari, proceset që sjellin ndryshime të përhershme në karakteristikat e anëtarëve të grupit dhe që shikohen si rezultat i socializimit. Së dyti, proceset ndërvepruese të anëtarëve të grupit që çojnë në ndryshime të përkohshme në sjelljen e individëve, në



ndryshime në marrëdhëniet mes tyre dhe mbi të gjitha në ekzekutimin e detyrave në grup dhe realizimin e synimeve të grupit. Dinamika e grupit është e interesuar në këto procese dhe karakteristikat e tyre, si në proceset që kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin e grupit, ashtu edhe në ato që çojnë në shpërbërje dhe përfundimisht në ndarje.

## 7.1. Fazat e formimit të grupit

Efektet e punës në një grup të të nxënit varen, ndër të tjera, nga marrëdhëniet mes anëtarëve të grupit dhe proceset e ndërveprimit që ndodhin brenda grupit. Integrimi në grup dhe proceset e tërheqjes reciproke ose refuzimit të anëtarëve të grupit ndikohen nga një numër faktorësh, të brendshëm për vetë grupin dhe gjithashtu të jashtëm. Faktorët e brendshëm përfshijnë marrëdhëniet e vendosura mes arsimtarëve dhe anëtarëve të grupit, mënyrën e udhëheqjes së grupit, statusin e anëtarëve të grupit, ndërsa faktorët e jashtëm përfshijnë të gjitha ato informacione dhe ndikime që dëgjuesit marrin nga mjedisi i jashtëm dhe nuk lidhen drejtpërdrejt me procesin e të nxënit.



Mbledhja e individëve në të njëjtin vend në të njëjtën kohë jo domosdoshmërisht i bën ata grup. Një grup fillon të zhvillohet me fillimin e veprimtarive të përbashkëta dhe ndërveprimeve mes anëtarëve të tij. Një grup është shumë më tepër sesa një shumë e thjeshtë e pjesëmarrësve.

Procesi i formimit të një grupi është gradual. Zhvillimi i integritit mes anëtarëve të grupit më së shpeshti përfshin disa faza: 1) para-integrimi, 2) vendosja e kontakteve të para, 3) integrimi dhe 4) pas-integrimi.

Faza e **para-integritit** fillon kur një individ vendos të marrë pjesë në një proces të të nxënit dhe përfundon me momentin e përfshirjes. Kontaktet e para mes anëtarëve në grupin e të nxënit kanë për qëllim zhvillimin e një qëndrimi pozitiv ndaj grupit si një mjedis i ri shoqëror, ku ata mund të arrijnë vetë-realizimin dhe përmbushjen e synimeve të tyre personale. Përvoja e parë emocionale dhe lidhja e pjesëmarrësve me grupin ndodh gjatë kësaj faze.

Gjatë fazës së **vendosjes së kontakteve të para** shfaqen marrëdhënie: mësimdhënës-grup dhe anëtar-anëtar, dhe vendosen kontaktet e para. Organizimi i këtyre kontakteve të para ka një ndikim pozitiv mbi integrimin në grup. Sjellja dhe komunikimi mes anëtarëve të grupit gjatë këtyre takimeve të para është mjaft formal dhe kryesisht përqendrohet në prezantime, njohje me planin dhe programin e punës, prezantimin e historikut, funksionit dhe rregullave të sjelljes në institucionin ku zhvillohet procesi i mësimdhënies.



Faza e **integritit** ndodh zakonisht me një ritëm të ngadaltë dhe fluks zhvillimor. Këtu, përcaktohen dhe ndërmerren detyra individuale. Në këtë periudhë, puna e përbashkët përparon ngadalë, e mbështetur nga aplikimi i teknikave të duhura të punës. Krijimi i një atmosfere pune në grup është i rëndësishëm për integrimin e anëtarëve të tij. Mësimdhënësi e ushqen atmosferën e punës në grup duke inkurajuar aktivitete të përbashkëta, ndarjen e duhur të detyrave në përputhje me karakteristikat individuale të anëtarëve, sigurimin e reagimeve mbi suksesin dhe përparimin në përpjekjet përkatëse.



**Faktorët që ndikojnë në procesin e integritit të grupit, dhe në zhvillimin e grupit, përfshijnë:**

- Përgatitja paraprake e nxënësve;
- Struktura e statusit të anëtarëve të grupit;
- Përmasa e grupit;
- Zhvillimi i lidhjeve sociale ose mekanizmave të jetës në grup dhe punë;
- Struktura moshore e anëtarëve të grupit;
- Mënyra e adresimit të njëri tjetrit;
- Zhvillimi arsimor dhe motivues i anëtarëve;
- Mësimdhënësi;
- Udhëzimi dhe mënyra e punës; dhe
- Komunikimi brenda grupit.

Faza e **pas-integritit** përfshin periudhën pasi procesi i të nxënësve është i plotë dhe grupi formalisht nuk ekziston, por anëtarët sidoqoftë vazhdojnë të komunikojnë me njëri tjetrin. Procesin e integritit nuk e ndalon ndikimin e tij edhe pas përfundimit të procesit të organizuar të të nxënësve. Rezultatet nga puna në grup, përvoja dhe dituritë e fituara, niveli i arritur i integritit dhe stili i mirë i udhëzimit, vazhdojnë të ndikojnë tek të rriturit në një mënyrë që edhe pas përfundimit të një procesi specifik të arsimit, ata ende janë të interesuar për të nxënë, arsimuar dhe vetë-arsimuar.

Mësimdhënësit duhet t'i njohin shenjat ose treguesit e zhvillimit të aftësisë së grupit për të funksionuar. Këto indikacione shërbejnë si pikë referimi për përcaktimin e rritjes së grupit ose fazës së zhvillimit në të cilën është grupi.

<b>Shenjat e rritjes së grupit:</b>	
<b>Adaptimi</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Rritja e hapjes së anëtarëve</li><li>- Aftësia për të zgjeruar kontaktet në grup</li><li>- Aftësia për të ndryshuar zakonet dhe rregullat në grup në bazë të informacionit të ri</li><li>- Balancimi i suksesshëm i “Unë” dhe “Të tjerëve”.</li></ul>
<b>Arritja e synimit</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Aftësia për të mbajtur parasysht synimet alternative gjatë procesit të arritjes së synimit</li><li>- Aftësia për të ndryshuar synimin</li></ul>
<b>Integriti</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Aftësia për të garantuar lirinë e zgjedhjes për anëtarët e grupit</li><li>- Orientimi drejt realitetit</li></ul>
<b>Ruajtja dhe zgjerimi i strukturës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Aftësia për të pranuar anëtarët e rinj dhe induksionin e tyre në grup</li><li>- Aftësia për të shumëzuar përvojat në grup, për të nxënë prej tyre dhe për t'i përcjellë ato në grupe të tjera</li><li>- Transferimi i jashtëm</li></ul>

Sipas Karlheinz A. Geißler

Grupi i të nxënësve arrin kulmin e rritjes së tij kur i përvetëson të gjitha tiparet e një ekipi dhe punës ekipore.

Një grup bëhet ekip kur<sup>17</sup>:

- anëtarët e tij ndiejnë një ndjenjë të pronësisë mbi punën e tyre dhe një përkushtim ndaj objektivave të përcaktuara së bashku;
- ka të kuptuar të përbashkët se synimet personale dhe ekipore arrihen më së miri me mbështetje reciproke;
- ka vendimmarrje pjesëmarrëse;
- anëtarët mund të kontribuojnë burimet e tyre personale, cilësitë dhe kompetencat për suksesin e punës;
- ekziston një klimë besimi dhe inkurajimi për të shprehur ide, opinione, mosmarrëveshje, ndjenja dhe pyetje, ku anëtarët bëjnë përpjekje për të kuptuar këndvështrimin e njëri tjetrit;
- anëtarët inkurajohen të zhvillojnë shkathtësitë e tyre dhe t'i zbatojnë gjatë punës;
- Konflikti konsiderohet një aspekt normal i ndërveprimit dhe shihet si një mundësi për ide të reja, kreativitet dhe përmirësim.



**Tabela 7.1:** Sugjerim për zbatimin kësaj nën-teme:

Nën-tema	Fazat e formimit të grupit
<b>Synimi</b>	Prezantimi dhe analizimi i të gjitha fazave të formimit të grupit.
<b>Metodat dhe teknikat</b>	Ligjëratë, demonstrim, diskutime, prezantime, ndërtimi i një piramide
<b>Korniza kohore</b>	30 min.
<b>Burimet e kërkuara</b>	Gota plastike, llastik gome (1 për grup), fije 20 cm (për secilin person)
<b>Materiali i kërkuar didaktik</b>	Prezantim me PowerPoint
<b>Procedura</b>	<p>Kërkojuni nxënësve të gjejnë 6 fjalë që janë thelbësore për një grup të mirë (p.sh. besimi, komunikimi).</p> <p>Jepuni 6 gota plastike për secilën tavolinë/grup dhe u thuajini të shkruajnë një fjalë në secilën gotë.</p> <p>Pasi të etiketojnë gotat e tyre, jepuni fije (1 për person) dhe 1 llastik gome Duke përdorur fijen dhe llastikun, ata duhet të ndërtojnë një piramidë me gota</p> <p>Ata nuk mund t'i prekin gotat dhe duhet të përdorin vetëm mjetin.</p> <p>Secili nxënës duhet të përdorë të paktën 1 fije. Pyetini për fjalët që zgjodhën dhe si punuan si ekip.</p> <p>Pyetje</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sa e lehtë apo e vështirë ishte ky aktivitet?</li> <li>- Kur ju tregua për herë të parë detyra, cilat ishin mendimet tuaja të menjëhershme?</li> <li>- Çfarë ju duhej të ishit të suksesshëm? Apo, çfarë do të duhej të bënit për të qenë të suksesshëm?</li> </ul>

**Sugjerime didaktike**

Kjo njësi e të nxënësve mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Ulja e NASA-s në Hënë (çka është një formë tërheqëse, interesante dhe dinamike për të kuptuar ndikimin e pajtimit në grup dhe presionit të grupit, dhe krahason efikasitetin e individit dhe grupit)  
 Punë grup ose punë në dyshe (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave mes nxënësve)

<sup>17</sup> T-Kit 6: Trajnimi themelor (2002), Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian

## 7.2. Fazat e zhvillimit të grupit<sup>18</sup>

Dinamika e grupit nuk është kurrë konstante dhe nuk ndodh kurrë me të njëjtin ritëm. Ka nivelet e larta dhe të ulëta dhe varet nga faza e zhvillimit ku është grupi.

### Faza e orientimit

Kjo fazë mund të njihet nga fakti se grupi nuk ekziston ende si i tillë. Secili pjesëmarrës është i përqendruar në situatën, nevojat dhe synimet e tij/saj individuale. Sjellja e kujdesshme dhe pasiguria mbizotërojnë. Pjesëmarrësit kërkojnë dhe përqendrohen te mësimdhënësi. Në këtë fazë, ai/ajo luan një rol qendror dhe të gjithë janë të përqendruar tek ai/ajo.

Gjëja e parë e përbashkët në lidhje me anëtarët e grupit është se ata nuk kanë asgjë të përbashkët; prandaj të gjithë janë shumë të varur nga mësimdhënësi dhe pranojnë të gjitha udhëzimet e dhëna nga ai/ajo.

Meqenëse kjo fazë e parë është për “orientim”, mësimdhënësi duhet të ndërmarrë veprime në këtë drejtim.

#### **Udhëzimi i procesit:**

Mësimdhënësi duhet të jetë i përqendruar në uljen e pasigurive. Ai/ajo së pari duhet të punojë për krijimin e unitetit mes anëtarëve në mënyrë që ai/ajo më vonë, në bazë të këtij uniteti, të nxjerrë në pah dallimet që ekzistojnë mes anëtarëve të grupit. Udhëzimi relativisht i drejtpërdrejtë nga mësimdhënësit këshillohet që në fillim.

### Faza e diferencimit

Në këtë fazë pjesëmarrësit tashmë kanë një përshtypje se si janë anëtarët, dhe kjo i bën ata të ndihen më të sigurt. Disa shohin që disa prej pritjeve të tyre janë përmbushur ose do të përmbushen, ndërsa të tjerët jo. Me kalimin e kohës, për shkak të kësaj, disa pjesëmarrës do të ndiejnë ose demonstronë zhgënjim, shqetësim ose kritikë. Teksa ndjenja e varësisë nga mësimdhënësi zvogëlohet pasi të jetë marrë orientimi bazë, pjesëmarrësit individualë janë në këtë fazë në gjendje të rezistojnë ndaj kërkesave të mësimdhënësve, udhëzimeve dhe mënyrës së punës. Mes pjesëmarrësve zhvillohen rritja e konkurrencës dhe rivaliteti. Shfaqen fraksione dhe nëngrupe joformale dhe diferencimi përkatës i roleve. Shpesh, në këtë fazë mes anëtarëve individualë të grupit shfaqen konflikte dhe keqkuptime. Reagimet më të shpeshta përfshijnë mungesën, ngadalësimin ose shqetësimin gjatë aktiviteteve.

Niveli i agresionit në grup ngrihet, dhe bashkë me të, hapja ndaj ndjenjave. Shpesh shfaqen argumentet personale, distanca ose koalicionet në lidhje me detyrat dhe temat.

Pjesëmarrësit dëshirojnë të marrin pjesë në ndikimin e procesit. Ata i shprehin qartë interesat e tyre dhe fillojnë të kërkojnë partnerë me të cilët ndajnë ngjashmëri, përmes pyetjeve të mëposhtme:

“Kush është si unë?”

“Me kë duhet të jem i kujdesshëm?”

“Kujt mund t’i besoj?”

“Çfarë duhet të bëj në mënyrë që opinioni im të dëgjohet dhe respektohet?”

<sup>18</sup> Sipas: Dorwin Cartwright, Alvin Frederick Zander, Dinamika e Grupit, Harper & Row, 1968

“Me kë mund ta kuptoja veten lehtë?”

Këto pyetje dhe kërkimi i përgjigjeve ndikojnë në sjelljen e individit.

**Udhëzimi i procesit:**

Lejoni nxënësit të përjetojnë dhe të tejkalojnë nevojën e tyre për ndryshime, argumentime dhe solidaritet. Jini të rezervuar dhe mos lejoni që ata t’ju përfshijnë në këtë proces. Mos e merrni rolin e gjykatësit. Jepuni anëtarëve të grupit kohë dhe hapësirë për rivalitetet e tyre, për konkurrencën dhe nevojën e tyre për t’u distancuar. Prisni, shikoni, dëgjoni dhe vëzhgoni. Nëse ndërhyini, bëjeni hapur dhe qartë, edhe nëse ka nevojë për konfrontim. Përdorni konfrontim për inkurajim dhe jo parandalim. Ndhmoni anëtarët e grupit të gjejnë vendin e tyre brenda grupit.

Prerja e këtyre tendencave dhe ndalimi i dinamikës së tyre mund të ketë pasoja të dëmshme. Pa sqarime, rolet, pozicionet dhe strukturat e pushtetit dhe ndikimit mbeten të paqarta. Vetëm pasi të gjithë ta gjejnë vendin e tyre në grup, pasi të jetë e qartë se kush çka mund të bëjë, të dëshirojë apo të lejojë, mund të realizohet procesi i punës me intensitet më të lartë.

**Faza e aftësisë së punës**

Sqarimi i marrëdhënieve në fazën e mëparshme çon në përcaktimin e normave dhe rregullave të grupit, gjë që lehtëson punën dhe të nxëniet e qetë. Në përputhje me aftësitë e pjesëmarrësve, të cilat tashmë janë të njohura në këtë fazë, mund të ndërmerren funksione specifike në përputhje me nevojat përkatëse, por disa funksione edhe mund të dorëzohen dhe delegohen tek anëtarët e tjerë.

Diferenca në opinione dhe interesa është e pranueshme dhe mund të përdoret për një proces të të nxëniet krijues. Dinamika drejtohet nga parimi i realitetit. Ne zbulojmë se çfarë mund të bëjë grupi dhe çfarë jo, dhe çfarë mund të mësohet.

Në këtë fazë konfliktet paraqiten hapur, duke bërë përpjekje për të mos dëmtuar partnerët në proces. Pyetjet dhe çështjet që lidhen me materialin e përmbajtjes diskutohen hapur. Proces i të nxëniet është shumë i suksesshëm, dhe motivimi i pjesëmarrësve, në lidhje me përfshirjen rreth synimeve të të nxëniet, është i lartë.

Kjo është një fazë e një ndjenje të fortë dhe të qëndrueshme NE që përshkon grupin. Kjo “NE” do të bëhet një normë dhe do të fitojë rëndësi. Grupi është në gjendje dhe i gatshëm ta prezantojë veten në botën e jashtme. Formohen nën-grupe që nuk janë kërcënim për ekzistencën e të gjithë grupit. Hapja rrit integrimin e anëtarëve, i cili reflektohet pozitivisht në tërheqjen e grupit.

Grupi është i orientuar drejt synimit dhe vetë-korrigjohet në situata të vështira. Në këtë fazë, grupi mund të pranojë për herë të parë anëtarët e rinj pa frikë se krijojnë fraksione ose shpërbërje. Mbizotërojnë marrëdhëniet bashkëpunuese, dhe rezultatet i atribuohen të gjithë grupit, jo vetëm anëtarëve individualë.

Anëtarët e grupit ndihen të sigurt dhe të pranuar. Ata kanë një identitet të dyfishtë, një të subjektit individual dhe një të subjektit grupor. Ata mund të tregojnë dallimet dhe karakteristikat e tyre pa frikë dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat. Mundësitë për zhvillim individual janë vërejtur dhe përdorur; ata punojnë me kënaqësi dhe angazhim për arritjen e synimeve të të nxëniet. Është i

pranueshëm ekzistimi i synimeve të ndryshme të të nxënimit në mesin e anëtarëve të ndryshëm të grupit, dhe pranohet se realizimi i tyre nuk ka nevojë të ndiqet përmes konkurrencës. Ekziston një ndjenjë e afërsisë, dhe ekzistenca e mundshme e ftohtësisë mes anëtarëve të caktuar nuk është kërcënim për grupin.

#### **Udhëzimi i procesit:**

Udhëzimi duhet të kryhet me kufizim. Një pjesë e madhe e udhëzimeve mund t'u lihen në dorë anëtarëve të grupit. Këshillohet që në këtë fazë ta ndani punën në nëngrupe.

Udhëzimet dhe orientimet mund të kufizohen në formulimin e saktë të detyrës së re dhe përdorimin e asaj që është bërë ose mësuar më parë.

Vlerësoni në mënyrë kritike progresin në të nxënë dhe në zhvillimin e grupit, në mënyrë që të parandaloni tendenca jorealiste. Merrni parasysh synimet realiste të punës dhe mos lejoni shfaqjen e synimeve jorealiste të shkaktuara nga ambiciet e grupit.

#### **Faza e ndarjes**

Anëtarët e grupit shfaqin ndjenjën e ndarjes dhe ndjenja të dukshme të lumturisë dhe gëzimit për shkak të arritjeve, pikëllimit për shkak të ndarjes së ardhshme, dhe zhgënjimit për atë që nuk u arrit, nuk u mësua apo përjetua, por edhe të mirënjohjes dhe kënaqësisë për përvojën e fituar, miqtë e takuar dhe momentet e këndshme të kaluara së bashku.

Nga njëra anë, pjesëmarrësit janë ende duke punuar në grup, por po mendojnë për “botën e jashtme” dhe janë të shqetësuar për fundin. Ndjeshmëria në grup është e lartë, por jo e hapur. Sjellja është e rezervuar, niveli i frikës është i lartë dhe hapja po bie. Grupi lëviz drejt një situatë ku është sërish shuma e personave që nuk mund të shprehin individualitetin e tyre. Uniteti në këtë fazë është i kufizuar në vetëdijen dhe ndjenjën se nuk do të kenë më asgjë të përbashkët.

Ndjenjat e vetmisë dhe braktisjes parandalojnë aktivitetet e orientuara drejt synimeve të të nxënimit. Dëshira për t'u përfshirë në punën e grupit zvogëlohet; zvogëlohet edhe dëshira për të investuar në një komunitet shoqëror që po ndahet. Anëtarët përballen me pyetjet: Sa ndjenja mund të përballojnë? Çfarë nuk duhet të tregohet hapur? Kjo është pafuqia e fundit, e cila është në përpjesëtim me mungesën e orientimit që nga fillimi.

#### **Udhëzimi i procesit:**

Është e nevojshme që të udhëzoni me qartësi dhe vendosmëri. Është shumë e rëndësishme dhënia e kohës për grupin dhe të gjithë anëtarët e tij veç e veç. Do të ishte kundërproduktive që mësimi i fundit në një proces më të gjatë të mësimdhënies dhe të nxënimit t'i kushtohej përmbajtjes. Është edhe më pak efektive ta rëndoni fundin me kritikë ndaj veprimtarisë arsimore. Në këtë fazë, duhet të mbështesim kalimin kognitiv dhe emocional në situatën vijuese.

Fazat e paraqitura janë paraqitur idealisht, që do të thotë se ato nuk mund të njihen gjithmonë si të tilla ose të kenë strukturën dhe renditjen e mësipërme në një situatë praktike. Në praktikë, ato kurrë nuk janë identike si më lart. Kushtet e kornizës për proceset e mësimdhënies dhe të nxënimit dhe proceset e vetë-organizimit lejojnë vetëm një dinamikë të caktuar.

Vështirësitë që duhet të tejkalohen gjatë zhvillimit të grupit për të siguruar një nivel më të lartë të stabilitetit, integritit, aftësive të punës dhe përkushtimit, përfshijnë:

- Grupi duhet të krijojë rregulla dhe parime të qarta për anëtarësim;
- Duhet të vendosen kufijtë për tolerancën ndaj sjelljes së anëtarëve të grupit, kufij që përcaktojnë se cila sjellje është e pranueshme dhe cila jo;
- Pjesëmarrësit duhet të jenë të qartë se si të reagojnë ndaj sjelljeve të pazakonta ose sjelljeve që shqetësojnë të tjerët;
- Grupi duhet të krijojë një pasqyrë të qartë se kush e kryen cilin funksion;
- Anëtarët e grupit duhet të dinë se cilat aftësi, dituri dhe shkathtësi mund të sjellë secili anëtar në grup;
- Anëtarët e grupit duhet të dinë si të marrin vendime;
- Grupi duhet të zhvillojë synime dhe forma bashkëpunimi që ka të ngjarë të plotësojnë nevojat e anëtarëve;
- Anëtarët e grupit duhet të krijojnë metoda dhe mënyra për bashkëpunim dhe komunikim.

**Tabela 7.2: Sugjerim për zbatimin kësaj nën-teme:**

Nën-tema	Fazat e zhvillimit të grupit
Synimi	Prezantimi dhe analizimi i formave dhe karakteristikave të grupeve të të nxënimit
Metodat dhe teknikat	Ligjëratë, diskutime, punë në grup, prezantimet, testi i vetëvlerësimit
Korniza kohore	30 min.
Burimet e kërkuara	Letër tabele, kartelat e moderimit, lapsa me ngjyra, projektor
Materiali i kërkuar didaktik	Prezantim me PowerPoint
Procedura	Vetëvlerësimi; shiko Tbl. Vetëvlerësimi

**Tabela 7.3: Vetëvlerësimi**

	--	-	+	++
1. A mund t'i njoh fazat e zhvillimit të grupit?				
2. A mund të diagnostikoj situatat në grup?				
3. A mund ta aktivizoj grupin për të bashkëpunuar me mua dhe njëri tjetrin?				
4. A mund ta pranoj kur anëtarët e grupit diskutojnë rolin dhe funksionin tim?				
5. A mund të flas me grupin për rolin dhe funksionin tim?				
6. A mund të krijoj rregulla me grupin?				
7. A mund t'i pranoj dallimet relativisht të mëdha mes anëtarëve të grupit?				
8. A mund t'i analizoj pengesat dhe t'i shtjelloj në një proces në grup?				
9. A mund t'i trajtoj në mënyrë produktive konfliktet në grup?				
10. A mund t'i jap kohë grupit për të arritur zgjidhje vetë?				
11. A mundet devijimi nga tema të shkaktojë kuriozitet për synimet e mia mes disa anëtarëve të grupit?				
12. A mund ta inkurajoj origjinalitetin dhe krijimtarinë mes anëtarëve të grupit?				
13. A mund ta trajtoj origjinalitetin dhe krijimtarinë që i tejkalon pritjet e mia?				
14. A mund t'i pranoj anëtarët e grupit që janë në pozita të larta?				
15. A mund t'i trajtoj shpërthimet e emocioneve nga anëtarët e grupit?				
16. A mund ta pranoj kur grupi ia del pa mua?				
17. A mund të trajtoj situata jo-transparente, kaotike në procesin e të nxënimit?				
18. A ndihem i aftë të lundroj nëpër situata kaotike?				
19. A mendoj se kam në dispozicionin tim mundësi të nevojshme për të ndërhyrë kur udhëheq procesin e grupit?				
20. A mund ta përpunoj pasigurinë time për sa i përket proceseve të reja të grupit të ardhshëm?				
-- = Aspak; ++ = Shumë mirë				
Rekomandim: Gjeni një person të cilit ju i besoni dhe flisni me të rreth vetëvlerësimit tuaj.				

**Sugjerime didaktike**

Kjo njësi e të nxënimit mund të zbatohet në mënyra të tjera, siç janë:  
 Ulja e NASA-s në Hënë (çka është një formë tërheqëse, interesante dhe dinamike për të kuptuar ndikimin e pajtimit në grup dhe presionit të grupit, dhe krahason efikasitetin e individit dhe grupit)  
 Punë grup ose punë në dyshe (çka rrit shkëmbimin e ideve dhe përvojave mes nxënësve)

## Tema 8: Modele për punën me grupe

Tema 8 adreson temën më të gjerë të modeleve për të punuar me grupe, si dhe rolin e mësimdhënësit në punën në grup, të cilat mund të vëzhgohet nga këndvështrime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme. Ajo ka dy nën-tema specifike të cilat janë përqendruar në elemente të ndryshme të Temës kryesore dhe janë paraqitur në Doracak me përshkrime të synimeve të të nxënësve dhe rezultateve të të nxënësve.

Arsimtarët kanë lirinë të vendosin kornizën kohore për realizimin e çdo nën-teme, si dhe renditjen e nën-temave, sipas karakteristikave dhe diturive dhe përvojave të mëparshme të grupit të të nxënësve.

Qëllimi kryesor i kësaj teme është të kuptohet përdorimi i modeleve të ndryshme për punën në grup në arsimin dhe të nxënësve e të rriturve.

**Tabela 8:** Nën-temat, synimet e të nxënësve dhe rezultatet e të nxënësve për zbatimin e temës: **Modele për punën me grupe**

<i>Synimi i të nxënësve:</i> Hyrje në modelet themelore për punën në grup dhe përdorimin e tyre në arsimin për të rritur.		
<i>Rezultati i përgjithshëm i të nxënësve:</i> Pas zbatimit të kësaj teme, nxënësit i njohin modelet e ndryshme të punës në grup, janë në gjendje të njohin dhe shpjegojnë të gjitha pikat e forta dhe të dobëta të tyre, dhe të marrin pjesë aktive në zbatimin e tyre.		
Nën-tema	Synimi	Rezultati
<b>1. Modelet për punën e suksesshme në grup</b>	Prezantimi dhe analizimi i të gjitha modeleve themelore për punën në grup.	Nxënësit janë në gjendje të njohin dhe shpjegojnë modelet themelore të punës në grup.
<b>2. Puna e mësimdhënësit dhe e grupit</b>	Prezantimi dhe analizimi i rolit të mësimdhënësit për punën në grup.	Nxënësit janë në gjendje të njohin rolin e mësimdhënësit për punën në grup.


## 8.1. Modelet për punën e suksesshme në grup

Rëndësia e rrjedhës së fazave të procesit të zhvillimit të grupit mund të përdoret për ndërtimin e një grupi të tërë modelesh për punën në grup. Modelet duhet të jenë të përqendruara drejt mundësive të të nxënit për ata që duan, dhe duhet të anojnë drejt dinamikës së zhvillimit të komunitetit shoqëror në të cilin ata mësojnë.

Ndërveprimi i përqendruan në temë është një model për zhvillimin personal dhe për të punuar me grupe.<sup>19</sup>

Ky model përqendrohet në sa vijon:

- proces aktiv, krijues dhe zbulues i të nxënit dhe punës
- procesi dhe struktura
- bëja të dukshëm e komponentit të padukshëm të dinamikës së grupit
- mjetet dhe qëndrimet për të optimizuar ndërveprimet në proceset në grup
- i zbatueshëm për një gamë të gjerë qëllimesh në grup, ekipe pune, ekipe departamentesh
- pamje holistike e personalitetit
- integrimi i ndjenjave, mendimeve, perceptimeve dhe instinkteve (kokë, zemër, bark).



Trekëndëshi i rrethuar nga rrethi është simboli për ndërveprimin e përqendruar në temë: komponentët e punës në grup që duhet të mbahen në ekuilibër dinamik për një grup për të arritur synimet e tij, përkatësisht: - egoja individuale (UNË); - nevoja e grupit (NE) dhe temës (AJO). (GLOBI) është ambienti rrethues ose konteksti me kërkesat dhe kufizimet e tij që ndikojnë në punën në grup.

Një sociogram është hartëzimi i marrëdhënieve ndër-shoqërore brenda një grupi. Qëllimi i tij është të zbulojë strukturën e grupit: d.m.th., "rrjetin" themelor të modeleve të miqësisë dhe organizimit të nën-grupeve. Marrëdhëniet e secilit nxënës me grupin në tërësi janë një lloj tjetër informacioni që mund të nxirret nga një sociogram. Vlera e një sociogrami për një mësimdhënës është në potencialin e tij për të zhvilluar të kuptuar më të madh të sjelljes në grup, në mënyrë që ai/ajo të operojë me më shumë mençuri në menaxhimin e grupit dhe zhvillimin e kurrikulave.

Sociogramet mund të ndërtohen në mënyra të ndryshme. Metodatat e përshkruara këtu janë ato që mësimdhënësit i kanë përdorur dhe i konsiderojnë jo shumë të vështira ose që kërkojnë kohë.

Baza e të dhënave: Materiali bazë nga i cili ndërtohet një sociogram mblidhet nga anëtarët e grupit që u përgjigjen pyetjeve si këto:

- Kush janë tre miqtë tuaj më të mirë në këtë grup?
- Kush janë tre personat në këtë grup që ju i admironi më shumë?
- Me cilët tre persona në këtë grup do të kënaqeni më shumë të shkoni në një piknik?

Bërja e pyetjeve është çelësi për të marrë më shumë informacione, dhe pa to komunikimi ndërpersonal mund të dështojë. Pyetjet janë themelore për një komunikim të suksesshëm - të gjithë duam të na

<sup>19</sup> <http://ehornecker.de/Papers/TZI.pdf>

bëhen pyetje kur jemi të përfshirë në një bisedë. Pyetjet mund të jenë të hapura, të mbyllura, alternative, retorike, sugjeruese, kundër-pyetje, pyetje pingpong, etj.

Edhe pse pyetjet janë zakonisht me natyrë verbale, ato gjithashtu mund të jenë joverbale. Për shembull, ngritja e vetullave mund të nënkuptojë “A jeni i sigurt?” Shprehjet e fytyrës mund të zëvendësojnë një numër pyetjesh delikate në periudha ose kontekste të ndryshme.

Megjithëse nuk është gjithëpërfshirëse, lista e mëposhtme jep një përmbledhje të arsyeve kryesore për shtrimin e pyetjeve në punën në grup me të rriturit:

- Për të marrë informacion.
- Për të mbajtur kontrollin mbi bisedën.
- Për të shprehur interes për temën ose për anëtarët e tjerë.
- Për të sqaruar problemet.
- Për të hetuar personalitetet e pjesëmarrësve dhe vështirësitë që mund të përjetojnë.
- Për të vlerësuar dituritë.
- Për të inkurajuar reflektim shtesë.
- Për të përfshirë të gjithë anëtarët e grupit.
- Për të inkurajuar pjesëmarrësit në një diskutim më intensiv.
- Për të mbajtur vëmendjen duke parashtruar pyetje pa njoftim paraprak.

Para se të bëni një pyetje, së pari pyesni veten:

- Pse - është kjo pyetje në rregull?
- Kur - është koha e duhur?
- Ku - është vendi i duhur?
- Kush - është personi më i përshtatshëm për këtë - a jam unë?
- Si - mund ta bëj më efikase?

Modelet e tjera që mund të përdoren gjithashtu për punën në grup përfshijnë:<sup>20</sup>

- |  |                                |
|--|--------------------------------|
| - Gjenerim idesh;                                  | - Matrica e kornizës logjike;  |
| - Simulime;  | - Ngrohjet, “Akullthyesit”;    |
| - Grafikë;   | - “Projeksione të së ardhmes”; |
| - Meta-plane (kartela);                            | - Debatet “Pro dhe Kundër”;    |
| - Tabela, diagrame;                                | - “Fantazia e ujit”;           |
| - Harta e mendjes;                                 | - “Shëtitje nëpër galeri”;     |
| - Analiza SWOT;                                    | - Barometra;                   |
| - Votimi, zgjedhje (p.sh. përdorimi i “afisheve”); | - “Stilet e të menduarit”;     |
| - Prezantime pamore;                               | - Lojë rolesh.                 |

---

<sup>20</sup> Šefika Alibabić; Katarina Popović; Emir Avdagić. Doracaku andragogjik për punën me të rriturit, *DVV International* - Zyra e Shkupit, 2013

#### Parimet themelore për punën e suksesshme në grup

- Përkushtimi! Një grup mund të punojë në mënyrë efektive nëse çdo anëtar dëshiron që ai të funksionojë.
- Gjeni kohën e nevojshme për të diskutuar qasjet dhe idetë themelore, për të vlerësuar punën tuaj në grup dhe që t'i jepni reagime njëri tjetrit.
- Bëni një kontratë; të gjithë janë përgjegjës!
- Veproni mbi bazën e vlerave dhe objektivave themelorë të vendosur së bashku.
- Pranoje veten dhe të tjerët.
- Vetë-përgjegjësi: Unë jam përgjegjës për veprimet dhe sjelljet e mia.
- Besoni tek njëri tjetri dhe mbështesni aftësitë dhe performancën e njëri tjetrit.
- Respektoni kufijtë e të gjithëve.
- Jini të gatshëm të pranoni riskun e të bërit diçka të re, sfidoni veten.
- Pranoni gabimet si një shans për të nxënë.
- Mendimi i orientuar drejt procesit: objektivat janë të rëndësishëm, por edhe procesi është i rëndësishëm. Grupi është në gjendje të vetë-përmirësohet duke ekzaminuar procedurat dhe praktikatat e tij.
- Vendosni disa procedura për të analizuar situatat dhe për të zgjidhur problemet.
- Jini të gatshëm të pranoni emocione si pjesë e procesit të punës.
- Mbani një ekuilibër mes efikasitetit dhe cilësisë sociale.
- Krenohuni për arritjet e grupit.

## 8.2. Puna e mësimit dhe e grupit

Roli i mësimit për punën në grup është i shumanshëm dhe, përveç përcimit të diturive dhe informacionit, përfshin motivimin dhe udhëzimin e pjesëmarrësve, drejtimin drejt mënyrave të ndryshme të të nxënës, aktivizimin dhe sigurimin e udhëzimeve për punë. Ai/ajo siguron impulsin fillestar dhe i drejton anëtarët e grupit drejt bërjes së kontakteve të para, njohjes me njëri tjetrin dhe shoqërimin. Nga ana tjetër, ai/ajo mundet që, në një kuptim, t'i vëzhgojë "nga jashtë" marrëdhëniet që po zhvillohen mes anëtarëve të grupit, dhe të ndërhyjë në situata të caktuara, kur është e mundur.

Mësimit është lehtësuesi i procesit të të nxënës, një nga burimet e informacionit, dikush që "lehtëson" rrugën drejt diturive, shkathtësive dhe aftësive të reja, i cili siguron një shtysë në procesin arsimor dhe më pas lë hapësirë të mjaftueshme për të gjithë për të dhënë kontribut në zhvillimin e tij. Mësimit duhet t'i motivojë nxënësit për përfshirje aktive në procesin e punës në grup dhe në procesin e përmirësimit të diturive të tyre.

Mësimit duhet ta bazojë punën e vet me nxënësit e rritur në një numër parimesh të përcaktuara në mënyrë që puna e tij/saj të përfundojë me sukses dhe të arrihen synimet e pjesëmarrësve, përfshirë ato të mëposhtme:

- T'i kushtojë vëmendje nevojave, shkathtësive dhe synimeve të pjesëmarrësit. Përfshirja e pjesëmarrësve në procesin e planifikimit dhe hartimit të vetë programit ndihmon në integrimin e nevojave dhe pritjeve të tyre, por më e rëndësishmja është së përbën një mënyrë për të demonstruar respekt ndaj pjesëmarrësit të rritur.
- T'i evokojë dhe të bazohet në përvojat e pjesëmarrësve. Përvoja e tyre e jetës mund të përdoret si shembull në procesin e mësimit dhe të nxënës.
- Mjedisi i të nxënës duhet të bazohet në respektin dhe besimin e ndërsjellë si themelet e procesit të të nxënës. Pjesëmarrësit duhet të ndihen të qetë gjatë procesit të të nxënës, dhe të mos kenë përvoja të pakëndshme të dështimit.
- Të ushqejë bashkëpunimin; secili pjesëmarrës posedon shkathtësi, përvojë dhe dituri të rëndësishme që ai/ajo mund të ndajë me pjesëmarrësit e tjerë dhe mësimit.
- Të zhvillojë iniciativë, pavarësi dhe ndjenjë e autoritetit mes anëtarëve të grupit.

## Tema 9: Teknika për drejtimin e dinamikës së grupit

Teknikat e mëposhtme për punën në grup dhe zgjidhjen e problemeve janë shumë efektive:

- *Rastet studimore* janë skenarë që zbatojnë konceptet e mësuara në klasë në një situatë të “jetës reale”. Ato zakonisht paraqiten në formë narrative dhe shpesh përfshijnë zgjidhjen e problemeve, lidhje me leximet e lëndës ose materialeve burimore, dhe diskutimet nga grupe të nxënësve, ose e gjithë klasa. Zakonisht, rastet studimore janë më efektive nëse ato paraqiten në mënyrë sekuenciale, në mënyrë që nxënësit të marrin informacione shtesë pasi shpaloset rasti, dhe të mund të vazhdojnë ta analizojnë ose kritikojnë situatën/problemin.
- Obelisku ZIN, lojë e cila me zgjidhjen e një problemi matematikor tregon mënyrën se si funksionon një grup, si zgjidhen problemet, si merren vendimet dhe rolet tipike në një grup;
- Aktivitetet e të nxënësve të bazuar në probleme janë të ngjashme me rastet studimore, por zakonisht përqendrohen në probleme sasiore. Në disa raste, problemet dizajnohen për të prezantuar materialin, si dhe u ofrojnë nxënësve një mundësi më të thelluar të të nxënësve. Avantazhet e aktiviteteve të të nxënësve të bazuar në probleme dhe rasteve studimore përfshijnë zhvillimin e shkathtësive të nxënësve për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve, zhvillimin e shkathtësive të të menduarit kritik të nxënësit, inkurajimin e reflektimit kritik dhe mundësimin e vlerësimit të paqartësisë në situata.
- Ulja e NASA-s në Hënë, që ndihmon për të kuptuar ndikimin e pajtimit në grup dhe presionit të grupit, dhe krahason efikasitetin e individit dhe grupit;
- Demonstrimet ndërvepruese mund të përdoren në ligjëratat për të demonstruar zbatimin e një koncepti, një shkathtësie ose për të kryer një proces. Ushtrimi nuk duhet të jetë pasiv; ju duhet të planifikoni dhe strukturoni demonstrimin tuaj për të përfshirë mundësi që nxënësit të reflektojnë dhe analizojnë procesin.
- Përfshirja e **debateve** në diskursin bashkëpunues dhe argumentimin rrit kuptimet konceptuale të nxënësve dhe rafinon aftësitë e tyre të arsytimit. Bëni një debat duke shfrytëzuar një ndarje të diskutueshme në materialet e ditës. Jepuni kohë ekipeve për t’u përgatitur, dhe pastaj hapni argumentimin me një ekip të përqendruar në përfaqësimin e një këndvështrimi të kundërt. Avantazhet përfshijnë praktikën në përdorimin e gjuhës së disiplinës dhe hartimin e arsytimit të bazuar në prova në argumentet e tyre.
- BAFA BAFA dhe punëtori të tjera me luajtjen e roleve dhe simulimin e kulturave të ndryshme, ku konteksti ndërkulturor i çon pjesëmarrësit të përballen me stereotipat e tyre dhe çon në rritjen e tolerancës dhe hapjes ndaj diversitetit;
- **Lojë rolesh**. Anëtarët e klasës marrin pjesën ose këndvështrimin e figurave historike, autorëve ose personazheve të tjerë, dhe duhet të bashkëveprojnë nga këndvështrimi i tyre. Ndarja e roleve në detyra specifike për t’i mbajtur nxënësit të organizuar dhe të strukturuar në mënyrë që të adresohet përmbajtja që dëshironi të mbulonin. Puna përgatitore mund të caktohet për jashtë klasës, kështu që është thelbësor komunikimi i qartë i pritjeve tuaja.
- Kapelet e De Bono-s, punëtori që mund të aplikohet në mënyrë shumë kreative dhe të krijojë një atmosferë të këndshme pune, dhe ofron përshtime për stilet e ndryshme të të menduarit dhe mënyrat si veprojnë në procesin e marrëveshjes, negociatave dhe diskutimeve në grup.
- Biletat hyrëse dhe dalëse janë udhëzime të shkurtra që u japin mesimdhënësve një diagnostikim të shpejtë të nxënësit. Këto ushtrime mund të mblidhen në kartela 3”x5”, copa të vogla letre, ose online përmes një sistemi të studimit ose menaxhimit të kursit. Avantazhet e biletave hyrëse dhe dalëse përfshijnë: pjesëmarrjen e secilit nxënës, nxitjen e nxënësve që të përqendrohen në konceptet dhe idetë kyçe, një kthim të lartë të informacionit për sasinë e kohës së investuar, reagime të rëndësishme për instruktorin që mund të jenë të dobishme për të udhëhequr vendimet e mesimdhënies ( p.sh., hapja e kurseve, sqarimi i shpejtë i keqkuptimeve të vogla, identifikimi i interesave dhe pyetjeve të nxënësve).

**Tabela 9.1: Udhëzues: Përgatitja për punën në grup**

<b>Mendoni me kujdes si do të vendosen nxënësit fizikisht në grupe</b>	A do të jetë e lehtë për grupet të formohen dhe për të gjithë nxënësit të jenë të qetë? Mendoni gjithashtu si do të ndikojë në volumin e zërit paraqitja e klasës suaj - a do të jenë në gjendje nxënësit ta dëgjojnë njëri tjetrin qartë? Si mund ta moderoni aktivitetin për ta kontrolluar volumin?
<b>Këmbëngulni për sjelljen profesionale, civile</b>	ndërmjet dhe mes nxënësve për të respektuar dallimet e njerëzve dhe për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës.
<b>Bisedoni me nxënësit për përvojat e tyre të shkuara me punën në grup</b>	Lejojuni të krijojnë disa rregulla themelore për bashkëpunim të suksesshëm. Ky diskutim mund të bëhet me sukses në mënyrë anonime përmes përdorimit të kartelave të shënimeve.
<b>Dizajnimi i aktivitetit të grupit të vogël</b>	
<b>Identifikimi i objektivave të udhëzimit.</b>	Përcaktoni se çfarë doni të arrini përmes aktiviteteve të grupit të vogël, si në aspektin akademik (p.sh. dituri për një temë) ashtu edhe në atë shoqëror (p.sh. shkathtësitë e të dëgjuarit). Aktiviteti duhet të lidhet ngushtë me objektivat e kursit dhe përmbajtjen e tij, dhe duhet të jetë i dizajnuar për t'u ndihmuar nxënësve të mësojnë, jo thjesht të zënë kohën e tyre
<b>Bëjeni detyrën sfiduese.</b>	Konsideroni dhënien e një detyre relativisht të lehtë në fillim të afatit për të ngjallur interesin e nxënësve për punën në grup dhe për të inkurajuar përparimin e tyre. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve, ushtrimet bashkëpunuese duhet të jenë stimuluese dhe sfiduese.
<b>Caktoni detyra në grup që inkurajojnë përfshirjen, ndërvarësinë dhe një ndarje të drejtë të punës.</b>	Të gjithë anëtarët e grupit duhet të ndiejnë një ndjenjë të përgjegjësisë personale për suksesin e shokëve të tyre të ekipit dhe të kuptojnë se suksesi i tyre individual varet nga suksesi i grupit. Ndani burimet thelbësore për të gjithë grupin, në mënyrë që anëtarëve të grupit të kërkohet të ndajnë informacione (p.sh., metoda “mozaik”) ose të arrijnë një konsensus; zgjidhni rastësisht një person për të folur për grupin; ose caktoni role të ndryshme për anëtarët e grupit në mënyrë që ata të jenë të përfshirë në proces (p.sh. regjistruet, zëdhënës, përmbledhës, kontrollues, skeptik, organizator, vëzhgues, kohëmatës, zgjidhës i konflikteve, ndërlihdës me grupet e tjera). Të dish se kolegët mbështeten te ju është një motivues i fuqishëm për punën në grup. Një strategji tjetër për promovimin e ndërvarësisë është specifikimi i shpërblimeve të përbashkëta për grupin, siç është marka e grupit.
<b>Vendosni për përmasën e grupit</b>	Përmasa që zgjidhni do të varet nga numri i nxënësve, madhësia e klasës, larmia e zërave të nevojshëm brenda një grupi dhe detyra e caktuar. Grupet prej 4-5 vetash kanë tendencë t'i balancojnë mirë nevojat për diversitetin, produktivitetin, pjesëmarrjen aktive dhe kohezionin.
<b>Vendosni si do t'i ndani nxënësit në grupe</b>	Ndarja bazuar në afërsinë ose zgjedhjen e nxënësve është më e shpejtë, veçanërisht për klasa të mëdha dhe të stërbushura; megjithatë, kjo do të thotë që nxënësit përfundojnë të punojnë së bashku me miqtë ose gjithmonë me të njëjtët njerëz. Për të ndryshuar përbërjen në grup dhe për të rritur diversitetin brenda grupeve, caktoni nxënësit në mënyrë rastësore në grupe duke i numëruar dhe grupuar ata sipas numrit; ose i bëni të rreshtohen sipas ditëlindjes, lartësisë, ngjyrës së flokëve, etj., përpara se t'i ndani; një ide tjetër është ndarja e karamelave (p.sh., karamelat me të kuqe ose të verdha) dhe e nxënësve të grupit sipas ngjyrës që zgjedhin. Për disa detyra në grup, diversiteti brenda një grupi (gjinia, përkatësia etnike, niveli i përgatitjes) është veçanërisht i rëndësishëm, dhe ju mund të dëshironi t'i caktoni vetë nxënësit në grupe

	para klasës. Mblidhni një kartelë të dhënash nga secili nxënës ditën e parë të kursit për të mbledhur informacione të rëndësishme në lidhje me prejardhjen, dituritë dhe interesat e tyre. Përndryshe, kërkoni nxënësve të shprehin një preferencë (p.sh., rendisni tre nxënës me të cilët do të donin më shumë të punonin ose dy tema që do të dëshironin më shumë të studionin) dhe mbajini parasysh preferencat e tyre kur caktoni grupe.
<b>Lejoni kohë të mjaftueshme për punë në grup</b>	Pranoni se nuk do të jeni në gjendje të mbuloni aq material sa do të mundeshit sikur të mbanit ligjëratë gjatë gjithë orës. Shkurtoni përmbajtjen që dëshironi të paraqisni në mënyrë që t'u jepni grupeve kohë për të punuar. Vlerësoni sasinë e kohës që iu duhet nëngrupeve për ta përfunduar aktivitetin. Gjithashtu planifikoni për një seancë plenare në të cilën mund të paraqiten rezultatet e grupeve ose të diskutohen çështje të përgjithshme dhe pyetje.
<b>Mundohuni të parashikoni përgjigjet e nxënësve</b>	Ju nuk do të jeni në gjendje ta bëni këtë në mënyrë të përsosur - prisni të papriturën - por duke pasur një ide se çfarë do të paraqesin nxënësit, do të jeni më të përgatitur për t'u përgjigjur pyetjeve të tyre dhe do ta përmbledhni punën në grup gjatë seancës plenare.
<b>Dizajnoni punë bashkëpunuese në kostelacione dhe forma të shumta</b>	Dyshet, grupet e vogla, grupet e mëdha, në mënyrë sinkronike, online në mënyrë asinkronike, etj. Disa nxënës mund të jenë më të aftë të kontribuojnë pasi të kenë pasur kohë për t'i tretur materialet, ndërsa të tjerët mund të jenë më të aftë të mendojnë në vend; nxënësit e tjerë do shkojnë me mendimin të tjerëve në grupe të mëdha, por kontribuojnë aktivisht në dyshe; të gjitha rolet duhet të vlerësohen dhe të përfshihen.
<b>Prezantimi i aktivitetit në grup</b>	
<b>Demonstroni se jeni i përgatitur për seancën në grup</b>	Mbërrini me përpikëri, përgatiteni një material që lidhet posaçërisht me detyrën dhe kryeni detyra që ju premtuat të kryeni kur keni përdorur për herë të fundit punën në grup në klasë (Race, 2000).
<b>Ndani arsyetimin tuaj për përdorimin e punës në grup</b>	Nxënësit duhet të kuptojnë përfitimet e të nxënës bashkëpunues. Mos supozoni se nxënësit e dinë se cili është qëllimi pedagogjik. Ndërlidhni në mënyrë të qartë këto aktivitete me temat më të mëdha të kursit dhe rezultatet e të nxënës, kurdo që të jetë e mundur. Nëse ata nuk e shohin vlerën e aktivitetit në grup, ata mund të konkludojnë se ju po e përdorni punën në grup thjesht për të hequr qafe përgatitjen apo ligjëratat.
<b>Bëjini nxënësit të formojnë grupe përpara se t'u jepni udhëzime</b>	Nëse përpikëri të jepni udhëzime së pari, nxënësit mund të jenë atë të preokupuar kur vendosin për anëtarësimin në grup saqë nuk ju dëgjojnë. Ose, deri ku t'i kenë përcaktuar grupet e tyre, ata mund të kenë harruar atë që duhet të bëjnë.
<b>Lehtësoni një formë të kohezionit të grupit</b>	Nxënësit punojnë më mirë së bashku nëse e njohin ose i besojnë njëri tjetrit, të paktën në një farë mase. Edhe për aktivitete të shkurtra në grup, nxënësit duhet të prezantohen me anëtarët e grupit të tyre përpara se të marrin pjesë në detyrën e tyre. Për periudha më të gjata të punës në grup, konsideroni prezantimin e një akullthyesi ose një aktiviteti të krijuar posaçërisht për të krijuar një ndjenjë të punës në grup.
<b>Shpjegoni qartë detyrën</b>	Kjo nënkupton se duhet t'u tregoni nxënësve saktësisht se çfarë duhet të bëjnë, si dhe të përshkruani si do të duket produkti përfundimtar i punës së tyre në grup. Shpjegimi i panoramës së madhe ose synimit përfundimtar është i rëndësishëm, veçanërisht kur puna në grup do të zhvillohet në hapa (si p.sh. ortek ose mozaik). Përdorimi i strukturave pamore si grafikët dhe diagramet sekuencialë është shpesh i dobishëm, siç është përdorimi i fillesave të fjalive dhe pyetjeve specifike. Mos harroni të përfshini vlerësimet e kohës për aktivitetet. Parashikoni

	minimumin; nxënësit do të punojnë në mënyrë më efektive kur afrohet afati. Nëse është e nevojshme, mund të rrisni kohën në dispozicion.
<b>Përgatitni udhëzime me shkrim për nxënësit</b>	Ose i projektioni udhëzimet me PowerPoint, ose nëse disa prej grupeve do të largohen nga dhoma, shpërndani një material të shtypur.
<b>Vendosni rregulla themelore për ndërveprimin në grup</b>	Sidomos për periudhat e gjata të punës në grup, vendosni si duhet të bashkëpunojnë me njëri tjetrin anëtarët e grupit, duke përmendur parime të tilla si respekti, dëgjimi aktiv dhe metodat për marrjen e vendimeve.
<b>Lëri nxënësit të bëjnë pyetje</b>	Jepuni kohë të bëjnë pyetje përpara se të fillojnë të punojnë.
<b>Monitorimi i detyrës në grup</b>	
<b>Monitoroni grupet, por mos u rriini mbi kokë</b>	Ndërsa nxënësit bëjnë punën e tyre, qarkulloni mes grupeve dhe përgjigjuni për çdo pyetje të ngritur. Po ashtu, dëgjoni për tendencat që dalin nga diskutimet, në mënyrë që t'iu referoheni gjatë diskutimit plenar pasues.
<b>Prisni shumë nga nxënësit tuaj</b>	Shprehni besimin tuaj tek ata teksa qarkulloni nëpër klasë.
<b>Ato që dini mos i ndani me nxitim</b>	Nëse hasni në një grup që po përjeton paqartësi ose mosmarrëveshje, shmangni tendencën natyrale për të dhënë përgjigje ose për të zgjidhur mosmarrëveshjen.
<b>Sqaroni rolin tuaj si lehtësues</b>	Nëse nxënësit ju kritikojnë që nuk keni kontribuar sa duhet në punën e tyre, merrni parasysh nëse e keni komunikuar mjaft qartë rolin tuaj si lehtësues.
<b>Përfundimi i detyrës në grup</b>	
<b>Bëni mbylljen e aktiviteteve të grupit</b>	Puna në grup mund të ketë sukses ose të dështojë bazuar në mënyrën se si e përfshini në pjesën tjetër të klasës dhe kursit. Nxënësit duhet të shohin dobinë e punës së tyre në grupe të vogla ishte dhe/ose nëse kontribuuan në zhvillimin e temës. Kështu, përfundoni me një seancë plenare në të cilën nxënësit bëjnë raportimin në grup:
<b>Modeloni si dëshironi të marrin pjesë nxënësit</b>	Kur u përgjigjeni përgjigjeve të nxënësve, modeloni respektin dhe ndjeshmërinë që dëshironi që nxënësit të shfaqin ndaj shokëve të tyre të klasës. Gjithashtu pranoni dhe vlerësoni me lehtësi opinionet e ndryshme nga tuajat; mos favorizoni klonet! Jini të gatshëm të ndani tregimet tuaja, kritikoni punën tuaj dhe përmbliidhni ato që janë të mëdha.
<b>Lidhni idetë e ngritura për përmbajtjen dhe objektivat e kursit</b>	Duhet ta pranoni se grupet mund të mos dalin me idetë që keni synuar prej tyre, kështu që duhet të jenë të gatshëm t'i bëni planet tuaja të ligjëratave fleksibël. Kudo që të jetë e mundur, kërkonte një lidhje mes përfundimeve të grupit dhe temës së kursit.
<b>Shmangni ligjëratat e improvizuara</b>	Ato ndërpresin rrjedhën e bisedës gjatë seancës plenare
<b>Mos e teproni me mbylljen</b>	Megjithëse seanca plenare duhet ta përfundojë punën në grup, mos ngurroni të lini disa pyetje pa përgjigje për hulumtime të mëtejshme ose për orën tjetër.
<b>Kërkojuni nxënësve të reflektojnë për procesin e punës në grup</b>	Ata mund të bëjnë këtë me gojë ose me shkrim. Ky reflektim i ndihmon të zbulojnë se çfarë mësuan dhe si funksionuan në grup. Kjo gjithashtu ju jep një sens të përgjigjes së tyre ndaj punës në grup.
<b>Përfundimi i veprimtarisë</b>	
	Pas një ore me aktivitete në grupe të vogla, reflektoni për procesin e punës në grup dhe referojuni shënimeve që keni bërë para klasës. Shtoni komente për atë që funksionoi veçanërisht mirë dhe çfarë do të ndryshonit në të ardhmen për ta bërë ushtrimin të funksionojë më mirë.

Sipas: Qendra për Përsosmëri të Mësimdhënies, Universiteti i Waterloo, Kanada

## Literatura e përdorur dhe e rekomanduar

- Brown, D.S., Lent, W.R. (2008). Handbook of counseling psychology. New Jersey, Canada: John Wiley & Sons, Inc.
- Brown, R. (1988) Group Processes. Dynamics within and between groups, Oxford: Blackwell.
- Communication for Business Success. See:  
<http://2012books.lardbucket.org/pdfs/communication-for-business-success.pdf>
- Communication Theory, [http://www.afirstlook.com/edition\\_9/theory\\_list/by\\_author](http://www.afirstlook.com/edition_9/theory_list/by_author)
- Compendium of Cultural Policies and Trends in Europe, (12.11.2011):  
<http://www.culturalpolicies.net/web/intercultural-dialogue.php> (12.11.2011)
- Delia, J. O’Keefe, B., & O’Keefe, D. (1982). The constructivist approach to communication. Human Communication Theory. New York: Harper and Row, 147-91.
- Gibbs, G., Habeshaw, S., i Habeshaw, T. (1989) 53 Interesting Things to do in Your Seminars and Tutorials. Bristol, TES Publications
- Gordon, T., (1970) Parent Effectiveness Training, New York, Peter H. Wyden, New York
- Griffin, E. (2012). A first look at communication theory (8thed.). New York: McGraw-Hill.
- Grundlagen, in: Klaus Künzel (Hg.), International Yearbook of Adult Education, Bd. 27 Köln: Böhlau
- Jaques, D. (2001) Learning in groups: A handbook for improving group work, 3rd ed. London
- Klippert, H. (2002) Methoden – Training, Weinheim und Basel, Beltz Verlag
- Lewin, K. (1935) A dynamic theory of personality. New York: McGraw-Hill.
- Lewin, K. (1951) Field theory in social science; selected theoretical papers. D. Cartwright (ed.). New York: Harper & Row.
- Lewin, K. and Lippitt, R. (1938) ‘An experimental approach to the study of autocracy and democracy. A preliminary note’, Sociometry 1: 292-300.
- Lewin, K., Lippitt, R. and White, R. (1939) ‘Patterns of aggressive behaviour in experimentally created “social climates”’, Journal of Social Psychology 10: 271-99.
- O’Connor, J., Lages, A. (2007) How coaching works. The essential guide to the history and practice of effective coaching. London: A & London: A & C Black Publishers Ltd
- Paula S. Tompkins, *Practicing Communication Ethics: Development, Discernment, and Decision-Making*. Routledge, 2016
- Popović, K. (2011) Self-directed Learning. In: Jarvis, P., Watts, M. (Eds.), The Routledge International Handbook of Learning (Routledge International Handbooks of Education), London etc: Routledge.
- Przybylska, E. and o. (2006) TEACH – Teaching adult educators in continuing and higher education, Torun, Uniwersytet Mikolaja Kopernika
- Rachow, A. (2000) Spielbar, Bonn, Gerhard May Verlag GmbH
- Robert Bolton, Ph.D. (2009): People Skills, A Touchstone Book, New York, London, Toronto, Sydney, p.
- Schulz von Thun, F. (1981). Miteinander reden 1 – Störungen und Klärungen. Allgemeine Psychologie der Kommunikation. Rowohlt: Reinbek
- Šefika Alibabić; Katarina Popović; Emir Avdagić. Andragogic Manual for Working with Adults, dvv international – Skopje Office, 2013
- Seifert, J. (2001) Visualisieren, Präsentieren, Moderieren, Offenbach, Gabal
- Sherif, M., & Hovland, C.I. (1961). Social Judgement. New Haven, CT: Yale University Press.
- Smith, M. K. (2001) ‘Kurt Lewin, groups, experiential learning and action research’, the encyclopedia of informal education, <http://www.infed.org/thinkers/et-lewin.htm>
- Stone, M.F. (2007) Coaching, Counseling & Mentoring New York: AMACOM

- Unesco (2006): Participatory Adult Learning, Documentation and Information Networking (PALDIN) 1 & 2, Group of Adult Education, School of Social Sciences, Jawaharlal Nehru University, New Delhi
- Unesco, Learning Package on Participatory Adult Learning, Documentation and Information Networking (Paldin) Documentation Dissemination and Networking, Course 02, Unit 13
- Unesco, Learning Package on Participatory Adult Learning, Documentation and Information Networking (Paldin) Documentation Dissemination and Networking, Course 01, Unit 4
- Watzlawick et al, (1967). The pragmatics of human communication: a study of intentional patterns, pathologies, and paradoxes, New York: Norton
- Wiechmann, J. (2002) Zwölf Unterrichtsmethoden, Weinheim und Basel, Beltz Verlag